

Dikush mund të thotë: përse rimerret kjo çështje? Duket sikur gjykimi mbi realizmin socialist është tejkaluar por, në të vërtetë, kjo është një çështje teoriko-historiko-letrare, shumë e rëndësishme për interpretimin shkencor të proceseve letrare që ndodhën gjatë zhvillimit të letërsisë shqiptare. Ndër më thelbësoret është: gjykimi i realizmit socialist mbi bazën e konceptit të drejtimit letrar.

FLORESHA DADO: REALIZMI SOCIALIST DUHET STUDIUAR SI DREJTIM LETRAR



Fjala me rastin e dhënies së çmimit për veprën
më të mirë studimore në Panairin e Librit

URAN BUTKA
MARRËDHËNIA E
MID'HAT FRASHËRIT
ME LIBRIN

(fq. 2)

SHËNIME PËR LIBRAT

Romani "Të murosuar", i Lindita Arapit

MUROSJA
E ILUZIONALEVE

Nga Virion Graçi

(fq. 8)

MONOGRAFI KUSHTUAR
KUJTIMIT TË NDRITUR TË
PROF. PETRIT GAÇES

Nga Prof. As. Dr. Astrit Bishqemi

(fq. 10)

Libri i Stefan Çapalikut "Tregimet e tranzicionit"
(Botimet Fishta)

RRUGËTIMI I INDIVIDIT
PËRGJATË TRANZICIONIT

Nga Xheni Shehaj

(fq. 11)

Shënime për romanin "Dielli më perëndon në
lindje", të Eralda Bazes

SHKRIMTARJA QË E BËRI
DIELLIN TË PËRËNDOJË NË
LINDJE

Nga Mark Simoni

(fq. 9)

Romani "Gërsheti", i Laetitia Colombani
"GËRSHETI", NJË ROMAN
QË I PËRGJIGJET PYETJEVE
THEMELORE TË LIRISË

Nga Andreas Dushi

(fq. 17)



(fq. 7)

KUR NISI FORMËSIMI I DRAMËS SHQIPE (1920-1939)

Nga Josif Papagjoni

E dalë më në fund nga terri osman, kalbja antropologjike, ligjet e hekurta të Sheh-Ul-Islamit dhe tespihet, ku artet, sidomos piktura dhe teatri ndaloheshin me ligj dhe qubeshin shembëlltura të satanit-shejtanit, vetëm në fund të shek. XIX, aroma dhe hijeshia e teatrit nisën të ndihen edhe në Shqipërinë e lodhur...

KËRCIMI I MATISSE

Nga Dr. Bledar Kurti

(fq. 20)



RAYMOND CARVER: mbi artin e tregimit



(fq. 22)

BIBLIOTEKË

- Ismail Kadare (fq. 12)
Tirana në dimër
- Roland Gjoza (fq. 13)
Borsalino
- Shqiponja Axhami (fq. 14)
Gungaçi
- Shqiptar Oseku (fq. 15)
Përkujtimi
- Qazim Shehu (fq. 16)
Kali i Rexhës
- Naguib Mahfouz (fq. 18)
Dhoma Nr. 12

Vepra poetike e Sadik Bejkos

POEZIA SI SHENJË RINGJALLJEJE

Nga Alisa Velaj

Vërsimi lirik i poetit Sadik Bejko, ashtu si rrjedha natyrale e një lumi të rrëmbyer, do të shpërfaqej i tillë që në ciklet e para botuar në shtypin e kohës...

(fq. 14)

FLORESHA DADO:

REALIZMI SOCIALIST DUHET STUDIUAR SI DREJTIM LETRAR

(Trajtim teorik)

Dikush mund të thotë: përse rimerret kjo çështje?

Duket sikur gjykimi mbi realizmin socialist është tejkaluar por, në të vërtetë, kjo është një çështje **teoriko-historiko-letrare**, shumë e rëndësishme për interpretimin shkencor të proceseve letrare që ndodhën gjatë zhvillimit të letërsisë shqiptare. Ndër më thelbësoret është: gjykimi i realizmit socialist mbi bazën e konceptit të **drejtimit letrar**.

A lindi ky proces krijues, bashkë me të edhe kritika letrare, mbi bazën e një programi estetik, që dallon gjithë drejtimet letrare, të shfaqura në zhvillimet e letërsive? A janë parimet e programit të kësaj letërsie vërtetë të natyrës artistike?

Që në vitin 1936, formalisti i shkollës së Pragës, J. Mukarovski pranonte se “funksioni estetik shfaqet vetëm në rrethana të caktuara, domethënë në një kontekst social të caktuar”. Gjithashtu: ‘funksioni estetik është një komponent në marrëdhëniet midis së përbashkëtës njerëzore dhe botës.” (*Jan Mukarovsky: ‘Aesthetic Function, Norm and Value as Social Facts’, Univ.of Michigan, 1970*). Kështu, evolucioni i pikëpamjeve të këtij formalisti, pranimi i lidhjes së funksionit estetik me realitetin social, është një nga pikëvështrimet që ndihmon në interpretimin edhe të letërsisë sonë.

Por, si do të ndodhte shmangia dhe zëvendësimi i parimeve estetike, që formësojnë drejtimin letrar paraardhës, në drejtimin letrar të realizmit socialist? Ishte, më herët, teoricieni i Kritikës së Re, T. Eliot, që, duke trajtuar raportin midis traditës letrare dhe individualitetit krijues (*Shih T.S.Eliot: Tradition and the Individual Talent”, Selected Essays, 2nd edn, London:Faber & Faber, 1934, (shkruar në vitin 1919)* kishte parashkruar, pa u marrë me realizmin socialist, se vlerësimi i çdo lloj krijimtari artistike duhej të bëhej jo i shkëputur, por në krahasim me letërsinë dhe autorët paraardhës: “Unë mendoj se ky është një princip estetik, jo thjesht historik, kritik” Në këtë pohim të hershëm gjejmë një pikënisje të rëndësishme metodologjike për të vlerësuar letërsinë e realizmit socialist, si një hallkë në zhvillimin e gjithë letërsisë shqiptare. Ky është **problem teorik** që, për mendimin tim, i kapërren kufijtë e letërsisë sonë; ai duhet parë si fenomen estetikohistorik, në gjithë letërsinë e vendeve të sistemit komunist.

Përballë konceptit teorik të ‘drejtimit letrar’

Dihet se zhvillimi i letërsisë, kudo, ka kaluar nëpërmjet zëvendësimit të drejtimeve të ndryshme, dhe, vetë koncepti i drejtimit u përpunua atëherë kur mendimi teorik kishte arritur në një nivel të tillë, që mund të bënte karakterizimin tipologjik të fenomeneve letrare. Kështu, ishte bërë e qartë se **drejtimi letrar** është një program estetik, ku përcaktoheshin parimet e konceptimit dhe ndërtimit të veprës letrare, program që pranohej me vetëdijë (por edhe intuitivisht) nga shkrimtarët. Megjithatë,

teoria e drejtimit letrar mbetet, ende, ndër më të pa përpunuarat në shkencën letrare. Çfarë kemi parasysh kur themi: klasicizëm, romantizëm, realizëm, natyralizëm, simbolizëm, modernizëm, postmodernizëm, etj.? Grupin e shkrimtarëve që krijojnë në një periudhë të kohës, psikologjinë e shkrimtarit? Vlerat historike të një shkolle estetike të caktuar, tërësinë e mjeteve letrare? Cila është përmbajtja dhe vëllimi i njohjes së *drejtimit letrar* në përgjithësi dhe e çdo drejtimi letrar në veçanti?

Këtyre pyetjeve përgjithësisht kritikët letrarë u janë përgjigjur në mënyrë individuale, sipas interesimit për njërin apo tjetrin drejtim letrar. Ndërsa në mendimin teorik të realizmit socialist janë përcaktuar, si tipare të dallueshme, pikëpamjet politike dhe pozita sociale e shkrimtarëve socialistë nga ata të drejtimit ‘realist’.

Në historinë e letërsisë mund të vërehen dy tendenca:

- Njera i sheh drejtimet letrare nga pikëpamja tipologjike, duke iu referuar kushteve historiko-konkrete, në të cilat lulëzon një tip i caktuar i krijimtarisë. Këtë e shtrijnë në të gjitha epokat.

- Përfaqësuesit e tendencës tjetër e shohin drejtimin letrar si një formim dhe grupim shkrimtarësh, real, konkret-historik. Sipas tyre, estetika, principet artistike dhe krijimtaria e këtyre shkrimtarëve, si rrjedhim edhe drejtimi në të cilin janë bashkuar, shpjegohen me kushtet historiko-konkrete dhe llojin e problemit që ata duhet të zgjidhin.

Cilit grupim do t’i qaseshim ne? Besoj se specifika e formimit të realizmit socialist kërkon qasjen në të dyja tendencat e mësipërme. Në përcaktimin tipologjik të tij ka shumë shpjegime, si nga studiuesit të sotëm rusë, nga studiues letrarë perëndimorë dhe amerikanë.

Por mendoj se, nga pikëvështrimi teorik, do të duhej të ndalemi në çështjet: a është realizmi socialist **drejtim letrar**, sipas asaj brendie që mbart vetë koncepti teorik mbi drejtimin? Ku qëndron dallimi me drejtimet e mëparshme: në aspektin politik, apo estetik, kur nga studiuesit tanë, por edhe të huaj, ky dallim është përcaktuar vetëm në aspektin politik?

Detyra e studimeve të sotme është të përcaktojë nëse ka kritere estetike në këtë program letrar? Sigurisht nuk është e nevojshme të risjellim një për një ato kërkesa, që njihen prej të gjithëve, por që, në fakt, pothuaj asnjë nga këto parime jashtëletrare (partishmëria komuniste, heroi pozitiv, karakteri kombëtar e popullor...), nuk i përkasin sferës estetike. Ato nuk strukturojnë një **program estetik**, që është tipari thelbësor për një **drejtim letrar**.

Sigurisht, çdo drejtim letrar, për shembull romantizmi francez, lindi mbi bazën e një ideologjie të re, që lidhej me ndryshime të rëndësishme që po ndodhnin në jetën politike e shpirtërore të shoqërisë franceze. Por programi ishte **estetik**, se i referohej artit! Edhe letërsia jonë e realizmit socialist, sigurisht, pati një shtrat të ri të situatës politike-sociale-shpirtërore (si në gjithë

vendet e sistemit komunist), por ky program nuk i kapërceu kufijtë e ngurtë politikë, për t’ju qasur aspekteve estetike, që e bëjnë një vepër të quhet dukuri arti. Disa tipare estetike, që i kish proklamuar drejtimi realist, ndonëse duket sikur mbështeten nga letërsia e realizmit socialist, në të vërtetë janë demagogji, ose shtrembërime flagrante. Mjafton të kujtojmë parimin teorik të ‘pasqyimit me besnikëri’ të realitetit, dhe atë çka kuptohej me ‘realitet’ në doktrinën imponuese të partisë që drejtonte proceset krijuese. Apo kuptimin mbi heroin pozitiv, një ndër konceptet më deformuese, që iu largua katërcipërisht parimit të realizmit: ‘personazh tipik në rrethana tipike’, duke e futur heroin në skema të ngushta, ideore partiake.

Duke ndjekur këtë arsyetim, do të thonim se përgjigjen se, ç’lloj drejtimi letrar ishte kjo letërsi mund ta gjejmë tek vetë emërtimi “realizmi socialist”. Termi i parë nuk i përgjigjet konceptit të vërtetë të realizmit (që teoricienët demokratë rusë të shekullit XIX e kishin përcaktuar qartë). Ajo letërsi, që ishte vërtetë e realizmit socialist, nuk kishte asgjë të përbashkët me realizmin, ajo ishte vështrim ndryshe, i imponuar, i asaj që pretendohet se i përkiste realitetit, ajo nuk rrespektonte logjikën e brendshme të zhvillimit të këtij realiteti, apo edhe të heroit që përfaqësonte këtë realitet. Ndërsa termi i dytë, ‘socialist’, i përgjigjet thelbit të asaj letërsie, e cila i shërbentë ideologjisë socialiste. Pra, midis dy termave, i dyti shpreh një përmbajtje reale, ndërsa bashkimi i të dyve është artificial, i ardhur që nga teoria sovjetike, e cila pretendonte se ishte zhvillim më i lartë se realizmi. Ky ‘zhvillim më i lartë’, sipas saj, i përkiste aspektit ideor. Por, mbetur vetëm në këtë aspekt, koncepti i drejtimit letrar ka humbur pjesën thelbësore, **programin estetik**. Atëherë do të thonim se, në gjykimin e realizmit socialist, **si drejtim letrar**, duhet të njohim këto dukuri:

- Në emërtimin e plotë termi ‘realizëm’ është i fallsifikuar, nuk i përgjigjet parimit të rikrijimit të realitetit dhe formësimit të personazhit. Nuk ka asgjë të përbashkët me parimin artistik të letërsisë *realiste*. Ndërsa termi i dytë, ‘socialist’, i përgjigjet plotësisht konceptit të kësaj letërsie, përqendruar kryesisht në anën ideore të saj. Gjithashtu mund të thojë se termi ‘socialist’ nuk i referohet thjesht aspektit sociologjik (sepse letërsia realiste e ka thelbësor këtë tipar), por ka të bëjë me ngjyrimin e veçantë të letërsisë, që nxorri në plan të parë një ideologji të re, atë komuniste.

- Ky bashkim termash, i pasaktë, ndoshta do duhej të zëvendësohet me emërtimin ‘letërsia socialiste’, që përputhet me drejtpërdrejtë me natyrën e kësaj letërsie.

- Në këtë mënyrë, mbas drejtimit letrar të ‘realizmit’, në historinë e përgjithshme të letërsive,

duhet pranuar se u shfaq drejtimi i ‘letërsisë socialiste’, tipar themelor i së cilës është mbizotërimi i ideologjisë komuniste, udhëhequr nga parimet ideore të partisë.

- Do të ishte, ndoshta, detyrë thelbësore e mendimit teorik të kohës së sotme, të

studiojë gjithë këtë prodhim të gjerë letrar, pikërisht në aspektin e saktësimit të drejtimit letrar, të cilit i përket. Në aspektin e përballjes me drejtimet letrare paraardhëse! Për shembull, dihet se edhe klasicizmi ishte një drejtim letrar me parime të caktuara estetike, të cilat shkrimtarët ishin të detyruar t’i respektonin... Në vështrim të parë duket se edhe klasicizmi, me parimet e shpallura të tij, është po aq dogmatik sa dhe realizmi socialist. Megjithatë, të përbashkëtat dhe dallimet i shoh në disa aspekte:

1- ndërsa klasicizmi ishte nën ndikimin e filozofisë racionalistë të Dekartit, realizmi socialist është pjellë e filozofisë marksiste;

2- ndërsa i pari reflektonte një ideologji *mbarënjëzore*, i dyti ishte pjesë e luftës për mbrojtjen e një pushteti klasor, në një fazë të vetme të letërsisë botërore.

3- Ndonëse ngrihen mbi baza filozofike-ideore, dallimet në sferën e poetikës janë të dukshme: ndërsa klasicizmi përcaktonte disa kritere estetike të konceptimit të veprës, realizmi socialist, i rrëmbyer pas ideologjisë partiake, nuk ndalet, pothuaj fare, në *parime estetike* të ndërtimit të veprës artistike.

4- Vetëm nga një krahasim i përciptë i këtyre dy letërsive, mund të arrijmë në konkluzionin se letërsia e realizmit socialist është një drejtim letrar i veçantë, që ngrihet jo mbi program estetik, siç ka ndodhur me letërsinë e periudhave të mëparshme, por mbi programe politike.

5- Ndonëse në programin teorik mungojnë parimet estetike, në të vërtetë, ky aspekt realizohet në qëndrimin kritik që mbajtën kritikët letrarë të këtij drejtimi kundër letërsive moderniste, ‘borgjeze’, jo vetëm në anën ideore të tyre, por edhe në elemente të poetikave të brendshme. Kjo do të thotë se, nuk pohojnë kritere të mirëfillta artistike, por pohojnë se cilat kritere duheshin luftuar. Kështu, sipas mendimit tim, koncepti bazë teorik i këtij drejtimi letrar ishte: **jo si duhen konceptuar artistikisht veprat letrare, por si nuk duhet të jenë artistikisht** ato. Ky tipar përbën një dallim thelbësor me të gjitha drejtimet letrare paraardhëse.

Drejtime të tjera letrare brenda periudhës së realizmit socialist?

Shpjegimi i sapo dhënë nxjerr, natyrisht, këtë çështje, që lidhet edhe me pyetjen se a mund të ndodhë që një letërsi 50 vjeçare të zhvillohet vetëm sipas një drejtimi të caktuar?

Nisur nga vetë thelbi i letërsisë dhe raporti special që ndërton ajo me ndjeshmërinë njerëzore, do ishte jashtë logjikës letrare të pranojmë se letërsia e jonë, në çdo fazë të zhvillimit, është e njëtrajtshme. Një përgjigje, tepër kalimthi: elemente të realizmit kishim gjetur në poezitë e shekullit XVIII të Hasan Zyko Kamberit, ndonëse realizmi, si drejtim i konsoliduar, nuk ishte shfaqur jo më në letërsinë tonë, por as në atë evropiane; apo, letërsia e fillimit të shekullit XX, që po shkonte drejt realizmit, mbarte me vete elemente të romantizmit dhe

sentimentalizmit të vonuar, diku elemente të neoklasicizmit, dukuri të simbolizmit, etj., ndonëse asnjë nga këto shfaqje nuk arritën të konsolidohen në drejtime letrare të plota. Diskutimi më interesant, në këtë drejtim, do të ishte marrëdhënia e letërsisë së periudhës së realizmit socialist edhe me modernizmin. Dihet se ndikimi i modernizmit në letërsinë e një vendi nuk është i njëlojtë në kohë të ndryshme. Në letërsinë tonë, të gjysmës së dytë të shekullit XX, ai mund të konsiderohet si një fllad i dobët, që tentoi të futej, pa bujë, në ndonjë vepër të veçuar. Pas viteve '70 prirje moderniste shfaqen në poezitë e Kadaresë, Xh.Spahiut, F.Arapit...., por asnjëri prej tyre nuk mund të çlirohej plotësisht nga realiteti jetësor dhe letrar, nuk mund të mohonte letërsinë, as atë që kish krijuar vetë, sepse nuk ishte në atë fazë të imagjinatës artistike.

Në mënyrë virtuale, kishte dalë një kontradiktë, ndoshta ende e pavetëdijshme, midis *kuptimit ideor* të letërsisë dhe *kuptimit estetik* të saj. Kjo dukuri dëshmon : nga njera anë, forcën e intuitës së brendshme të krijuesve të veçantë, që nuk komandohet as nga vetë shkrimtari; nga ana tjetër, provon se shfaqja, sado sporadike e një dukurie letrare, i nënshtrohet ligjshmërive të brendshme të zhvillimit të vetë letërsisë, pavarësisht dogmave imponuese.

Ekzistojnë ligjshmëri të brendshme të zhvillimit të botës shpirtërore-krijuese, të cilat nuk mund të mbahen plotësisht të mbërthyer vetëm në një drejtim. Atë që një shkrimtar nuk dëshiron ta bëjë me vetëdije (për shkak të presionit...) e bën intuita, marrëdhënia e tij intuitive me problematikën njerëzore. Sigurisht ky dualizëm nuk ndodh të autorët mediokërr, por te artistët e vërtetë, që nxitja u vjen e brendshme.

Trajtimi i gjithë krijimtarisë, gjatë viteve '45-'90, si e letërsisë së realizmit socialist, jo vetëm në kritikën e shkruara para dhe pas '90-ës, por edhe në tekstin akademik "Historia e letërsisë së realizmit socialist", është një deformim i realitetit letrar, është dhunim i llojshmërisë së parimeve estetike, që u mbështetën në krijimtarinë e autorëve të ndryshëm.

A mund të përdorë një drejtim letrar parime artistike të një drejtimi tjetër ?

Ky problem del, konkretisht, tek marrëdhëniet e drejtimit të *realizmit socialist* me parime e mjete artistike të *realizmit*, apo *romantizmit*. Natyrshëm lind pyetja : a do të pranojmë se nuk ka mënyra e mjete artistike që e dallojnë letërsinë e realizmit socialist nga realizmi, apo romantizmi ? Apo këto dallime ekzistojnë ? Këto pyetje nuk janë të rastësishme; ato diktohen nga prirja, e tërthortë, për të kanonizuar format letrare të realizmit socialist, për trajtimin dogmatik të metodës krijuese.

Si në çdo koncept, që ka të bëjë me thelbin e letërsisë së realizmit socialist, edhe në këtë aspekt ekziston një kontradiktë, madje naive. Nga njera anë në mendimin teorik pohoj se realizmi socialist pranonte forma artistike të drejtimeve të tjera, nga ana tjetër parimet krijuese ishin rigorozisht të kontrollueshme.

Sigurisht ka forma artistike që janë karakteristike për të gjitha llojet e drejtimeve letrare. Janë parime që i përkasin vetë letërsisë, në çdo periudhë të lulëzimit të saj. Por, siç dihet, parimet estetike të ndërtimit të veprave letrare, historikisht kanë ndryshuar, duke afirmuar drejtime të reja letrare. Kjo do të thotë se, mjetet e organizimit të sistemit figurativ të letërsisë, gjatë rrjedhave artistike, ndryshojnë në funksionin e tyre. Nga ana tjetër, ato fitojnë rëndësi të ndryshme, në vartësi të drejtimit letrar të cilit i përket letërsia.

Në letërsi nuk mund të ketë kurrë forma të pastra, gjatë gjithë kohës. I pandryshueshëm është *konvencioni*, si thelb i letërsisë. Të ndryshueshme janë *format* e këtij konvencioni.

Marrëdhënia midis këtyre konvencioneve duhet parë në pranimin e dy fakteve të ekzistencës dhe jetës historike të sistemit letrar. Nga njera anë- ndikimi i tërthortë i realitetit në letërsi, i cili nga teoricienët

materialistë-marksistë është quajtur 'faktor formëformues' .Nga ana tjetër- roli i traditës letrare, e cila, gjithashtu konsiderohet si një faktor tjetër formëformues. Kjo do të thotë se forma zotëron një logjikë të brendshme zhvillimi, sa e ndërvarur nga forma paraardhëse, aq edhe e veçantë për krijime të reja. Kjo do të thotë se thelbi i tipareve të një drejtimi letrar lidhet me vendosjen e formave artistike, që veprojnë si forca lëvizëse të brendshme, prirja e të cilave është gjithnjë drejt ripërtërimit të vazhdueshëm. Në tre rrethe që kryqëzohen : Realizmi/ Romantizmi/Modernizmi, ka elemente dhe parime krijuese të përbashkëta, të cilat i përkasin vetë **sistemit letrar**, në përgjithësi; por ka edhe elemente specifike, që i përkasin **drejtimeve letrare të veçanta**. Pra, ato forma artistike, që duket se kalojnë nga njeri drejtim letrar te tjetri, i përkasin letërsisë, *si letërsi!* Ndërsa dallimi i formave të realizmit socialist, nga drejtimet e tjera, i përket mikrosistemit të këtij drejtimi, parimeve që e dallojnë atë nga ato letërsi.

Kjo çeshtje e rëndësishme, nuk është trajtuar deri tani në studimet letrare mbi realizmin socialist, jo vetëm shqiptar, por të gjithë sistemit komunist. Nëse duam të përcaktojmë qartë se ç'ishte letërsia e realizmit socialist, duhet ta përqendrojmë qasjen tonë në dy aspekte themelore : mbi ç'poetikë artistike u ngrit kjo letërsi ? Cili është raporti i poetikës së realizmit socialist me poetikat paraardhëse ?

Përpjekje pas '90 për krijim të një Manifesti të ri letrar

Kundërvënja e ashpër ndaj parimeve krijuese të realizmit socialist, pas vitit '90, solli tek një brez i ri krijuesish idenë për të shpallur një Manifest të ri krijues. Dukej ide shumë interesante, e nxitur nga ndryshimet politike në vendin tonë. Kishte ndodhur, më

shumë se dy shekuj më parë, me shkrimtarët romantikë francezë, të cilët iu kundërvunë klasicizmit, duke i konsideruar parimet e tij krijuese si pengesë për lirinë e frymëzimit poetik. Drejtimi i ri u konfirmua në një **program** të qartë, që pati mbështetje nga shumë shkrimtarë dhe, gjatë viteve më pas u konfirmua, përmes krijimtarisë artistike, në vende të tjera evropiane.

Por, çfarë ndodh në Shqipëri, menjëherë pas përmbyssjes së rregjimit komunist ? Në vitin 1991 shfaqet shoqata RA (Rinia dhe Arti), e cila u prezantua me antologjinë poetike "O moj Shqipni dhe lirika të tjera" si dhe bëri përpjekje të afirmohej me gazetën e vet "E PËR-7—SHME". Ishte një dukuri interesante, entuziazmi i një grupi poetësh të rinj, që synonin të afirmonin një lëvizje të re letrare. Jehona që e shkurtër ; autorët, në mosha të reja, nuk arritën të imponohen në mendimin dhe letërsinë e kohës. Ishte paaftësia teorike dhe, sidomos, mungesa e përvojës, për të shkruar drejt konfirmimit të qëndrimi të ri krijues. Grupimi i poetëve të talentuarve, që aspironin të sillnin diçka të re, shpejt u shpërbë, për të vazhduar secili, në mënyrë të pavarur, karrierën e vet krijuese.

Disa vite më vonë, në gazetën letrare 'Ars', 28 mars, 2004, rindizet dëshira për të shkruar drejt krijimit të një Manifesti të ri letrar. Por,fryma tepër agresive që përcolli kjo gazetë, në disa shkrime të veçanta, zbehu, ose la jashtë vemendjes , çeshtjen interesante që shtrohej në disa shkrime të saj. Botuesi, I. Jubica, duke pohuar se u nisën jo për t'i shpallur luftë dikujt, por vetëm për përkrahjen e një letërsie të re, shkruan, në nëntitull të veçantë, 'Koha për manifest' : "Me kalimin e kohës e kupton se më e keqja e së vjetrës – ajo që kurrë nuk do të mund të fitojë statusin e dëshiruar të traditës - nuk ikën vetë; ajo duhet të hidhet tej, për t'i lënë vend tjetrës, siç ka ndodhur kur njëra rrymë letrare binte, ngaqë i bënte presion lindja e një tjetre....Ndoshta ka ardhur koha

të hartohet një dokument, një tekst, ndoshta një manifest për letërsinë, që – sigurisht nuk do ta përmbyse me revolucion, me fjalime përpara turmave të ekzaltuara, regjimin letrar në fuqi, por do ta ngrejë në rrang institucioni zërin e refuzimit, të protestës publike ndaj të shpallurve përfaqësues të letërsisë së sotme shqiptare, që janë njëkohësisht edhe ata të vjetrit. Po, ka ardhur koha për një manifest letrar" (*Irhan Jubica "Nuk është kurrë vonë për një manifest letrar", Ars, 28 mars 2004*)

Autori bën thirrje të bashkohen me *Arsin* ata që mund të ofrojnë diçka për këtë manifest, por nuk qe ende e qartë dilema "kush do ta bëjë këtë manifest?". Vështirësinë e gjen te mospërputhja e aftësisë së tyre me klimën mbizotëruese, sepse mendohej se të gjithë ata që kishin shkruar deri në atë kohë, që jetonin akoma, ishin 'sorealistë...', pra nuk mund të bëheshin pjesë e realizimit të këtij misioni. Vazhdimi i trajtimit të çeshtjes së hartimit të një manifesti të ri letrar, edhe në numurin e mëpasshëm të gazetës *Ars*, ishte, për mendimin tim, një ide origjinale, e vlefshme, që do të duhej të përfshinte në diskutim studiues, shkrimtarë dhe artistë. Pse nuk ndodhi kjo ?

- Sepse vetë gazeta *Ars*, kishte investuar keq reputacionin e saj, në disa shkrime, në të cilat autorët rrëmbeshin në vrullin e sulmeve dhe fyerjeve , që nuk ka asgjë të përbashkët me debatin e vërtetë shkencor.

- Sepse, disa autorë kishin menduar, gabimisht, se mund të bëheshin persona të rëndësishëm në këtë moment politik e kulturor, duke u shfaqur kritikë po aq të egër e të politizuar sa paraardhësit, në periudhën e komunizmit.

Sigurisht, ishte shkruar edhe se nuk synonin të mohonin gjithshka, se "ne duhet t'u sqarojmë njerëzve se s'kemi ndërmend 'të vrasim' njerëz, por të marrim qëndrime për çdo dukuri me të cilën ndeshemi dhe që mendojmë se duhet shqyrtuar (pa kompleks), se jemi kundër KORNIZAVE, duke mos e duruar imoralitetin e atyre që mbrojnë letërsinë e fundit të realizmit socialist dhe vlerat e dyshimta të saj..." (*Ars, 25 prill 2004*). Por , nuk kish mbetur asnjë krijues, studiues e kritik pa u sulmuar e fyer. Një frymë e tillë, në fillim të shekullit XXI, në një vend, që ishte i etur për diskutim të lirë, pa paragjykime dhe me respekt reciprok, ishte shumë lodhës !. Ndërsa rubrikat që i kushtoheshin botimeve të letërsisë bashkëkohore, të huaj dhe krijues shqiptarë të rinj, ishin mjaft interesante, fashikulli i kritikës, jo vetëm që nuk arriti të tërheqë autorë e studiues të Shqipërisë dhe të Kosovës, por i bëri indiferentë ndaj saj. Forcat krijuese qëndruan larg, jo nga frika, siç mund të jetë shprehur dikush, por shmangën këtë komunikim jo profesional. Kjo nuk duhej të ndodhte, sepse, megjithë pohimet e botuesve për 'bashkëpunim', për marrjen pjesë në debat, ata e kishin humbur shansin që këtë gazetë ta bënin një organ të vërtetë debati, rrahesh mendimesh, si për traditën letrare gati 50 vjeçare, ashtu dhe për drejtimin që po merrte letërsia e pas '90-ës. Duke vlerësuar dëshirën për të hapur debatin, mbi një Manifest të ri letrar, mendoj se roli i kësaj gazete do të kishte mbetur i spikatur, nëse në diskutimin teorik (jo më politik) për zëvendësimin e drejtimit letrar të realizmit socialist me një drejtim tjetër, që duhej të institucionalizohej në një manifest letrar (siç ka ndodhur në gjithë historitë e zëvendësimit të një drejtimi letrar me një tjetër...) do përfshinte specialistë të letërsisë, shkrimtarë e kritikë të gjithë brezave.

Pse nuk pati jehonë ideja e diskutimit të një Manifesti të ri letrar ?. Mendoj se ishin disa shkaqe kryesore :

E para, paqartësia teorike, moskuptimi i faktit se manifestet letrare janë **programe estetike**, që përcaktojnë parimet estetike të konceptimit të letërsisë dhe ndërtimit të veprës letrare, që u kundërvihen parimeve estetike të letërsisë ekzistuese. *Së dyti*, diskutimi i gjerë do të duhej të hapte një çeshtje themelore mbi **rrugën drejt së cilës po shkon letërsia**. Ç'është letërsia sot ? Moderniste, simboliste, ekzistencialiste etj..? Të gjitha këto drejtime letrare janë

(*Vijon në faqen 4*)



Vijon nga faqja 3

konfirmuar në shekullin e kaluar, me manifeste letrare, nga përfaqësues të shquar të letërsive të ndryshme. Atëhere: cili drejtim letrar do ta zëvendësojë realizmin socialist? A ka shenja se letërsia jonë ka marrë, ose duhet të marrë një **drejtim të ri**, të panjohur në zhvillimet e letërsive evropiane, dhe, mbi këtë bazë, shkrimtarët, ata që janë në ecurinë e këtij procesi, hartojnë një manifest, që do të reflektojë pikërisht këtë tendencë? Nuk ka ndodhur kurrë që letërsia shqiptare të paraprijë drejtime letrare që nuk kanë lulëzuar në vende të tjera. Përkundrazi, shumë drejtime letrare nuk kanë arritur të lulëzojnë fare, ndërsa të tjerë (klasicismi, romantizmi, realizmi, modernizmi, postmodernizmi...) kanë ardhur vonë në letërsinë tonë. Atëhere çdo përfaqësonte ky manifest? Thjesht kritikë, mohim të parimeve të realizmit socialist? Sepse manifestet letrare kanë dalë për t'iu kundërvënë letërsisë ekzistuese, e cila nuk i përgjigjet më jetës shpirtërore të shoqërisë dhe bëhet e domosdoshme që ajo të orientohet drejt **parimeve të reja estetike**. Pra, manifesti është njëherazi: **kundërvënie dhe afirmim**!

Të hartosh një Manifest, i cili vetëm mohon trashëgiminë e realizmit socialist dhe nuk propozon një program estetik për zhvillimin e letërsisë, është tjetër gjë!

Por, edhe në këtë mision thelbësor të Manifestit, duhet të kemi parasysh se asnjë program subjektiv nuk mund të orientojë zhvillimin e letërsisë. Programet e drejtimeve të ndryshme letrare janë hartuar atëhere kur vetë letërsia ka dhënë sinjalin, modelin e një zhvillimi të ri. Kjo do të thotë se as kritikët, as teoricienët, nuk mund ta drejtojnë letërsinë, ajo ka zhvillimet e brendshme, që vinë si rezultat i ndryshimeve që ndodhin në jetën shpirtërore të shoqërisë.

Së treti, nëse në themel të kësaj lëvizjeje do të ishte vetëm lufta ideologjike, përsëri koncepti i Manifestit do të ishte i cunguar, dhe i përealizueshëm, sepse, çdo lëvizje letrare, e konkretizuar në një program estetik, i referohet në radhë të parë ndryshimeve të poetikës së brendshme të veprës letrare;

Së katërti, dëshira për hartimin e një manifesti të ri (siç e thashë ide interesante) nuk arriti të shtrihej në rrethet e gjera të krijuesve dhe studiuesve të letërsisë dhe arteve të tjera, në Shqipëri dhe Kosovë, për t'i bërë pjesë të këtij debati, i cili, pas viteve '90, do ngjallte një diskutim interesant për ecurinë e letërsisë dhe të studimeve letrare.

Vite, më parë, atëhere kur realizmi socialist mbizotëronte letërsinë shqiptare, proklamohej në gazetën Rilindja (1971) shkrimi: "Vox clamantis in deserto", i cilësuar si një *Manifest letrar*. Një grup krijuesish e studiuesish të rinj e të afirmuar (Hysni Hoxha, Ali Podrimja, Samedin Mumxhiu, Gani Bobi, Rexhep Ismajli, Eqrem Basha, Mensur Raifi, Anton Pashku) shpallnin, haptazi, qëndrimin kritik ndaj parimeve të realizmit socialist. Kjo gjeneratë e re nga Kosova provonte të sfidonte traditën **bashkëkohore letrare** të realizmit socialist, duke synuar t'i kundërvinin një **drejtim** tjetër avangardist, kundër dogmës socialiste, të mbrojtur nga disa shkrimtarë të kohës, të shprehur në "pesëdhjetë përqind të veprave letrare që botohen tek ne". Shkrimi kritikonte mungesën e kurajos të shumë shkrimtarëve, që i quan "realitetofobë", si dhe kritikën që është në rrezik të bëhet një zorrë qorre e letërsisë".

Ky shkrim kishte tagrin e një Manifesti, sepse i kundërvihet letërsisë dhe kritikës ekzistuese të realizmit socialist, sepse përfaqësohej nga emra që kishin sjellë dukuri moderniste në krijimtarinë e tyre, nga studiues që kishin afirmuar metoda të reja në interpretimin letrar. Pra, që kishin arsye të forta sociale e kulturore të rebeloheshin. Manifesti nuk flistë për një krijimtari të përfunduar, por për realitetin letrar të kohës së tyre.

Megjithatë, edhe ky shkrim, i cilësuar *Manifest letrar*, qëndron vetëm në aspektin e kritikës ndaj letërsisë dhe kritikës letrare, nuk përfaqëson një manifest me parashtrim kriteresh të reja për zhvillimin e letërsisë. Pse? Sepse letërsitë e vendeve evropiane dhe anglo-amerikane ishin futur me kohë në rrjedhat e letërsisë moderniste, me format e ndryshme të saj, me lirinë e krijimtarisë. Pra, ajo çka i mbetej letërsisë dhe kritikës shqiptare, ishte liria e krijimit, braktisja e parimeve dogmë të realizmit socialist.

Në të vërtetë manifestet letrare, në Shqipëri dhe Kosovë, mund vetëm t'iu kundërviheshin parimeve të realizmit socialist, për ta orientuar letërsinë drejt lirisë së krijimit. Letërsia kishte nevojë për krijues e kritikë të guximshëm. Ndërsa sot, detyra e studiuesve është tjetër: t'i japin kuptimin e vërtetë realizmit socialist, jo në aspektin e jashtëm politik (dihet tashmë!), por në qasjen dhe përcaktimin e parimeve estetike, që i përkasin ose jo thelbit të tij.

Fjalë me rastin e dhënies së çmimit për veprën më të mirë studimore në Panairin e Librit 2021

Marrëdhënia e Mid'hat Frashërit me librin

Nga Uran Butka



Vlerësimi nga ana e jurisë së panairit të librit 2021 me çmimin për veprën më të mirë studimore është një akt madhor, por edhe një domethënie për veprën e zgjedhur të Mid'hat Frashërit, e cila rrjedh nga një përcaktueshmëri genetike e hershme, nga një vullnet titanik, ndjeshmëri e lartë artistike, kulturë e gjerë evropiane dhe një mendje e ndritur. Ndoshta edhe një providencë, që vepra madhore e tij që i rezistoi kohës (shekujve 19, 20 dhe 21), përbaltjes dhe amnezisë shoqërore e politike, të rikthehet e të vlerësohet pas 140 vjetësh, kur është më i nevojshëm se kurrë.

Gjithashtu është një akt kulture, sepse vlerësimi i kësaj vepre vjen nga njerëzit e kulturës, nga juria profesioniste e librit, por vjen edhe nga vetë libri, i cili ia kthen borxhin, mundin e mirënjohjen të Zotit. Libri ishte qenia më e çmuar e Midhatit, madje edhe përpara lirisë apo që të çon te liria, mjeti i ndriçimit, ndërgjegjësimi dhe përparimit të një kombi.

Në moshën 17 vjeçare, djaloshi Frashëri, themeloi në Stamboll biblioteken personale "Lumo Skëndo", duke dëshmuar një mëvehtësi dhe një mendësi kulture vetiake, në mjedisin e rilindës dhe të bobliotekave të Abdyl, Naim dhe Sami Frashërit.

Botimet e para të tij ishin libra për shkollat shqipe, me të cilët fëmijët të mësonin gjuhën e mëmës dhe diturinë, si edhe përkthimet nga gjuhët e perëndimit të një letërsie artistike dhe edukative për të rinjtë, ndër të cilët edhe

"Vilhelm Teli", për të ngjallur ndjenjën e lirisë e të çlirimit kombëtar.

Si kryetar i Kongresit të Manastirit (1908) ai ka meritën që ndihmësoi për miratimin e alfabetit plotësisht latin të shqipes, me të cilin ai shtypi librat, gazetat dhe gjithë literaturën e mëpasme.

Më 1909 botoi revistën kuturore "Diturija", që vijoi për 20 vjet dhe ishte një libër i hapur për shqiptarët.

Haxhiqamilistët ai dogjën shtëpinë dhe bibliotekë në Elbasan më 1914, ku ishte mësues i shqipes, pas dorëheqjes nga qeveria e Ismail Qemalit. Më 1917, armiq të librit ia dogjën pasurinë librore, që e kishte sjellë nga Stambolli dhe e kishte vendosur për ta ruajtur në shtëpinë e Vrionasve në Berat. Atje, mes të tjerash, gjendeshin, sipas pohimit të vetë Mid'hatit, edhe dorëshkrimet e Abdyl Frashërit për Komitetin e Stambollit dhe Lidhjen shqiptare të Prizrenit.

Por ai as nuk u thye, as nuk iu nda librit.

Kur ndodhej në Evropë, në vitet 1914-1922: në Bullgari, Rumani, Gjermani, Zvicër, Angli dhe sidomos në Paris dhe Gjenevë, ku ai ishte kryetar i delegacionit shqiptar në Kongrëncën e Paqes dhe Lidhjen e Kombeve, ai shkroi dhe botoi veprat kryesore të tij si "Hi dhe Shpuzë", "Letra nga një udhëtim në Zvicër", "Rilindja shqiptare", "Shqiptarë e sllavë", "Rivendikimet shqiptare", "Çështja e Epirit", "Shqiptarët në vend të tyre dhe jashtë", "Për Shqipërinë" etj. Po ashtu, mblodhi nektarin e literaturës evropiane, bleu me shpenzimet e tij veprat më të mira veçanërisht botimet për Shqipërinë, shënoi në çdo cep të tyre vendin, datën dhe çmimin dhe i solli në Shqipëri. Kjo pasuri librore prej mëse 40.000 vëllimesh, e sekuestruar në në fund të vitit 1944 nga komunistët, ndodhet sot në Bibliotekën Kombëtare dhe në institucione të tjera private e shtetërore. Një sallë e Bibliotekës kombëtare sot mban emrin dhe botimet e Lumo Skendos.

Në vitet 1923-1926, kur ishte ambasador i Shqipërisë në Athinë, përveç mbrojtjes së fuqishme të çështjes Çame, ai nuk u shkëput nga libri dhe krijimtaria, madje prej andej dërgoi dhe botoi në Tiranë librin "Plagët tona", (1924) një vepër me karakter të theksuar sociologjik etj

Kur u kthye nga Greqia, pasi dha dorëheqjen si ambasador për faktin e shëmtuar kombëtar të shtetit shqiptar të faljes së Shën Naumit dhe të një pjese të Vermoshit -Jugosllavisë, bashkë me protestën midhatjane" Anjë pëllëmbë të mos japim nga trupi i mëmëdheut", Midhati u shndrrua nga diplomat, historian, shkrimtar, publicist, biograf, albanolog, bibliograf, përkthyes, kritik gjuhësor dhe letrar etj, në një librar të thjeshtë. Çeli në Tiranë librarinë "Lumo Skëndo", një vatër e librit dhe e kulturës shqiptare në vitet '30-'40, ku merrnin libra, por edhe shpjegime, udhëzime, komente, porosi për to nga librari Lumo Skendo për intelektualët, por edhe për të rinjtë, nxënësit, njerëzit e thjeshtë. Ndërkohë, Libraria "Lumo Skendo" kishte marrëdhënie me libraritë dhe shtëpitë botuese të vendeve kryesore të Evropës, si edhe me dijetarë dhe albanologë të shquar evropianë si Shuflai, Pedersen, Jokli, Roques, Majer etj

Jeta dhe puna në librarinë "Lumo Skendo" ishte periodha më e qetë dhe më e bukur në jetën e tij.

Vërshimi lirik i poetit Sadik Bejko, ashtu si rrjedha natyrale e një lumi të rrëmbyer, do të shpërfaqej i tillë që në ciklet e para botuar në shtypin e kohës. Vëllimi *Rrënjët* do të shenjonte për lexuesin e viteve '70 të shekullit të kaluar një përmasë të qenies, të palëvruar deri atëherë në lirikën tonë: tjetrin brenda vetes. Tjetri brenda vetes, apo uni lirik si përthyerje unësh, që do të pulsonte në krejt opusin poetik të mëpastajmë, ka zanafillë të vetën poezinë *Rruga* në vëllimin më të parë *Rrënjët*.

*Jam i zhveshuri,
i grinduri i vetes me tjetrin tim,
me veten që më ha pjesën e njeriut,
ha pjesën e asaj fytyre që duhet të jem unë.*

Në mënyra që nuk kanë nevojë të jenë doktrinale, poezitë e forta janë gjithmonë shenja të ringjalljes.¹ Lirika e Bejkos, përgjatë një periudhe gjysmëshekullore, ngjizet si një tëhuajëzim trajtash e himnesh. Një lloj tëhuajëzimi që ka në thelb dramën e vetes që i ha pjesën e njeriut dhe njeriun që thur e shthur himne të rrezikuara prej të papriturave të udhës. Uni lirik herë përthyeret në kufijtë e vetes e herë në kufijtë që vetja prek/rrezikon/rrezikohet prej tjetrit. Vetë poeti e përshkruan në këtë mënyrë këtë proces: “Ekzistenca e vënë në tehun më të fundmë, deri në perin e hollë jetë a vdekje, më ka ndjekur.”²

Shenjat e ringjalljes, kur ekzistenca shtrihet në tehun më të fundmë, patjetër se përpigjen të robërojnë vdekjen. Përmendim në këtë kontekst lirikat *Ura mbi terr*, *Hone të mëdha*, *Drita e parë*, *Degë të thyera*, *Në mjegull*, *Pusi*, *Muzgu i murosjes*, *Sy të vdekur*, *Fëmija lakuriq*, *Binjaku*, *Rendim pas frymës*, *Në ballkonin e natës*, *Shtyllë dheu*, *Profeti i pasmesnatës*, si edhe plot të tjera të ngjashme me to për nga fryma ekzistenciale dhe vegimet ngjethëse. Lexuesi model thith lartësi e humb peshë pas çdo rileximi. Asgjëmangut përtej shtegimitit në fjalë, uni lirik shpërthen nga kraharori gjëmën e thërrmuar të shpirtit dhe rrëfen secilën vete përballë vetes tjetër. Të rrëfyerit ka një funksion të dyfishtë: të rrëfyerit e shpirtit poetik për shpirtin e lexuesit dhe rrëfimin si akt shenjtërimi të tjetrit brenda nesh.

Tjetri brenda nesh në lirikën e Bejkos ka trajta të llojllojshme dhe disapak prej tyre janë: ky unë në padritë, në pagjumë, në pazë (*Ura mbi terr*), unë dhe ishulli me hone të mëdha në gjoks³ (*Hone të mëdha*), njëra vete që merr në shenjë veten tjetër, kur ajria të mpaket aq tepër, sa ty s'të takon më as vetja (*Hije apo kufomë*), shtangimi mes të ndërjit të unit herë njeri e herë burg (*Në mjegull*), odiseja e mbartjes së pambarimtë të një fëmije lakuriq askurrë të parituar, varur në gjoks, alegori e unit sizifian (*Fëmija lakuriq*), vetja binjake si vetreflektim i unit kohor dhe tejkohor (*Binjaku* dhe *Në ballkonin e natës*) dhe vetja e vërtetë (*Profeti i pasmesnatës*).

Shenjat e ringjalljes na rrëfejnë unin e përthyer në një seri unësh të tjerë, njësoj si një ekzistencë e shoh vetveten të trashëguar në ekzistenca të tjera të ngjashme apo të largëta në ngjashmëri. Me një të parathënë të pandryshueshme se edhe ngjashmëritë e tjera, sado të largëta qofshin, janë në fund të fundit pjesë e të njëjtit gjen që gjallon mbi të njëjtin truall. Bejko shtron dilemën e njeriut-gur apo gurit-njeri.⁴ Të dyja janë në thelb një tëhuajëzim i trajtës. Njeriu-gur apo njeriu drejt gurëzimit është uni pa shpirt, apo në humbje/përhumbje të shpirtit. Guri-njeri mbart në hovin e britmës së gëzimit rikthimin nga bota e të vdekurve, por ama me një vdekje të hershme brenda tij. Njeriut-gur i dihet udha e nisjes, por jo pika e mbërritjes. A do të ketë përherë bekimin e ringjalljes? Më shumë sesa imazhe statike, lirika e Bejkos ndjell vegime flurore në kujtesën e lexuesit të tij. Vegime që për çdo herë që i rikthehesh tekstit gjen aty, falë vallëzimit e pjalmimit të fjalëve, një tablo ku çdo detaj të avullon sapo bën përpjekjen e parë për ta fiksuar me sytë ngultas në të.

*Dua të të prek, në ngulç ulërij,
nën këtë verbëri mugu
drunjëzohesh: flokët gjethe, lëvorja prej trungu.*

*Folmë, folmë, të them, njeri a burg,
zembrën ta nisa si një kalë
të verbër si rrugë pa rrugë.*

Poezia kurrë nuk e harron plotësisht se si gjuha po përdoret, përmbushet, zhvlerësohet. Duhet të flasim më shpesh për procesionin e poezisë, i cili rikthen pafajësinë e gjuhës, që e bën gjuhën të jetë e dukshme përsëri.⁵ Bejko e përdor përherë gjuhën si për-mbushje të një gropimi diku atje tej me mjegull fjalësh. Për të zhvlerësuar gjithçka duket se ka një vlerë subline në shkrepitjen e parë fare të syve në tekstin poetik, por që në fakt nuk e ka. Duke i rifunksionalizuar fjalët, duket se i bën më të mjegullta kuptimet. Brenda këtij iluzionit optik ndodh tëhuajëzimi i trajtës. Për pasojë dhe tëhuajëzimi i himneve, si kredoja

Vepra poetike e Sadik Bejkos

POEZIA SI SHENJË

RINGJALLJEJE

Nga Alisa Velaj



shpirtërore e trajtës. Tëhuajëzimi si drunjëzim, gurëzim apo zgjim fantazmagorik (“unë dhe ai prej fantazme”)⁶ nis si metamorfozë me një dialogim të pakuptueshëm dhe të mjegullt mes dy unëve. Pamundësia e kryerjes së misionit të komunikimit si akt njohjeje sjell mjegullimin e situatës brenda poezisë.

*Folmë, folmë, të them, njeri a burg,
S'flas dot, thua, e tretesh si në makth-mjegull.*

Sapo poezia kodon heshtjen dhe misterin e efektit mjegull,⁷ pikërisht atëherë fjalët rifitojnë një tjetër konotacion. Thënë ndryshe, zhvlerësohet kur lexuesit fillon t'i shpërndahet tymnaja mjegullore dhe shoh se pamjet ishin të ndryshme nga ç'i kishte përfytyruar. Është ky çasti kur nis drama në perin e hollë jetë-vdekje. Ky lloj uni që ka gëlltitur një shufër dielli kthjellohet dhe gjuha fiton pafajësinë. Tashmë gjuha e re, krejtësisht e zhveshur dhe e rrezitur prej gëlltitjes, na zbulon pamjet reale. Gjendja e makth-mjegullës është gjendja e unit që vetëm arrin të burgoset. Në pamundësi absolute për ta shpëtuar veten nga mjegullimi si akt flijimi, me qëllim që ne qeniet e tjera bashkëvuajtëse të kuptojmë nga na vjen kërcënimi. Vargjet më lart, si jehona e zërit të një orakulli, apo uni të mbijetuar, na rrëfejnë se cila metamorfozë do të na ringjallte.

Ekzistenca e unit lirik të poetit e arrin pikën e saj më tragjike në kufirin hije-kufomë, ku vritet vullneti për të kundërshtuar dhe njeriu është larg lirisë së tij të vetëndriçimit. Njeriu-gur, i murosur jo prej etjes së vetëflijimit nën gurë, është një vete që shpërndan dhimbje dhe frikë.

*Po vjen muzgu, po vjen i tunxhtë, i betontë,
në gravurën e tij na fikson
mua, dridhjet e ajrit, blegërimën e deles,
parashikimet e reve
dhe zogun në çerdhen e njomë.* “Muzgu i murosjes”

Këtu nuk është më vetja që po ha pjesën e njeriut, por njeriu që i kanë ngrënë veten pa kuptuar. Simbolika e gurit shfaqet kështu sa e larmishme, aq përjashtuese. Guri si kujtesë, ndërsa uni lirik fiket te një gur nën urën-muzg, guri si proces gurëzimi, duke ngjizur njeriun-burg, guri si truall ekzistence, guri si shpëtim dhe guri si mallkim. Përsjastimi më i theksuem në gjuhë dhe në gjendje ndodh kur koha të muros pa kuptuar. Uni i kohës dhe uni i ajrit që të mbërthejnë jo sikur të jenë shëmbëlltyra abstrakte, trupa fizikë realë. Koha dhe ajri janë ekzistenca jote. Janë tjetri, jashtë e brenda qenies. Një jashtësi që projektton brendinë dhe një brendi e kushtëzuar nga kumtet e qenieve alegorike kohë dhe ajër.

...binjaku im, ajri im, ajri me gjembat-iriq.

Bejko shpirtëzon kohën, ajrin dhe gjithçka tjetër, me të tillë lehtësi që përshkruan një situatë poetike më pak “të komplikuar” apo situata të tjera, ku mesazhi i poezisë është më i drejtpërdrejtë. Gjendjet në poezinë e tij kthehen në shpirta dhe shpirtat trupëzohen me një alkimi fjale krejt spontane. Tjetri brenda nesh në lirikën e Bejkos përshkruan betejën e përjetshme të njeriut me të kundërtat e egos dhe shpirtit të tij. Poezia *Në ballkonin e natës* ka në thelb të saj dy koncepte të trajtuara gjerësisht nga filozofia dhe Shkrimet e Shenjta.⁸ Vargu “luftonte me dy që ishin një” dhe përcaktimet “unë dhe ai prej fantazme” japin trajtat e dy shëmbëlltyrave tek e njëjta qenie. E gjithë lirika e poetit në pjesën tjetër të saj është ose rravim i njeriut për gjetjen e lirisë së vetëndriçimit,⁹ ose jehonë e tjetërsimit të trajtës, himneve dhe psalmeve në kakofoninë e tmerrshme të korit të fantazmave. Bejko nuk është aspak sarkastik me dilemat ekzistenciale. Përkundrazi, ai i merr ato të mirëqena prej fillimit. Vegimet ngjethëse projektohen para lexuesit me një paanshmëri aq “të qetë”, sa habia filozofike e një mendjeje subjektive e me përjetime emocionale, në leximin e parë të poezive mund të jetë shpesh jo e vogël. Poeti ka imunitet të plotë ndaj të ngjethurave që japin vegimet.

Një shtyllë dheu – vegim ngjethës –

6 Vargu përmblylles i poezisë *Në ballkonin e natës*.
7 Mjegull “reale” si në këtë poezi, apo mjegull/mjegullim alegorik në poezi të tjera.
8 Bibla. *Dhiata e Vjetër* dhe *Dhiata e Re*. (2002). Romakëve 7: 18-20 dhe Efesianëve 6: 1-16, Tiranë: Shoqëria Biblike Shqiptare. Për ilustrim përmendim Romakëve 7:19 ku shkruhet: “Në fakt, të mirën që unë e dua nuk e bëj; por të keqen që sdua, atë bëj.” Vargu pasqyron luftën e vetëve apo të kundërtave brenda qenies. Në tekstin poetik kjo shndërrohet në përthyerje e disa e unëve brenda unit lirik.
9 Perifrazohen vargjet “Jashtë, domethënë brenda/ në lirinë time të vetëndriçimit” nga poezia Drita e parë.

*[...] Është rrënjë e lashtë e zbuluar në ajër,
është unë, është ti, është askushi?* “Shtyllë dheu”

Dilemat ekzistenciale janë konteksti ynë “normal”. Tragjikja qëndron në mahnitjen pas tyre, humbjen e vullnetit për të kundërshtuar dhe marrjen e vetes në shenjë. Kjo lloj qenieje shndërrohet në fantazmë dhe rrezik për tjetrin. Jo në tjetrin brenda nesh, por në qenien tjetër, si tjetrin brenda species sonë humane. Pikërisht këtij çasti qenia fiton peshë faji dhe pushon së thithuri lartësi.

*Pa sy qielli përsipër kisha mbetur.
Sa sy më paskan vdekur,
në sa sy të të tjerëve qenkam i vdekur!* “Sy të vdekur”

Zgjidhja e dilemës mes njeriut-gur apo gurit-njeri, lirisë së vetëndriçimit apo burgut të qenies, njeriut apo fantazmës, e merr “përgjigjen” e plotë në lirikën *Profeti i pasmesnatës*. Është lirika ku shenjat e ringjalljes janë më të forta se askund tjetër nga krejt lirikat që janë alegori e unit lirik si përthyerje unësh në rrezik tëhuajëzimi. Te kjo apologji poetike “ndokur greminë e vetes del mbi rrugë” dhe “vetja e vërtetë është kokëposhtë”. Sërish syri i ftohtë dhe të vetëmësuarit me rravimin mbi tehun më të fundmë në kufirin jetë-vdekje, që këtu jepet si një rrëfim në kohën ëndërr-realitit. Njeriu i vetëndriçuar i ëndrrës (si përmasë ekzistence transhendentale) i jep kumte profetike trajtës së tij fantazmagorike, ogurligë dhe të ankthshme. Janë gjendjet e greminta të vetes nën diellin e jetës dhe vetja e vërtetë në përmasën jashtë reale. Profeti që i shpifet në xham unit lirik është njëri prej atyre të dyve që luftojnë tek e njëjta qenie. Është gremina e vetes, së cilës i profetizohet se cila duhet të jetë vetja e vërtetë. Ajo vete e përmbytur dhe e ligështuar e përditshmërisë.

Profeti apo kumtet profetike vijnë në mesnatë. Sërish tehu më i fundmë mes dy kohërave. Pas mesnatës, sapo ajo kalon, lind mëngjesi i ditës tjetër dhe zgjimi real i zërit që na e rrëfen ngjarjen ndodh sinkron me lindjen e ditës tjetër. Një zgjim alegorik i vetes së vërtetë dhe i së vërtetës. Te koncepti i tjetrit brenda nesh, me betejat brenda unit, vetes greminë dhe vetes së vërtetë, Bejko ka jehona (jo fort të dukshme) të vizioneve mesianike gjithashtu. Mjaft të përmendnim se Mesia paraqitet në Testamentin e Ri si njëqind për qind njeri dhe njëqind për qind perëndi.¹⁰ Nëse veten profetike do ta analizonim si veten e vërtetë apo të perëndishme, në kuptimin e vërtetësisë dhe vetëndriçimit, ndërsa veten greminë si atdhe dilemash ogurliga, pa dyshim se poeti ka ndikimin e intertekstit biblik në poezinë *Profeti i pasmesnatës*.

Koha si realitet metafizik

Çdo poet ka në ashtnarin e universit poetik një raport të caktuar të unit lirik me kohën dhe anasjelltas. Një raport që nuk ruan asnjëherë të njëjten kahe, sidomos kur poeti rreket ta ngjizë kohën si realitet metafizik. Në këtë kontekst, Bejko pozicionohet në poezinë bashkëkohore shqipe si një poet shumë modern. Kjo e fundit referuar më së shumti lëndës poetike në funksion estetik dhe psikologjik. Lirika e tij më përfaqësuese përkap çastet kohore që rrendin përtej një vdekjeje dhe përtej një zgjimi. Vdekja mundet të jetë faktike, simbolike dhe alegorike, ndërsa zgjimi mbetet përherë vetëm alegorik. Në fund të fundit, asnjë poet modern nuk është unik, pavarësisht nga bindjet e tij të deklaruara. Poetët modernë janë domosdoshmërisht dualistë të mjerë, sepse ky mister, kjo varfëri, është pika fillestare e artit të tyre.¹¹ Misteri i përtejvdekjes dhe i përtejzgjimit ndërtohet përmes tri rravimeesh: së pari, qenia në një fragment kohe, së dyti, koha në një fragment të qenies dhe së treti, fragmente kohësh e qeniesh në një gjithësi ekzistence pandalshmërisht të pjerrët, honeve të shpirtave njerëzorë.

Qenia në një fragment kohe tkurret në lirika të natyrës: *Zogu në mbrëmje*, *Nata e fundit e deles*, *Babai në mbrëmje*, *Murgu i rrugës së madhe*, *Plak në grykë lumi*, *Rob në muzgje*, *Delet në dimër*, *Lepurushat në bar marsi* etj. Uni lirik shëtit nga një anktë në tjetrin, jo duke u

ligështuar prej tragjikes, por me një të tillë et për mosvdekje pas çdo elegjie të deklamuar, sa të duket se ajri i rralluar mbyll një cikël jete, për t'i hapur portat një dimensionit tejkohor. Qenia tkurret e tkurret aq sa duket se humb krejt, deri në çastin fatlum, kur ajri i rralluar bymehet saora dhe përtejvdekja çapitet jo pa mundim drejt përjetësisë.

*Erërat ta bëjnë daulle
mbi mal lëkurën prej reje.* “Nata e fundit e deles”

Nëse koha gjen kuptimin e saj te përjetësia, atëherë duhet kuptuar duke u nisur nga kjo e fundit. Me këtë, përfytyrohet pika e fillimit dhe rruga përpara në këtë hetim: nga përjetësia në kohë.¹² Tkurria e qenies alegorizohet përmes udhëtimit të një frymori në ajrinë mes dy botëve, ose në atë shkrepitje çasti që kryen kalimin prej një gjendjeje në gjendjen tjetër, e cila kur nuk qëllon të jetë “përjetësi reale” (si në vargjet e lartpërmendura), është patjetër një përjetësi alegorike. Kemi përgjithësisht një qenie reale (babai, murgu, plaku, robi), apo simbolike (zogu, delja, lepurushat), në një kohë kufitare (mbrëmja, nata e fundit, muzgu, dimri) dhe vendndodhje disi të paadrsuara nga pikëpamja e koordinatave të prekshme me shqisa konkrete (rruga e madhe, gryka e lumit, bari i marsit). Këto të fundit janë alterego po e kohës kufitare. Rruga, sado e madhe, herëdokur do të mbarojë dhe ka për ta shpënë murgun drejt një porte që e pret krahëhapur: dashurisë në formën më të epërme (*Në krahë të thatë, krok-krok korbi/ kam vënë dashuri*). Dashuria sfidon kështu vdekjen dhe fragmenti kohor ka bymyer qenien dhe kohën. Lumi nënkupton një krehde heraklitiane ujërave të tij. Asnjëherë nuk kridhemi njësoj, por në mbarimin e kohës (qenia drejt fundit të kohës tokësore) krehdja jo vetëm se merr një kuptim të ri, por duke kaluar nëpër grykën e lumit rravimi përmes një përfytyrimi fantastik bën që ajo, gryka, të jetë kufiri mes kohës dhe përjetësisë. Udhëtimi i plakut nëpër grykë është pika e fillimit të tij, çasti fatlum kur përjetësia e kap për dore në pikën e fundit të ajrit të rralluar dhe e përkund në një tjetër ajri plot oksigjen të rinuar. Sintagma “bar marsi” përcakton gjithashtu një kohë kufitare, kalimin nga dimri në pranverë, nga vdekja e natyrës në përtëritjen e saj.

Bejko i shëtit ankthet prej kohës në pakohësi, prej vdekjes në jetë, prej tokës në qiell, por asnjëherë në drejtim të kundërt. Andaj tragjikja në lirikën e tij e ndal sulmin e saj në atë çast të rravimit, kur duke ecur bie në honet e zgjimit.¹³ Rënia në këto hone, herë ndodh ashtu si pa kuptuar, herë duhen rravime të tëra të unit lirik, deri në harxhimin absolut të jetës së prekshme nga syri i vdekshëm. Përtejzgjimi fanepset ose si një vegim ngjethës përgjatë odisë së torturuese në kohën e trupit, ose në formën e një të ardhmeje profetike, të ndjellë prej tragjikes dhe vdekjes së pohuar faktike, apo asaj të nënkuptuar metafizike. Gjithësia poetike zvetënon çdo çast të qenies në një fragment kohe, duke shmangur plot kokëfortësi qenien fragmentare. Fragmentarizimi kohor (mbrëmja, nata e fundit, muzgu, dimri) shndërrohet në kundërrfragmentarizim të unit lirik. Ky fragmentarizim “i prekshtëm” kohor përplaslet pa kuptuar me kohën kufitare, me këtë të panjohur të papritur, e cila e çon po drejt një të panjohure tjetër. Për të cilën duket se lexuesi nuk është fare i papërgatitur, për sa kohë i është dëshmuar hapur se para syve të tij gjendet një frymor që përherë nxiton për diku.

Koha në një fragment të qenies ngjizet në atë pikë fillimi, kur përjetësia hyn në jetën e qenies apo në ajrinë e unit lirik. Kjo kohë plotnie bymehet në lirika të llojit: *Odise i malit*, *Dy orë blu*, *Rendim pas frymës*, *Djegagur* etj. Poeti rrok thelbet ekzistenciale duke i mbjellë si rrënjë të brishta në truallin e poetikës së tij dhe korr prej tyre këngë, në të cilat herë monologon “me zë të lartë” për t'u dëgjuar thekshëm prej lexuesit, herë dialogon me lexues-dëgjuesin e tij si me tjetrin brenda vetes. Koha e bymyer në këtë lloj lirike rrjedh e tillë prej fillimit. Aspak duke qenë më parë e mpakur dhe pastaj të fillojë procesin e të bymyerit. Është çasti kur uni lirik ka prekur themelin e së kaltrës së errët, ngjyrimin mbështjellës të qenies në fragmentin e saj të dhimbjes së skajshme, ku “si një odise i vetmuar në male, në skajin e tejmë të dhimbjeve”,¹⁴ nuk di më se nga t'ia mbajë. Gjithçka di është

1 Bloom, Harold. (1997). *The anxiety of influence, a theory of poetry*. Preface, The Anguish of Contamination. New York, Oxford: Oxford University Press, fq. 24.

2 Intervistë me Valdete Antonin, https://alb-spirit.com/2018/03/16/sadik-bejko-nje-malesor-brishte-kur-shkroi-rrenjet-e-denuara/.

3 Vramendja rrjedh natyrshëm drejt përfundimit se ishulli është tjetri brenda nesh, pasi përdoret njëjtsi i shenjesit gjoks, ndërkohë që bartësi janë dy (unë dhe ishulli).

4 Vargu ishtë njeriu-gur a guri-njeri i poezisë “Përralla”.

5 Hirsch, Edward. (1999). *How to read a poem and fall in love with poetry*. San Diego, New York, London: The Center for Documentary Studies in association with A Harvest Book Harcourt, fq. 12.

10 Bibla. *Dhiata e Vjetër* dhe *Dhiata e Re*. vep. cit, Gjoni 20:28, 1:1, 5:18, Isaia 9:6, Mateu. 1:23, Romakët 9:5, Filipianët 2:9, 1 Timoteu 3:16, Hebrejve 1:8. Për ilustrim marrim vargun biblik te Romakët 9:5, ku shkruhet: “Të tyrë janë edhe etërit, prej të cilëve rrjedh sipas mishit Krishti, i cili është përmbi çdo gjë Perëndi...”.

11 Bloom, Harold, vep. cit, fq. 35.

12 Heidegger, Martin.

13 Perifrazim i vargut “Në ecje bija në honet e zgjimeve” në poezinë *Sy të vdekur*.

14 Perifrazim i vargjeve përmblyllesë të poezisë *Odise i malit*.

se koha është më sublimi lajtmotiv, “përtej një vdekjeje dhe përtej një zgjimi”.¹⁵

*Vetëm sot, vetëm sot
preka themelin e së kaltrës së errët,
një blu të pastër nate,
qiell ngjashëm me ujin-det i kthjellët.* “Dy orë blu”

Këtë prirje për të funksionalizuar e për të sendërtuar artistikisht ashtet apo thelbet ekzistenciale të jetës gjithësisht Sadik Bejko e pati shfaqur qysh në krye të herës¹⁶ në krijimtarinë e tij poetike. Funksionalizimi dhe sendërtimi poetik ndërthuren me njëri-tjetrin si lënda me frymën, për të na e dhënë qashtërsisht e lakuriq shëmbëlltyrën e rrënimit në krejt çastet kohore kur lënda (qenia, uni lirik) e braktis frymën/rend pas frymës, apo vuan paplotninë si shkak i kohës së pamjaftueshme të blusë. Lirikat *Rendim pas frymës* dhe *Dy orë blu* janë ndër ato lirika fort të mrekullueshme që e rrokin katërçipërisht konceptin e kohës si realitet metafizik. Në lirikën *Rendim pas frymës*, e gjithë simbolika kuptimore sendërtohet mbi funksionin e sintagmës që i referohet “pamjaftueshmërisë së drunjtë” dhe trivargëshit¹⁷ “në shartimin e një shtylle qielli/ mbi një pemë/ a mbi dy këmbë njeriu”. Rrënimi vjen për shkak se shartimi ynë nuk kryhet me një shtyllë qielli, por me shtylla dheu. Qenia në alegorinë e pemës bëhet edhe vetë pamjaftueshmëri, duke u tkurrur në një fragment dhimbjeje të padurueshme, kur mpaket ajri i pane dhe themeli i blusë së thellë zëvendësohet me themelin e një peme në vyshkje, që ka ajër sa për një qukapik. Sintagma “vetëm sot, vetëm sot” në lirikën tjetër *Dy orë blu* përforcon idenë se ne qeniet që rendim ta kapërcejmë frymën para nesh,¹⁸ në vend që ta mbartim përbrenda, zgjohemi në perin e hollë mes jetës a vdekjes. Ekzistenca jonë rreh përherë në këtë hapësirë. Fluturime të tilla që rendin drejt plotnisë si “dy orë blu” (dhe jo tri orëve blu), pas ishujve të vetmuar, që veç një rrip toke do t'i kthente në gadishuj, janë alegori e ajrisë së ekzistencës si antipodi i vetmisë. Janë ambiguiteti i shenjuesit “mal”, i cili herë shenjon një kufi kohor e hapësinor mes tokës e qiellit dhe herë tempullin ku mediton e dëshmon uni lirik.

Fragmente kohësh e qeniesh në një ekzistencë të pjerrët honeve të shpirtit shfaqen në lirika, si: *Sy të vdekur, Zbehja e zogjve, Fytyrë e panjohur deri në qiell* etj. Ajo që sheh është lëvizje, diçka si gjendje transite drejt dekompozimit a, të paktën, shndërrimit në diçka tjetër, krejt tjetër nga ç’ka qenë dikur e që ti rrekesh me mendimin se nuk ka për të ndodhur me ty dhe e ndien se ndërkaq je bërë njësh me të, madje, se keni qenë gjithnjë kështu, pa e ditur.¹⁹ Mosdija nuk të bën as më të mirë dhe as më të keq. Ti bën thjesht më tragjik. Koha fragmentare del e projektuar si e tillë prej një uni lirik po aq fragmentar. Kemi njeriun që ka ikur tepër larg kohës dhe kohën që nuk njeh më veten. A është kjo koha që njeriu humbet, apo koha që e ka harruar njeriun dikur diku dhe nuk i kujtohet dot më? Koha e vërtetë është ajo *balonë flu* prej *bryme të ngrohtë*, që zgjeron kufijtë e shpirtit me et të pangjshëm për mosvdekje. Gjendja transite drejt dekompozimit të lë mënjanë kësaj kohe dhe kur ti e ndien se je bërë njësh me zvetënimin, nuk di më se ku të kapesh. Ky është procesi i zbehjes së ngjyrave, zbehjes së botës dhe zbehjes së kuptimeve. Koha është aty, por jo më për ty, në kuptimin e vetofrimit. Je ti që duhet të përfshihesh larg ajrisë së dekompozimit, të çash veten në dysh, pasi je bërë një me vyshkjen tënde. Është qenia që duhet të rilindë nga e para për të njohur fytyrat e tjera të ngjashme me veten. “Sa vjet dritë duhen për një sy të verbër?”²⁰ - klith uni lirik në monologimin dhe dialogimin e tij me të ngjashmit e vet të trishtë.

Koha e zvetënimit është gjendja transite që refuzon tranzicionin në një rravim torturues për të njohur tjetrën e saj të vërtetë. Hyn këtu koha e panjohur, e cila në lirikën *Fytyrë e panjohur* na vjen në formën e kohës mjegullore²¹ dhe në trajtë reale e të prekshme (anipse të pagjendshme). A thua se shtegtimi i qenies në kohë e bën të perceptueshme edhe kohën si trajtë reale.

*Ka një grimëherë bosh kur bie dita.
[...] Fytyrë e panjohur gjer në qiell.
Frymë e ajërt, që të josh, të ndjell.* “Fytyrë e panjohur”

Poezia përmbillet me lutjen e unit lirik: “Lutem, lutem, shfaqmu prapë, prapë!” Lutja si nevojë shpirtërore për shfaqjen e pandërprerë të një fytyre të panjohur nga toka në qiell nuk është gjë tjetër veçse dashja me afsh e sublimes për përmbushjen e një shpirti që është bjerrë nga drita dhe është hijezuar aty, “buzë më buzë me humnerën”.²² “Grimëkoha bosh kur bie dita” është ajo koha kufitare, nëpër të cilën

ndodh akti transhendental i përndritjes së honeve të errëta thellë nesh. Honeve me të cilat jemi bërë një person dhe deri pak më parë nuk ishim në gjendje as të kuptonim. Hapësira transhendentale bëhet edhe më e afërt në komunikimin mes unit lirik dhe Zotit në lirikën me atmosferë tejte ogurzezë *Zbehja e zogjve*.

*Zot, thashë, janë të mbaruar,
s’i hanë më qiejt e vjeshtës
me sqepat dhe me krahët e harkuar.
Fytprerë i gjen në ag.* “Zbehja e zogjve”

Jemi tashmë në një kohë të ngrirë. Njësoj si me ngrirjen e kohës në epos, kur ngrijnë krushqit, u ndalet kënga dhe udha popullohet me qenie as të vdekura dhe as të gjalla. Frymorët e ngrirë këtu janë zogjtë, simboli më i bukur i lirisë. Zbehet jeta dhe ngjyrat e saj i kalojnë vdekjes. Jeta është pa ngjyrë, ndërsa vdekja është e etur për këngë e hare zogjsh. Në këtë çast uni lirik merr rol mesianik në komunikimin që vendos me Zotin dhe përmbushjen e misionit për t’i komunikuar Krijuesit se deri në çfarë shkalle vdekja ka vrarë lirinë. Qeniet në alegorinë e zogjve kanë humbur peshën e jetës dhe mbartin atë të vdekjes, sepse kanë humbur aftësinë e të thithurit ajër lartësie. Duhet përherë qiell e ajër prej themelit të blusë më të thellë, që ekzistenca e qenieve të jetë kuptimplote, plot ngjyra jete dhe jo e mbushur me jehona të elegjive që ndjellin hijen e vdekjes dhe zvetënojnë shpirtat.

Sadik Bejko²³ ka një prirje gjenetike për të zbuluar shenja dhe kumte transhendentale edhe te dukuritë më të zakonshme të botës.²⁴ Në gjithë opusin poetik kemi një konfigurim të kohës së barit. Bari është jo vetëm bimësia që mugullon e vyshket nga një stinë në tjetrën, por edhe përkohshmëria tokësore që ringjallet në forma e kohë nga më të llojllojshmet. Poeti i thur psalmet e veta për njerëzit e tokës dhe bash në tokën e njerëzve u këndon drithërimave të barit. Atyre të brishtave dhe të paepurave, tek shpërthejnë pareshtur, plot guxim dhe ethshëm në toka pjellore dhe djerrina nga më të palumturat. Bari është jeta, vdekja dhe rilindja jonë shpirtërore. Koha e barit si alegori e çasteve të njerëzve të tokës është shenjuesi tokësor i asaj çka mundet ta pagëzojmë si transhendanca tokësore në këtë lirikë. Kumtet e transhendencës hyjnore i kanë farërat e tyre të mbjella pikërisht në këtë truall paraardhës. Në këtë lloj soditjeje të barit si gjenezë ekzistence në hapësirën mes tokës e qiellit, Sadik Bejko na vjen në letrat shqipe si një sivëlla shqiptar i poetit amerikan Walt Whitman.

Simbolika e zjarrit

Një nga simbolikat më shenjuese në lirikën e Bejkos është ajo e zjarrit. Për zjarrin shkruhet se kuptimet simbolike të tij në letërsi janë po aq të shumëfishta sa forma mund të marrë një flakë.²⁵ Në varësi të metamorfозës së kësaj flake, dritëhijet e fjalës herë e krijojnë botën sipas perceptimit të poetit dhe herë e shpërfaqin në gjithë dimensionet e bjerrjes së saj para shqisave të lexuesit. Këtu do të detajojmë vetëm disa shqisa: zjarri i Zotit në Bibël, zjarri i purgatorit, zjarri i Prometeut, i kulturës ose intelektit, dhe zjarri i pasionit (epshit dhe zemërimit).²⁶ Zjarri hyjnor përndrit shtresat kuptimore të lirikave të tilla, si: *Kënga e fundit për zjarrin, Drita e parë, Nga e nesërmja, Letër Hamurabit, Maja mbi Luzat, Djegagur, Thirrja e udhës* etj. Zjarri i diturisë, ashtu në pamundësinë e tij absolute për të mos u përzier me flakë të zjarrit hyjnor, shenjon kufijtë ekzistencialë mes kuptimit dhe moskuptimit. Kufij aq lehtësisht të ngatërrueshëm në krejt këto troje poetike. Përndriten këtyre flakëve

^[1] Sintagma “ky poet” në citimin original është zëvendësuar prej meje me emrin real të poetit

^[2] Jakllari, Adem. (2016). Mbi kodin e dyfishtë. Tiranë: Zambaku, fq. 72-78.

^[3] Ferber, Michael. (1999). A Dictionary of Literary Symbols. USA, Cambridge University Press, fq.72.

^[4] Ferber, Michael, vep. cit, fq. 72.


gjendje poetike pështjelluese në lirika të llojit: *Te zjarri, Hëna ime, Dhe prapë fillim, Hëna e zezë, Dritare në zjarr, Përbaltja e yllit, Psalm për atin* etj. Ndërkohë, zjarri i pasionit dashuror djeg e përvëlton në lirika, si: *Është dimër mikja ime, Qan një grua, Sytë e grave të gurit, Mos më lexo në mbrëmje, Magdalini* apo në plot poezi të tjera erotike, të përdezura nga dashuria në përmasën e saj shpirtërore apo në kufijtë e epshores.

Zjarri hyjnor në poetikën e Sadik Bejkos do të shfaqej për së pari më 1972, në vëllimin *Rrënjët*, i cilësuar si një nga kundërvëniet e pakta e të suksesshme poetike ndaj asaj furie skematizmi ku gjendej poezia shqipe e viteve ’70.²⁷ Kundërvënia e poezisë së Bejkos ndaj poezisë skematike të kohës do të dallohej nga prania e përmasës së shpirtërores në lirikën e tij. Në vëllimin e parë të poetit bie në sy poezia *Kënga e fundit për zjarrin*. Kjo këngë “e fundit” është në të vërtetë kënga e parë për simbolikën e zjarrit. Një këngë e parë që do të arrinte flakërimën e saj më të begatë në vëllimin *Letër Hamurabit*. Vëllimin më përfaqësues të autorit dhe një nga krenaritë e lirikës shqipe, botuar në vitin 1997 dhe vlerësuar shumë nga kritika zyrtare dhe jozyrtare gjithashtu. Poezia *Kënga e fundit për zjarrin* është një himn për qeniet e “përndritura nga zjarri”, ndërsa janë “të strehuara te zjarri”. Në këtë atmosferë duket se krijohen disa lloje asosacionesh. Ka pikësëpari një lloj dialogu të fshehtë me zjarrin, por që mund të merret edhe si një lloj dialogu me atë tjetrin brenda vetes. Atë tjetrin përndritur prej zjarrit.

*Ja, pllakos heshtja:
[...] Heshtnin, po së thelli një këngë agimesh
ti brambullije.*

Ka një enigmë se nga vjen kjo lloj flake që ngroh e mban larg lëngatën e errësirën. Përmes vezullimeve të dritës qeniet parashohin “agimet fantastike” të së ardhmes. Vargu hapësi i poezisë, “Zjarri digjet si një godinë e rubintë”, është një varg çelës për ta larguar vëmendjen thjesht nga ai zjarri i vatrës rreth të cilit ngrohemi sot e ngaherë. Zjarri është një lloj godine, një lloj shtëpie që po digjet për të përndritur banorët e saj. Në këtë poezi, kuptimet e zjarrit nuk janë vetëm të shumëfishta, por nganjëherë të paqarta: çfarë ngroh mund të digjet, çfarë ndriçon mund të të verbojë.²⁸ Zjarri ngroh, vetëdigjet dhe ndriçon/përndrit. Ky zë që digjet bashkë me zjarrin (“zëri i ndonjë gjyshi të urtë”), ky zë i zjarrtë, ky zjarr që digjet si një godinë apo kjo godinë/strehë që digjet dhe në këtë djegie përndrit qeniet rreth/brenda saj është pa dyshim zjarrmi prej një tjetër bote. Vetëm zjarri hyjnor është ai që digjet vetë për të të përndritur ty. Vetëm zjarri hyjnor “rrënohet e rrëzohet e brofëtin i guximtë”, pa mundur të shuhet si vegim. Akti i sakrificës në emër të sublimes, si një nëntekst shumë recesiv, është një nga dominantet e kësaj lirike. Për më tepër që kjo këngë për zjarrin cilësohet si “e fundit”. Ky cilësim duket se merr vlerën e një testamenti përndritjeje. Një lloj testamenti që në poezinë *Drita e parë* poeti e vulos me vargjet:

*Ndaj ngrihem herët,
me dëshirën për t’u kthjelluar
e rikrijuar në dritën e parë.*

Poeti shtegton “me besim te zjarri” (*Te zjarri*) dhe shkruan se “mendoj për ditën” dhe se si “njeriu më i bukur se një luledielli, rrotullohet nga drita” (*Nga e nesërmja*). Dy janë koordinatat që e mbajnë themelin e qenies në këtë poetikë; rrënjët dhe zjarri. Rrënjët sjellin vazhdimësinë tokësore ku poeti e sheh veten “si një truall të blertë, ku rrënjët zgjaten nga të tjerë”. Po në këto rrënjë, ku njeriu dhe bari, si simbole të përkohshmërisë, përkulen duke ushqyer rrënjët e njëri-tjetrit, nuk ka kuptim ekzistenca pa një këngë zjarri hyjnor. Përndryshe, qenia pushtohet prej kobit e errësirës, nën tingujt e këngës së zvetënuar të korbave (*pranojeni korb-ndivnesën*). Në një kohë që ekzistenca jonë, “jeta jonë” merr kuptim “përtej një vdekjeje dhe përtej një zgjimi”.²⁹ Pra, në një hapësirë përtej asaj që duket. Hapësira përtej projektohet në mënyrën e saj më të përsosur në poezinë *Letër Hamurabit nga murgari i shpellës Aram*.

Pse më tundon, zoti im, me sjellje të kësaj bote?

*Njerëzit këtu janë me nga një bodrum të zi,
me nga një hambar terri mbi shpinë dhe nën tru.*

Rrëfimi i murgarit që vjen nga shpella Aram, andej nga mpaket drita e diellit dhe bubulon në tru zjarri i të vërtetave, larg zvetënimit të qenieve të tjera me dritë dielli të plotë mbi krye, por me terr në tru, është alegoria lebetitëse e njeriut pa dritë nën dritë apo njeriut pa zjarrin e të vërtetave në kujtesë. Daljen në dritën e verbër apo ditën e të marrëve, murgari e përcakton si një tundim. Kjo botë me qenie të terrta e pa dashuri është një lloj ndjelljeje ndaj paditurisë dhe ftesë ndaj zjarrit që duket se ndriçon (dritë e plotë dielli jashtë shpelle), kur në fakt ajo çfarë ndriçon, në këtë rast mundet të të verbojë. Mpakja e dritës, apo drita që verbon është një

^[5] Shënim i botuesit Gentian Çoçoli në përcjellje të ribotimit të librit me poezi Rrënjët më 2002 nga “Aleph”. Ky ribotim do të vinte 30 vjet pas botimit të parë më 1972 nga “Naim Frashëri”.

^[6] Ferber, Michael, vep. cit.

^[7] Kjo fjalia dhe mbyllja e fjalisë paraardhëse perifrazojnë vargje nga poezia Djegagur.

lloj habitati binjak me një tokë të shtetur nga dashuria.

Zjarri i diturisë, apo shenjuesi i kufijve ekzistencialë mes kuptimit dhe moskuptimit, ka në zanafillë të tij po dashurinë. Krejt ajo pjesë e lirikës që përndritet nga ky zjarr është “një psalm për besimin e shenjtërisë së jetës”.³⁰ T’i përfalesh shenjtërisë së ekzistencës, do të thotë të ujisësh në honet e moskuptimit shkëndijën prometeiane. Të kuptosh se zjarri i dashurisë më të thellë nis me njohjen e vetes. Poeti “mbjell mbi buzë luledritën që s’ka të dytë” (*Hëna ime*), për ta filluar edhe një herë procesin e lirisë së vetëndriçimit, në atë kënd të vetes ku “sikush e ka një kënd të diellzuar” (*Dhe prapë fillim*). Qenia nën flakën e kuptimeve të epërme prodhon dritë e zjarr dashurie dhe për të arritur këtë liri absolute vetëndriçimi, qenia (në alegorinë e hënës së zezë) “kërkon qiellin nga i verbri vdekërim” (*Hëna e zezë*).

Poezi të natyrës, *Dritare në zjarr* apo *Përbaltje e yllit*, e shëmbëllojnë fytyrën e vdekjes në një formë më abstraguese, ndërsa kalojnë nga mungesa e qiellit të qenies në mungesën e qiellit brenda kohës së qenies. Dritarja, si syri i shtëpisë dhe syri i kohës, digjet nën një zjarr shkatërrimtar. Bashkë me qenien, digjet edhe koha e saj. Shkatërrimi përfshin hapësirën dhe kohën, ndërsa kataklizmi na mbjell në sy jo luledritën, por “zogj e gjethe prej një shekulli të djegur”. Bejko ndërton imazhe pikturash surrealistë me fjalën e tij poetike, aq sa lexuesi si fillim nuk e ndan dot kufirin e dritës dhe hijes. Hijet valëviten nëpër imazhe si valëvitje flakësh. Mandej, kur stuhia fashitet, trupëzohen një nga një në qenie që dalin prej hijezimit të pejzazhit duke u përndritur befas. Të duket se prej të qenit spektatorë në këto pejzazhe poetike shndërrohesh në një lloj shtegtari që humbjen e peshës dhe thithjen e lartësisë e fillon bash në çastin kur të ndjell zëri nga përtej pamjes.

*Qiell, ati im, ti ke zogun në blu të errët,
ti ke agun, dritën
[...] Më ndjell dhe që nga mitra e honeve, nga lumenjtë.* “Thirrja e udhës”

Zjarri i pasionit merr formën e shpirtërores së thellë, epshit dhe zemërimit. Në lirika të tipit *Është dimër mikja ime* dhe *Qan një grua* dashuria është zjarri, falë së cilës fillon e ngrohet një botë e ftohtë me fytyra ish-njerëzish. Kur flaka e shpirtit është mpakur si mungesa e diellit në natyrë dhe si pikëllima e thellë e mbrëmjes. Zvetënimi i humanes në çdo skutë të natyrës e shpirtit lind tragjiken në poezinë e parë, ndërsa lirika tjetër vjen e ngjizur në formën e një elegjie për nga forma dhe tharmi i saj poetik. Zjarri i pasionit pranëvë një grua shpërfillëse ndaj zvetënimit dhe një tjetër që zvetënohet nga mungesa e flakës së dashurisë, duke vetmuar dhe pikëlluar edhe të tjerët me pikëllimën e saj. “Cili qiell të ndriton, të yllëzon ty?” - monologon uni lirik me miken e zemrës. Në lirikën tjetër, poeti lutet me përdëllim e zemëratë për një flakë dashurie që duhet të ngjizet për dikë që është “mospërfillës për një fytyrë drite”, duke shkaktuar terrin e lotëve në shpirtin e gras. Elegjia e dashurisë *Qan një grua* ka sërish efektin mjegull në ndërtimin e imazheve, duke ravijëzuar sa fytyrën konkrete të pikëllimit, sa gjendjen abstrakte të një pikëllimi universal, që pikon mbi shpirtin e mbrëmjes dhe lulevileve të kopshtit.

Zjarri i pasionit si zemërim bubulon e brof në lirika, si: *Sytë e grave të gurit, Mos më lexo në mbrëmje, Magdalini* etj. Kemi një rrëfim në vargje dhe një dialogim shpirttrash binjakë, në të cilat lexohen hapur shenjat e ringjalljes. Mungesa e plotë e dritës në një atmosferë plot “palumturi djegaguri”, ku uni lirik skicon imazhe përvujtnie të shkëlqimit të zi në sytë e grave, ndjell zemërim dhe përvëlton dhimbje për receptionin e poezisë. Rrëfimi i unit lirik dritërore duke na shpënë drejt një realiteti real dhe surreal njëherazi. Poezia *Mos më lexo në mbrëmje, Magdalini* rimerr mitin biblik, duke i qëndruar besnike vetëm brendisë faktike të mitit. Ndërsa brendinë biblike, atë që flet më shëmbëlltyrë, e lë krejt mënjanë. Ngase i intereson më tepër shëmbëlltyra që ngjiz retorika e vet poetike në rimarrjen e këtij miti. Poeti në zërin e Solomonit lutet për zjarrin e dashurisë tokësore dhe qiellore. Sulamithit, së dashurës së zemrës, i lutet ta lexojë kur t’i thotë të dua, për të mësuar shtershëm kuptimin e thellë të dashurisë, ndërsa Magdalini-t (gruas që mësoi kuptimin e dashurisë hyjnore prej Mesias) i kërkon të mos e lexojë në mbrëmje. Mbrëmja sjell natën dhe nata kreu dikur një kryqëzim.³¹ Ndaj dashuria hyjnore duhet lexuar vetëm nën dritën e diellit. Për ta ringjallur zjarrin e saj të shenjtë në çdo rilexim.

Lirika e Bejkos, prej fillimeve të saj, kur i këndonte zjarrit që digjej si një godinë e rubintë dhe deri në poezitë e vëllimit më të fundit *Këngët e Solomonit* kërkon shenja të ringjalljes për zvetënimet e reja dhe ato të trashëguara, në një botë ku tjetri brenda vetes, koha dhe zjarri i dashurisë qëndrojnë në kufirin mes përhitjes dhe sublimes.

*Alisa Velaj
Vlorë, nëntor 2020-maj 2021*

^[8] Perifrashoet vargu përmbyllës i poezisë Psalm për atin.

^[9] Teksti i referohet kryqëzimit të Jezu Krishtit në Testamentin e Ri dhe historisë së Maria Magdalenës.

Edalë më në fund nga terri osman, kalbja antropologjike, ligjet e hekurta të Sheh- Ul-Islamit dhe tespihet, ku artet, sidomos piktura dhe teatri ndaloreshin me ligj dhe quheshin shëmbëlltyra të satanit-shejtanit, vetëm në fund të shek. XIX, aroma dhe hijeshia e teatrit nisën të ndihen edhe në Shqipërinë e lodhur e në zgrip të zhbërjes. E si mund të hamendësohej teatri në një Shqipëri arkaike, pa salla dhe godina, me njerëz të paditur lënë për ibret, pa shkolla, pa artistë, ca më tepër kur gjinia e dramës, si më sqimatarja dhe e vështira e letërsisë, kishte ligje të rrepta, ku shprehja lirike dhe narrativat grishëse përjashtoheshin, se qenë hipoteka të poezisë dhe prozës. Dhe siç letërsia shqipe erdhi nga përtej detit, nga arbëreshët, ashtu erdhi edhe drama, e shkruar fillimisht në italisht e më pas në shqip. Ishin shkrimtarët katolikë dhe kisha që i dhanë asaj një gjuhë, filluar me “Nata e Këshndellave” e Leonardo de Martinos më 1881, një tekst me karakter liturgjik, pastaj “Emira” (1885) dhe “Alles Dukagjini” (1891) të Anton Santorit, i cili mund të quhet edhe dramaturgu i gurit të parë të themelit. “Emira” vjen brenda poetikës së romantizmit me gërshetime të elementëve të klasicizmit, komedisë baritore dhe melodramës, ndërsa “Allesi...”, ani pse në po këtë poetikë, sjellë temën e parapëlqyer të besës dhe pabesisë falë një strukturë klasike trekëndore: Jerina, Alles, Zakaria.

Më pas erdhi “Besa” e Sami Frashërit, e shkruar në turqisht më 1875 dhe në shqip më 1901. Kaq shumë u vu kjo dramë në qytetet shqiptare nga Korça, Shkodra, Janina, Gjirokastra, Manastiri, Vlora e gjer në Gjirokastrë e më thellë, sa mund të thuash se ishte ajo që e preu edhe shiritin e teatrit shqiptar. E panë mijëra njerëz dhe kuptuan, ose ndjenë, qoftë pse të kredhur në paditurinë e tyre, fuqinë publike të teatrit, ndezullinë e tij për të drithëruar shpirtat. Po pse tronditi kaq shumë kjo dramë? Ndofta për atë ç’ka bartte vetë titulli i saj, pra Besa, ky asht antropologjik i shqiptarëve i shfaqur si virtut i rrallë dhe si krenari, sa madhështore, aq dhe fatale. “Shqiptari kur jep fjalën, ther dhe djalën”, ja ky lloj talismani i zbuluar më në fund nga një shkrimtar-dijetar si Shemshedin Samiu, përveç tragjizmit të thellë dhe situatave të jashtëzakonshme jo dhe pa efektet sentimentaliste a një petk ekzotik përsipri, e rrëqethi publikun duke rrugëtuar përmes asgjësimit të së keqes deri te linja e gjakut at-bir, kur i pari vret të dytin (Fetahu, Selfon), për hakën e një të trete (Vahidesë).

Ai që i habiti shkrimtarët e dramës së fillimeve qe prifti Fan S. Noli, i cili në rininë e hershme, në Athinë, shkroi *Izraelitë e flistinë*, botuar më 1907 dhe e quajti “sqelet drame”. Paçka se e tillë, ajo mbetet nga vlerat e rralla të trashëgimisë sonë. Prifti mendjendritur thiri në ndihmë rrëfenjën e Dhiatës së Vjetër, mitin e Samsonit. Me forcë apo me bindje duhej hapur udha e të vërtetës - pyete i shuguruari rebel? E vërteta duhet rrokur njëherit nëpërmjet bindjes dhe forcës, ide e cila përkonte me detyrat e shtruara për zgjidhje para shqiptarëve në luftën që ata duhej të bënin për të fituar lirinë dhe pavarësinë e tyre. Ani pse i ri, Noli ndërkaloi ide universale që prekin ekzistencën njerëzore, kuptimin e të drejtës, fljimin për të vërtetën, dikotomitë gjithëkohore të së mirës dhe të ligës, besnikërisë dhe tradhtisë, reales dhe fantastikes, të njëmendtës dhe mitit. Një hop të duket se ai ngarendej drejt poetikave të letërsisë moderniste që risemantizonte mitet, dhe them se e ka njohur bukur mirë këtë teknikë.

Gjatë kësaj kohe shkruajnë drama edhe Namik Delvina, Tito Toska, Shtjefën Gjeçovi, Mihal Grameno, Foqion Postoli, Kristo Floqi, Haki Stërmilli, Zef Harapi etj. Për pamundësi kohe, unë po i anashkaloj. Vitet 1912-1924 dhe më pas 1925-1939 shënojnë një përparim të ndjeshëm në fushën e dramaturgjisë. Rritet numri i autorëve dhe i veprave, spikatin përmirësime në



KUR NISI FORMËSIMI I DRAMËS SHQIPE (1920-1939)

Nga Josif Papagjoni

strukturimin e dramës si gjedhe letrare, po ashtu bëhen të qarta prirjet që mëtonin modele nga rrjedhat letrare bashkëkohore. Është koha kur zgjyra osmane u flak tej dhe dëshira për të shijuar gjellë të ndaluara të argëtimit publik nga teatri shoqëruar me histori ngjethëse, të pushtonte qytetet shqiptare duke hapur një varg shoqërisht e grupesh artistike kulturore si: në Shkodër (shoqëritë “Bogdani”, “Rozafat”, “Vllaznia”, “Populli”), në Korçë (shoqëritë “Artet e bukura”, “Rinia korçare”), në Vlorë (shoqëritë “Labëria”, “Filodramatika”), në Elbasan (shoqëritë “Afërdita”, “Egnatia”) etj. Këto shoqëri e të tjera, u bënë djepet dhe bujtësit ku dramaturgët dhe veprat e tyre u krezmuar si më të dashurit e më të mirëpriturit e kohës.

Krahas komedisë *14 vjeç dhëndër* dhe tragjedisë *Burri i dheut*, A. Z. Çajupi solli një nga perlat e dramaturgjisë shqipe, komedinë *Pas vdekjes* (shkruar më 1910 dhe botuar më 1937), me një strukturë të tipit klasik, ku gjallonin 4 karaktere të spikatur, një gjetje e mprehtë komike, sarkazma therëse dhe elementët e groteskut. Sa e sa herë është vënë kjo vepër në skenë dhe përherë na ka mbushur me hare për gjithë kinsat, pseudopatriotët dhe intelektualët shterpë si budallai Adhamut, që thosh se shqipja jonë e bukur duhej shkruarj nga “e djathta në të

mëngjër”. Mendja e Çajupit huajti një çelës: tundimin se çdo thonë të tjerët pas vdekjes, kjo rëndomtësi e thashethemnaje që nuk e përballojmë dot. Përmes truket të leximit të nekrologjisë, mjeti i vetëdemaskimit dhe ai i kontrastit midis dukjes dhe thelbit dha aq sharm veprës, sa dhe një rrugëtim të bukur në kozmosin tonë letrar.

Pa At Gjergj Fishtën drama shqipe do të kishte një raft bosh. Me 8 melodramat e tij, të strukturuar në trajtën e poemave dramatike, ku të këndellin për lirinë dhe poezinë poema dramatike *Jerina*, *ase mbretnesha e luleve*; për kuptimet filozofike *Odisëa* dhe *Ifigjenia n'Aulli*; për sensin atdhetar mes dialogësh moralë e historikë *Shqiptari i gjytetnuem* dhe *Shqiptarja e gjytetnueme*; për rikuptimësimet nga jeta e shenjtoreve si *Shën Françesku i Asizit* dhe *Shën Luigji Gonzaga*. Dramaturg i kahut mitologjik, ai solli risi dhe vështrime origjinale në dramaturgji. Si forma më e pastër dramatike e tij, *Juda Makabe* nuk e di pse ende nuk është prekur nga teatri bashkëkohor! Aty ndihen bukur mirë ligjësitë e organizimit dramatik të lëndës, ngjeshja dhe vijimësia progresive e veprimit, kundërshtitë e shprehura në konflikt etj. Mesazhi i besës dhe i pabesisë, ideja e tradhtisë së brendshme (linja e Alkimit), ndjenja e sakrificës ndaj atdheut dhe

idealit në kushtet e mohimit dhe përbuzjes kolektive (linja e Juda Makabes), sjellin edhe sot jehona dhe sinteza përvojash historike e filozofike që lidhen me të kuptuarit e heroizmit, sakrificës dhe tradhtisë. Por nëse “Juda Makabe”, mbase i ka trembur regjisorët shqiptarë, komedia satirike *Gomari i Babatasit*, jo! Ishte Altin Basha me teatrin e Shkodrës ai që na e solli këtë satirë të pamëshirshme ku askush dhe asgjë nuk flalet. Vepra ka një prerje asilloy të realitetit shqiptar me shëmbëlltyrën tragjikomike të klasës politike të viteve 20-30, sa edhe sot na vjen si një sfidë ndaj elitave politike të korruptuara, të paafta për të ofruar vizione europianizuese. E kush i del dot para mllëfit të pater Fishtës? Gjithçka veçse fshikullohet, përtallet, ironizohet në sherrnajat prej burracakësh dhe injorantësh, ku të gjithë shajnë dhe shahen, dhe prandaj në muzeun kombëtar ia vlen të “vendoset” veçse gomari i Baba Tasit, si relikti më domethënës i shqiptarëve grindavecë, gjithë asaj shpure snobistësh dhe provincionalësh që të marrin frymën, politikave të tyre antikulturore dhe kinse “oksidantizmit”. A s’është po njësoj dhe sot?

Fe e kombësi, Triumfi i lirisë, Karlo Topia dhe Pirro Neoptolemi, në këto katër drama të Kristo Floqit historia vjen si dëshmi e zulumës së të parëve në funksion të zgjidhjes së problemeve madhore të kohës, e nevojës për unitet kombëtar dhe homogjenitet shpirtëror, për mirëkuptim fetar. Porse ky autor la gjurmë në dramaturgjinë shqipe veçanërisht me 28 komeditë e tij të shkurtra, që karakterizohen nga situatat komike zbavitëse e plot fantazi, nga karakteret e gjalla, fjalët e mprehta dhe befasimet humoristike. Humori “i lehtë” dhe sensi argëtues, prania e paradokseve dhe të papriturave, me përdorimin e alogjizmave dhe burlëskut, sikurse edhe antroponimizimi i personazheve me emra përtallës si Halldupi, Dudumi, Sorollopi, Kopani, Strumbullari, Duduku, Kastravec, Galica, etj, e shton efektin komik. Jo njëherë, ai është quajtur si Molieri i komedisë shqiptare. Komeditë “Vëllazëri e interes”, “Zi e më zi”, “Sorollopi” etj, kanë gjetur dritën e skenës kaq e kaq herë në teatrot tona, por më habit fakti përse “Qerthulli politik”, kjo satirë inteligjente politike nuk ka mundur ta gjejë dot atë...

Do të kisha qejf të flisja edhe për disa drama të Foqion Postolit, sidomos komedinë “Martesa e një avokati”, për Haki Stërmillin dhe trilogjinë e tij *Dibrania e mjerueme*, ku përmes brengave të zgjidhjet fatlume me një lloj katarsisi të natyrës së triumfit dhe shpresës. Vitet 20-30 patën në banketin e dramës edhe Kolë Mirditën, Zef M. Harapin, Milo Duçin, Henrik Lacajn, Filip Papajanin, me një mori veprash, por diçka duhet thënë medoemos për njërin nga autorët më në zë të viteve ’20-’30, Et’hem Haxhiademin, i krahut mitologjik, i cili lëvroi tipin e dramës antike e neoklasike, por pa hequr dorë nga përditësimi i subjekteve. Me tragjeditë e tij me motive nga shkrimet e shenjta dhe mitet e lashta (*Abeli, Akili, Diomedi, Ulisi*), apo nga historia dhe heronjtë e moçëm të shqiptarëve (*Pirrua, Aleksandri, Skënderbeu*), ai sendërttoi një kah jo fort të rrahur të dramës shqipe duke u rrekur të gjejë pikat e takimit midis të shkuarës dhe të sotmes, më së shumti nën një optikë filozofike universalizuese, duke “ngacmuar”, siç mëtonte vetë, plagë shoqërore, ku e moçmja i fliste të sotmes kurse e sotmja riformësohej hipotetikiisht në kurmin e mitit, legjendës apo historisë së mbyllur. Paçka se mbi ligjërimin dramatik peshon një stil e parapëlqim shpesh racional e me tepri parashtimesh logjike-cerebrale, megjithatë si kundër-rrjedhë ai mbishtreson monologë hermetikë, qëndrime e gjësende ambiguidë, që veçse hamendësohen, çka sjellë si pasojë një ankth të brendshëm bashkëshoqëruës. Mund të thuhet se tragjeditë e E. Haxhiademit janë prijëse të modernizmit në dramaturgjinë shqipe.

Krijimtaria letrare e botuar e Lindita Arapit nis nga fillimi i viteve '90 kur paraqitet e re ndër poetët e rinj me zërin dhe fizionominë e saj të dallueshme. Ajo periudhë thyerjesh drastike - sociale, politike e kulturore si dhe pikënisjesh të shumta - ishte kohë përsiatjesh e zhgënjimesh nga vetvetja, për ata që kishin pasur pozicion të mirë klasor a familjar në sistemin totalitar; ishte po ashtu periudhë shpresash dhe iluzionesh të shfrenuara për të gjithë, sidomos për ata që në epokën e mëparëshme kishin jetuar përballë majës së thikës, nën syrin e vëngër të pushtetit shtetëror dhe propagandës së tij denigruese/përrjashtuese. Gjithandej shembeshin mure e mite, rrëzoheshin perdet ideologjike të ndarjeve antagoniste mes vendeve të ndryshme dhe mes shtetasëve të të njëjtit vend, shpopulloheshin burgjet e të dënuarëve të ndërgjegjes dhe mbipopulloheshin sheshet qendrave të ndryshme urbane; ishte ndërprerë gjithandej puna prodhimore në fshat e në qytet, në bujqësi e në industri; veprimtari 'prodhues' ishin bisedat e ethshme mes njerëzve, projektet verbale, artikulimi publik e euforik i çdo zëri a zemërimi të brendshëm. Të gjendur nën gërmadhat e utopisë komuniste, menjëherë u hodhënmnë të tjera utopi, po aq abstrakte e joshëse, njëkohësisht. Nga ky truall i zhurmshëm epik, me ngjarje, personazhe e sipërmarrje gjëmuese, duket se ka lindur historia e Albës, protagonistes së romanit "Të murosurat", vajzë e grua fjalë-pakë, nëpër perceptimin e përditshëm dhe digresionet/kujtimet e së cilës materializohet si dramë individuale - psikologjike një tablo e gjerë, nga qyteti provincial shqiptar deri në Vienë.

Historia e treguar në roman nis kur betejat epike janë kryer, turmat e kanë kryer ekskursionin e tyre historik dhe janë të gatshëm të shijojnë të arriturat vetjake, sy më sy me të vërtetat trishtuese të dështimeve seriale. Ëndërrat, iluzionet e rinisë e kishin madhëruar edhe Albën, për sa kohë shërbyen për ta vënë atë në veprim fat-ndërtues, në kurorëzim e shkollimit në perëndim, në kërkim të punës së përherëshme atje sipas kualifikimit përkatës, në kërkim të statusit si qytetar me të drejta të barabarta me kolegët vendas, si dhe, në planin intim/shpirtëror - në mbrojtje të dashurisë dhe të jetës së re familjare, bashkëshortore. Bash kur ka realizuar objektivat e mëdha dhe pret t'i gëzohet jetës së re, zgjohet si vetëdije, shikon më objektivist vendin ku është atdhesuar dhe vendin e saj të origjinës, kupton më qartë e më thellë shoqërinë në të cilën përpigjet të inegrohët dhe shoqërinë nga e cila e ka ardhur.

Romani "Të murosurat" shpreh katërcipërisht gjendje tronditjeje e topitjeje deri në patologji, kolapsin mendor dhe shpirtëror të femrës shqiptare, parë në vendndodhje të ndryshme: 1- Në Austri/Vienë, vend tipik perëndimor për nga trashëgimia krenare historike, për nga zhvillimi modern kapitalist, për nga fetishet e jetës mondane dhe shprehitë e shoqërisë së konsumit dhe, 2 - Në Shqipërinë e të dy kohëve, para e pas rënies së Murit të Berlinit. Motrat Alba dhe Pranvera, e para si protagoniste dhe e dyta si figurë plotësuese e fabulës romanore, bëhen secila dëshmi e

viktima të dy botëve sa të ndryshme nga njëra-tjetra aq dhe të pandryshueshme në vetvete: Viena ashtu si mund të ketë qenë për një periudhë të gjatë - me madhështinë, ftohtësinë monumentale dhe shtresëzimet e spikatura klasore, dhe qyteza provinciale në Shqipëri - e kredhur si dikur nën të njëjtën skamje kolektive post-diktatoriale, nën të njëjtin mentalitet tradicional-konservator, në të njëjtën re pluhuri që ka mbuluar raftet e bibliotekës së zbazur, klasat pa fëmijë të shkollës, orenditë e shtëpive ku tashmë banojnë vetëm të moshur, pa kujdes e pa të afërm pranë, duke lënguar e duke u zvarritur në papastërtitë e trupave të tyre të venitur e të sëmurë. Përmbledhtazi - në Shqipëri ka vazhduar rrënimi ekonomik i masave, ka ndodhur vetëm procesi i

mplakjes së gjallesave e sendeve dhe jo rigjenerimi, jo përtëritja e shoqërisë.


Kriza mendore dhe emocionale ka kapluar Albën, atdhesuar në vendin e mirëqenies dhe të traditave, por e pa klimatizuar me natyrën e marrdhënieve njerëzore, sidomos, sa i përket konceptit për martesën, familjen, jetës bashkëshortore. Në marrdhënie burrë-grua ajo e ndihen veten të parë vetëm si objekt kënaqësish, si partner investimesh në pasuri të përbashkëta materiale, si fëmër e bukur por me afat skadimi për shkak të moshës dhe në konkurrencë me femrat e botës përjashta shtëpisë, në disko-klube e gjithandej lokaleve të zhavitjeve të natës. Ajo nuk mund ta gjejë veten në një treg të tillë ofertash dhe dehjes kalimtare. Ajo është gota e përplasur fort në murin



Lindita Arapi

TË MUROSURAT

OnufriRoman



Romani "Të murosurat",
i Lindita Arapit

Murosja e iluzioneve

Nga Virion Graçi



e shurdhët të një botëkuptimi tjetër. E ardhur nga një traditë ku familja, prindërit, fëmijët janë autoriteti, robëria e ëmbël, qëllimi dhe shpëtimi i jetës, ajo depersonalizohet nga lidhja me një burrë pa biografi origjine, pa prindër, pa gjyshër, pa familjarë e aq më keq - pa nevojën për ta pasur (me Albën, siç duket) familjen e tij të paktën si projekt, si objektiv të radhës. E kush është shpëtimi në një botë të tillë? Shpëtimi është psikologu, mjeku psikiatër, sukcesi financiar dhe - e pazvendësueshmja, mikja më besnike - medicina, industria farmaceutike.

Nga romani:

Dr. Eisenberg-u shpjegonte me qetësi dhe ngadalë.

"Por, nëse duam të kemi sukses, duhet të vazhdojmë terapinë. Ne po testojmë. Le ta themi ndryshe, me oksitocinë po i japim patericat besimit tek ti të ngrihet më këmbë, konsideroj si një element shoqëruar që na ndihmon drejt qëllimit. Lëng i tejdukshëm çudibërës që të kthen besimin, e quajnë disa, por unë kam dyshimet e mia. Janë bërë eksperimente, e vërtetë, oksitocina ka pasur efekt pozitiv në zbutjen e frikës, shtimin e besimit, por, nga ana tjetër, kur janë testuar grupe të ndryshme nga studiues holandezë, rezultatet ishin shqetësuese. Oksitocina forcon harmoninë dhe rrit gatishmërinë për të bashkëpunuar brenda grupit me të cilin ndihesh i afërt, por rrit agresivitetin ndaj grupeve të tjera. Kush thithte aty ositocinë, u vishte tipare më të mira të vetëve dhe distancohej edhe më shumë nga të tjerët. Jo vetëm kaq, tendencat denigrimit të të tjerëve ishte më e madhe, deri te agresiviteti ndaj grupeve rivalizuese. Por, gjithësesi, oksitocina ka efekt në zbutjen e frikës. Ndoshta një ditë do të zvendësojë benzodiazepinën, që jep efekt, por i bën pacientët të varur si nga një drogë, të shpresojmë".

"Domethënë, oksitocina i lidh më shumë ata që njeriu i ndien si të tijtë, por ata që janë ndryshe i pëjashton më shumë. Ky qënka hormone racist!" tha Alba.

Dr. Eisenbergu buzëqeshi lehtë dhe u ngrit në këmbë.

Ora e terapisë kishte mbaruar. (F. 107-108)

Protagonistja e merr oksitocinën, por edhe me të dështon t'i ngjitet shoqërisë që ka përreth, dështon të bëhet pjesë e natyrshme e saj; dallimet janë të thella, plasaritjet në ndeshjen e normave të ndryshme morale e etike janë aq të theksuara sa nuk mund të shërohen as prej medikamenteve. Alba nis të t'u largohet gjërave që ka mbritur, gjërave që ka fituar; ajo bën hapa pas, në kërkim të botës që ka braktisur duke

kërkuar të ardhmen e mirë, parajsën tokësore, perëndimin, si çdo qytetar nga vendet e botës së tretë.

Në sinkroni me titullin e romanit si propozim ideor i autores për një shumësi fatesh femërorë të *murosur* në një vend si Shqipëria, duhet të ndalemi edhe te Pranvera, motra e madhe e protagonistes Alba. Nëse Alba, me sjelljet dhe prurjet e saj psikologjike zbulon pamje deiluzonuese nga jeta e ç'integrueshme e emigrantëve nga vende të botës në kryeqytetin austriak, Pranvera mbetet sinonim i femrës shqiptare që bën paqe me gjendjen ekzistuese të vendit të saj; për shkak të bukurisë admirohej dikur në heshtje dhe përmendej dyshueshëm nga 'të rriturit', mbikqyrej nga rojet e "moralit të pastër komunist", keqtrajtohej fizikisht nga prindërit për shkak se dashuronte një djalë; ajo pranon të abortojë në kushte primitive duke rrezikuar jetën e saj, pranon ta dorëzojë vullnetin e saj në duart e të tjerëve: punësohet me ndërmjetësi, martohet, bëhet nënë dhe përshtatet të jetojnë në harmoni me ambientin mbytës sikur nuk ka ndodhur diçka e keqe më parë, sikur s'ka lënë pas krahësh asgjë me vlerë për ta kujtuar, për ta mbrojtur. Ka pranuar llojin dhe përmasat e kafazit gjinor që i është ofruar i gatshëm, standard, mezi pret të mplaket si nënë dhe të shpëtojë kështu nga çdo trazim që i vjen nga jashtë mureve të shtëpisë prej të qenurit femër ende e re dhe e bukur.

Sa pamë më sipër për romanin e ri të Lindita Arapit, nuk mund ta zvendësojë leximin e romanit, nuk mund ta shuajë kureshtjen për të, përkundrazi; "Të murosurat" nuk është roman i verdhë i një enigme që zbulohet në faqen e fundit, në paragrafin e fundit; ai zbulon në çdo fjalë, në çdo fakt, me gjërat e shqiptuara nga protagonistja dhe me gjërat e lënë në heshtje, nënkuptuar midis rreshtave nga autorja. Romani ia vlen të lexohet për rrëfimin e rrjedhshëm, pasuruar gjatë rrugës prej digresioneve, prej restrospektivave shtegëtuese në kohë e hapësirë të cilat bëjnë të mundur që historia e dy motrave nga një qytetit i vogël i Shqipërisë së mesme të mos ngelet një aksident familjar, një dramë e ishulluar. Duke rrëfyer vetëm për Albën dhe Pranverën L. Arapi arrin të kuadrojë në roman më shumë njerëz, të ngjashëm nga fati, të ngjashëm nga forca e nga dobësitë njerëzore me personazhet e saj; nëpërmjet realizmit psikologjik, karakteristik për pjesën më të madhe të veprës, kur tregohet vendi dhe përjetimet e një emigranteje të re e të brishtë në kryeqytetin të njohur perandorak, mbipopulluar me statuja, lavdi e simbole autorja përcjell nga lindja në perëndim iluzionet dhe traumat e qindra-mijëra njerëzve që rropaten larg vendeve të origjinës për në viset e ëndërruara; nëpërmjet realizmit piktorial, mbizotërues në episodet e fundit të librit kur bëhet fjalë për riatdhesimin vullnetar të Albës, kapet imtësisht gjendja e vendit amë, me ngjyrat gri të mjerimit, me mungesat elementare të jetës dhe deformimet e pandreqëshme të strukturave sociale-urbane.

Në romanin e saj të ri L. Arapi çmuros sekrete të përditshmërisë dhe nxjerr nga errësira pamje domethënëse, emocionuese, të qenësishme jo vetëm për ne shqiptarët.

Shënime për romanin "Dielli më perëndon në lindje", të Eralda Bazes

SHKRIMTARJA QË E BËRI DIELLIN TË PERËNDOJË NË LINDJE

Nga Mark Simoni

Letërsia pikësëpari është atribut i njerëzve të ditur. Këtë mësim, që nga antikiteti i filozofit Aristotel e deri tek kulturologu Umbero Eko, e artikulojmë dhe e pretendojmë çdo ditë. Dhe madje, si në një palimpsest, vendosim veprën mbi kulturën e autorit, duke u sajdisur akoma më tepër nëpërmjet librit. Këtë impakt dhe impresion kam patur gjatë gjithë leximit në dorëshkrim të veprës së shkrimtares Eralda Baze. Jo pa qëllim thashë edhe vepër edhe shkrimtare, mbasi mendoj se romani Dielli më perëndon në Lindje nuk është thjeshtë libër, dhe Baze nuk është vetëm autore me emrin mbi kopertinë. Janë shumë më shumë edhe ky tekst letrar, edhe kjo krijuese. Që në herën e parë kjo shkrimtare e ka fituar këtë status, ashtu si Elvira, këngëtarja e pyllit, që u bë e famshme sapo lëshoi zërin e saj të parë dhe mrekulloi tërë botën me këngën e saj.

I gjithë subjekti i këtij romani është shpërndarë në kohë, në vende të ndryshme, në kultura dhe zakone alternative, dhe është një volum i madh letrar, që vetëm një shkrimtare racionale, një mendje e kthjelltë, një instikt excellent talenti, mund ti administrojë gjithë këto linja fatesh, tërë këtë galeri përsosnazhesh. Veç hapsirës fizike ku luhet subjekti, ka dhe një hapsirë më të

hijshme, më të thellë dhe më të bukur që është hapsira e dijeve kulturore të kësaj shkrimtareje. Nuk është thjeshtë Kajroja dhe Tirana, por është pasqyrimi deri në detaj i substancave të këtyre vendeve, stili i jetesës, zakonet dhe kulturat, nuk është thjeshtë një Miladi apo një Klajdi, por arketipet e tyre të shumëfishuar në mijra njerëz. Eralda Baze ka me vete në dispozicion në këtë sipërmarrje të madhe, edhe kulturën e leximit, edhe volumin e dijeve, edhe njohjet e strukturalizmit të veprave, njeh sintaksën dhe kategoritë gjuhësore, përdor në mënyrë fantastike humorin, sarkazmen, madje deri në nivele inteligjente dhe autoironinë. Ky libër është një katalog mirazhesh dhe imazhesh që e bën këtë vepër të rrijë në paradhomën e mundësisë për të hyrë në kinema në formë filmi.


Eralda Baze ka kujdesin e një arkeologeje, që zbulon ngadalë para nesh parkun e madh arkeologjik, teatrin ku luhet subjekti i veprës, pikërisht atë fushtirë që e kemi para syshë, por që nuk e dallojmë dot. Kemi një harmoni gati alkimike në një dashuri sa ekzotike, aq dhe moderne njëkohësisht.

Era, që është dhe uni letrar i kësaj vepre, është e përshkruar me një hijeshi të pashoqe artistike, nur të bukur, me sharmin e dashurisë si rrallë kush në

simotrat e saj në veprat e tjera. Ky personazh lëviz në një gjeografi të gjërë reale dhe fizike, ashtu si dhe kulturore dhe të ndjesive, lëkundet dhe gjindet herë në qendër të ciklonit të situatave dhe herë në vëshguese inteligjente, në një atmosferë ngjarjesh ku është e përfshirë vazhdimisht, herë me brenga distancash, herë me udhë të pafund, herë plot mall të largët dhe herë dhimbje të mungesës, herë në lëngime të gjata, me këngë të pakënduara. Dhe e gjithë kjo materje që rri në profilin karakteristik të heroinës sonë, e përshkollon tej e mbanë dhe ndërgjegjen artistike të këtij libri. Mall e brengë, dhimbje e dashuri, miklim dhe tundim njëkohësisht, është tisi sentimental që bie mbi teatrin e kësaj vepre.

Autorja ka një delikatesë gati në kufijtë e së thyeshmes, që përndritet nga frymëzimi dhe arti.

Eralda Baze ka një




stil brilant, plot me aromë kulture dhe marinuar me ingredient humori, satire dhe sarkazme, çka e bën këtë vepër shumë të komunikueshme me lexuesin. Ritëm i zhdërvjelltë, plot temporitëm, me shkurtica sintaksore, që tregojnë se Baze ka shije të stërvitur dhe intuitë të pazakontë.

Përdor mjete inteligjente të gjuhës, e pa rënë në grackën e letërsisë cerebrale. Kjo autore e ndjenë se edhe vetë gjuha është një këmishë që i rri ngushtë një vepre me një subjekt të gjërë e ambicioz, ndaj shkrimtarja jonë thërret në ndihmë dhe mjete të tjera për ta përcjellë aq sa duhet dhe si duhet emocionin dhe shijen e krijimit letrar. Ky arsenal i thirrur nën armë nga kjo autore ka në të edhe muzikë, edhe energji, edhe ritëm, edhe determinizëm, edhe jehona ndërgjegjeje, edhe zëra zanoresh, edhe tingëllima kuptimshmërie, edhe rrëfime lineare me përthyerjet estetike të tyre, ka harmoni dhe dizharmoni, që flasin më shumë se vetë fjalët, gjuhë arkaike, zëra mistikë, britma gjithëfarë lloji. Kjo zeje letrare e Eralda Bazes është një nga velencat më të mrekullueshme që kanë nxjerrë këto vite evlemendet e krijuesve. Vepra i jep jo vetëm zë ideve dhe shqetësimeve të shkrimtares, por është mbi të gjitha zëri dhe vokacioni i ndërgjegjes së shoqërisë që na rrethon, është arketipi i krizës së intelektualit, është bota pa rrugëdalje, mbi plagët e së cilës ne duhet të ndalemi. Ecja në këtë libër nuk është ecja në një fushtirë monotoni, por një zbritje në thelbin e autores, në sociolinguistikën e saj, në gjendjet e saj të fshehta, në gjendjet e saj të hipnozës krijuese, atje ku ka situata transi, mediumesh, atje ku është nukli i vetimit të shkrimtares, atje ku ka alkiminë e raporteve të çdo gjëje.

Ky libër jo vetëm të jep kënaqësi estetike, është interesant në stil apo është një regjistër i veçantë të përceptuari. E them pa mëdyshje se kjo vepër është libri i një njeriu që jo vetëm e shkruan letërsinë, por mbi të gjitha e ka dije letërsinë, e kupton dhe si kulturë letërsinë, e zotron dhe si disiplinë letërsinë.

Një vepër interesante dhe dinjitoze, një korpus ngjarjesh dhe situatash, gjeografishë dhe realitetesh.

Kritika e vemendshme patjetër që do ta njohë këtë vepër, dhe duke e analizuar, kritika do të fisnikrojë dhe veten e saj, madje leximi nga kritika i kësaj vepre, do të jetë një shenj i mirë dhe një ogur për të na dhënë dhe ne të kuptojmë se kritika jonë tashmë nuk e ka humbur as instiktin, as nuhatjen, as intuitën dhe as shijen e përzgjedhjes së veprave dinjitoze dhe të vlefshme.



Kohët e fundit shtëpia botuese “Erik” publikoi monografinë “Petrit Gaçja, kirurgu i zemrës” të autorit prof. dr. Lluka Heqimi.

Libri kompozohet në gjashtë pjesë.

Pjesa e parë i kushtohet qytetit të lindjes së protagonistit, fëmijërisë e rinisë së tij, arsimimit të tij në shkollën Normale të Elbasanit dhe, më tej, në shkollën e lartë të mjekësisë “A.P. Pavlov” në Leningrad të ish-Bashkimit Sovjetik, si dhe diplomimit kandidat shkencash në atë institut.

Pjesa e dytë merret me vitet ’60-’70, specializimeve jashtë shtetit, pajisjes së sallës së operacionit për kirurgjinë e zemrës.

Pjesa e tretë bën fjalë për hapat e mëtejshme të kirurgjisë në vendin tonë nën drejtimin e profesor Gaçes në vitet ’80 dhe krijimit të Departamentit Universitar të Anestezisë dhe Reanimacionit.

Pjesa e katërt tregon për qëndrimin e prof. Gaçes gjatë dhe pas ngjarjeve politike të lëvizjes studentore dhe në vitet e vendosjes së Demokracisë, krijimi në vetësi i shërbimit të kirurgjisë kardio-vaskulare të ne.

Pjesa e pestë përqendrohet në jetën familjare të profesorit, në sëmundjen e tij dhe lamtumirën e këtij njeriu human.

Në pjesën e fundit, të gjashtë, jepen kujtime të kolegëve dhe të shokëve për këtë figurë të shquar të mjekësisë shqiptare.

Në çdo pjesë lënda më së shumti është organizuar në sythe, duke u ndalur në vite të shënuara në të cilat protagonist, mjekësia shqiptare a botërore ka hedhur hapa përparimi me një sukses të ri në fushën e kardiologjisë. Ja disa të tilla për repartin e kardiologjisë:

- Viti 1960. Profesor Gaçja realizon komisurotominë digjitale transaurikulare
- 1967. Paisja e sallës së operacionit për kirurgjinë e zemrës dhe enëve të gjakut
- 1969. Instalohet aparati i parë angiografik në QFR
- 1971-72. Operacionet me zemër të hapur
- 1980. Protezat valvulare të zemrës
- 1985. Bypass aorto-koronar
- 1992. Vizita e mjekut amerikan G. Berg
- 1996. Shërbimi i kirurgjisë kardio-vaskulare sistemohet në godinë të re
- 1999. Klinika kardio-vaskulare mban emrin Petrit Gaçja etj.

Sythe të tjera, qysh në titull ngandonjëherë, i kushtohen X apo Y mjeku, shqiptar ose të huaj, për të renë që ka sjellë në shkencën mjekësore për të cilën flitet.

Pas titullit të çdo sythi jepen së pari citate që simbolizojnë përmbajtjen e lëndës që trajtohet, si:

-Bëje hapin e parë me besim. Nuk është nevoja të shohësh të gjitha shkallët (Martin Luter King), f. 84;

-Diferenca, zotërinj të nderuar, mes meje dhe jush është pikërisht kjo: ju mund ta kishit bërë, kurse unë e bëra (Kristofor Kolombi), f. 85;

-Nuk jam aq i ri sa të di gjithçka (Oscar VVilde), f. 93;

-Pa vlerësimin, ekzistenca do të ishte lëvozhgë boshe (Neitzche), f.205;

-...I zgjuar është ai që di atë që nuk di (Sokrati), f.217 etj.

Ajo që të bie në sy në këtë monografi është pasuria e fakteve, informacioni i pasur biografik për prof. Gaçen. Dhe jo vetëm për jetën e tij. Ky informacion shtrihet edhe për të gjithë mjekësinë shqiptare, sidomos në fushën e shërbimit kardiologjik. Jepen hapat e përparimit të tij nën drejtimin e mjekut Petrit Gaçja dhe të kuadrove që përgatiti ai.

Lexuesi njihet kështu me figura të shquara mjekësh shqiptarë:

Kirurgët që kishin filluar të ndërhyjnë në toraks në Shqipëri e kanë zanafillën me Shirokën, Ndroqin, Polenën, Canin e Papariston... (f. 73). Më tej jepet biografia edhe për mjekë të tjerë, si Rushen Golemi, Gazmend Velçani, Avdi Bala, Maks Çela etj.

Libri i Lluka Heqimit “Petrit Gaçja, kirurgu i zemrës”

Monografi kushtuar kujtimit të ndritur të prof. Petrit Gaçes

Nga prof. as. dr. Astrit Bishqemi

Midis tyre, shpaloset mirë shkolla ruse që solli në Shqipëri mjeku Petrit Gaçe, por edhe përparimet e mëtejshme me specializimet që ai bëri në Perëndim.

Informacioni vazhdon më tej edhe për përparimin e mjekësisë në shkallë botërore, psh.: “Kirurgjia e zemrës lindi në Gjermani, në vitin 1896 kur Ludvig Rehn qepi me sukses një plagë të ventrikulit të djathtë në një pacient të goditur me thikë në zemër.” (f. 81).

Lexuesi njihet edhe me personalitete të shquara të mjekësisë botërore, si:

Aleksandër Vishnjevski, që “ishte babai i operacioneve me anestezi lokale dhe pionieri i kirurgjisë pulmonare dhe kardiovaskulare ruse” (f. 56);

Akademikun rus Fjodor Uglov që ishte “një nga kirurgët më me famë në Bashkimin Sovjetik, i ashtuquajtur motor i kirurgjisë ruse, njeriu me bisturi në dorë [...] dhe që u tërhoq nga mjekësia praktike në moshën 102-vjeçare” (f. 61, 62);

Pietro Veladoni, babai i kirurgjisë moderne italiane (f. 88);

Diku autori na njeh me mjekun Christian Barnardit, që i vuri zemrën e dikujt një të sëmuri rëndë (f. 135);

Diku na njeh më gjatë me jetën e arbëreshit prof. Guido Chidichimo, i cili

“ishte pionieri i kardiologjisë së zemrës së hapur...” (f. 146) etj. etj.

Vepra që shqyrtojmë është një monografi që mund të shkruhej vetëm nga një njohës i mirë i shkencës së mjekësisë në përgjithësi, i profesionit të mjekut, pra nga një njeri me arsim e kulturë mjekësore, nga një ish-koleg i prof. Gaçes. I tillë është edhe autori i kësaj monografie, Lluka Heqimi. Ai ka përfunduar studimet në fakultetin e mjekësisë të Universitetit të Tiranës. Ka punuar mjek kirurg, madje i atashuar në ekipin e profesor Gaçes. Ka qenë i vlerësuar nga ai, qoftë si student, qoftë si mjek. Më tej u specializua në Vjenë për mjekësinë sportive, shërbeu për një kohë të gjatë mjek i përfaqësueses sonë të futbollit, duke u bërë figurë e shquar e mjekësisë sportive shqiptare. Ka fituar titullin “profesor” e gradën shkencore “doktor” në mjekësi. Dhe, krahas profesionit si mjek, ka patur edhe interesa për veprimtari të tjera, sportive e kulturore. Atlet i shquar dhe mjeshtër sporti, ka shkruar artikuj të ndryshëm shkencorë, 10 tekste për studentët e mjekësisë e të sporteve, 4 vëllime me monografi sportistësh dhe 6 monografi mjekësh tanë të dallueshëm.

Vetëm pas kësaj përvoje i hyri punës për të shkruar e botuar këtë monografi për profesor



Gaçen, me të cilin ka kaluar një pjesë të mirë të jetës së vet. Kësisoj mund të themi se libri është një monografi e shkruar me njohje të jetës personale e shkencore të protagonistit, një vepër e shkruar me përkushtim e me zemër për një mjek mjeshtër të kirurgjisë së zemrës. Autori e ndriçon figurën e mjeshtrit të vet, personalitetin e tij njerëzor e shkencor, edhe me kujtimet e ngrohta të shokëve e kolegëve të tjerë. Vlerësojmë që ky libër është një punë e rëndë studiuese e përkushtuar, mbështetur në një literaturë të pasur të historisë botërore të mjekësisë, në historinë e Fakultetit shqiptar të Mjekësisë, si dhe në arkivat personale të vetë autorit apo edhe të familjes së profesorit protagonist. Teksti gjithashtu ilustron me një pasuri të tërë fotosh e dokumentacioni për lëndën që trajtohet.

Me këtë libër vlerësojmë që autori arrin kulmin e veprës së tij krijuese. Se nuk është e lehtë të përshkruash jetën, me luftë e përpjekje të një mjeku shkencëtar, të cilit i rreh zemra për njeriun, për përparimin e popullit të vet të vogël, që të arrijë përparimet e prekura nga njerëzimi.

Vepra nuk është monografi e letrarizuar. Stili është i larmishëm: herë i lirë, herë gazetaresk, herë i rënduar me terma shkencore, herë autori ndërfit kujtimet e veta me dr. Petritin. Kësisoj, rrëfimi herë është në vetën e tretë e herë në të parën, herë i lihet dikujt tjetri që të tregojë po në vetën e parë (f.122)

Libri është një jetëshkrim monumental, me pasuri faktesh reale të një shkencëtar i mjekësisë, me punën dhe ngjitjen shkallë-shkallë të tij, që në fakt është ngjitja e kardiologjisë shqiptare sipas viteve të shënuara me arritjen e çdo suksesi të ri të bisturisë mjeshtërore të mjekut Petrit Gaçe e të ekipit të tij.


Megjithatë, nuk mungojnë edhe pasazhe të ndryshme artistike. Ja, një shembull i rastësishëm, si shprehet diku autori për protagonistin e tij:

Dr. Petriti kishte një ëndërr “të kirurgjisë së mushkërive dhe të zemrës. Ëndrra e tij ishte e bukur, një rrugë e re për të cilën kishte shumë nevojë vendi i tij. Ai e shikonte këtë specialitet si një metal të çmuar, të rrallë, që e kishte vendin bosh në tabelën e Mendelejevit në kirurgjinë shqiptare.” (f.62)

Ose, kur Gaçja do të mbronte desertacionin në Moskë, autori thekson se mjeku shqiptar:

“...vuri re një mal të madh mbushur me dëborë. Ishin mjekët e studentët që kishin ardhur ta dëgjonin në sallën e amfiteatrit, të veshur me bluza të bardha.” (f. 66)

Duke përfunduar, kemi mendimin që në një ribotim të mundshëm në të ardhmen të kësaj monografie, redaktori mund të përdorë ca gërshërët në disa dorëlëshime, qoftë në narracion, qoftë në kujtimet e kolegëve, qoftë në ilustrimet fotografike, gjë që do ta bënte veprën më kompakte e më të ngjeshur, duke evituar përsëritjet; gjithashtu edhe dora e korrektorit duhet të jetë më e kujdesshme dhe më e saktë në anën drejtshkrimore.



Së fundmi doli nga shtypi libri me tregime i shkrimtarit Stefan Çapaliku “Tregimet e tranzicionit”. Shoqëria shqiptare ka kohë që sillet brenda një qarku të mbyllur. Fjala “tranzicion” është në gojën e çdo shqiptari. Tashmë prej vitesh jemi një shoqëri në tranzicion. Tranzicioni ynë ngjason me një agoni të gjatë, të gjatë...

Në libër pasqyrohet individi shqiptar, dëshirat, ëndrrat, pamundësitë, bjerrjet e kota, dyshimet, dështimet, shkurt, rrugëtimi i tij përgjatë tranzicionit. Personazhet e Çapalikut janë njerëz të thjeshtë, ata bartin brenda vetes një mori ndjenjash, emocionesh. Me sjellje e vese hera – herës të pashpjegueshme, personazhet e autorit plotësojnë mozaikun shumëngjyrësh të periudhës post komuniste.

Libri në fjalë, pra “Tregimet e tranzicionit” përmban dymbëdhjetë tregime dhe është i ndarë në tri pjesë:

- libri i ëndërrimeve
- libri i dyshimeve
- libri i dështimeve

Në librin e ëndërrimeve janë përmbledhur gjashtë tregime të cilat lidhen me mendësinë, frikërat e pasojat që la pas diktatura. Por gjithashtu vihet re një lloj ndjenje ëndërrimtare e cila pothuajse gjithnjë përzihet me frikën nga e reja, e panjohura. Mund të përmendim frikën që mbillej që në fëmijëri për mjekët, policët, mësuesit. Tek një nga tregimet personazhi kryesor edhe pse është burrë dridhet kur ulet në kolltukun e dentistit, frikë kjo e mbetur që prej fëmijërisë.

“U tremba, u struka, u zvogëlova, s’di ç’ndodhi me mua, por që prej atij çasti unë s’isha”.

“Shitja” e individit nëpër shoqata, organizata, është tregues i mendësisë komuniste. Nëse e shisje veten tek partia kishe privilegje. Pas rënies së diktaturës njerëzit u “shitën” si mall shumice dhe merrnin pjesë nëpër protesta në këmbim të ushqimeve apo parave. Edhe këtu shihet një dëshirë për ndryshim, përqaftimi i së resë, në këtë rast i shoqatave (më parë nuk kishte të tilla, pas komunizmit mbinë si kërpuhat pas shiut).

“E thënë troç, familja jonë u punësua ndër protesta dhe demonstrata. Në protesta na jepnin lekë. Ngandonjëherë edhe mall, si puna e thasëve me miell, makaronave, sheqer, vaj, shkrepse, etj por ne preferonim lekë”.

Me daljen e vendit nga sistemi komunist njerëzit u prirën drejt “ëndërrimit” të gjërave që gjatë diktaturës nuk i kishin shijuar. Mbizotëronte një etje e madhe për të përpirë gjithçka që kishte qenë e ndaluar deri më atëherë. Në tregimin “Eros dhe Thanatos” del në pah kjo etje e veçanërisht etja seksuale. PP-ja, personazhi i tregimit në fjalë, me një kamer të dhuruar nga kushërinjtë filmonte çdo gjë. I lindi idea të hapte një videotekë dhe ishte i bindur që punët do i shkonin vaj pikërisht se njerëzit kishin “uri”.

“Ajo që kishte vënë re lehtësisht PP nga periudha e shkurtë e pasizolimit ishte se njerëzit kishin uri për gjithçka, e posaçërisht thellë – thellë vetes së tyre fshihnin urinë seksuale”.

E pra pas komunizmit lulëzuan një sërë aktivitete që kishin qenë të ndaluara më parë, e që për fatin e mirë të “ideatorëve” babëzia e popullit ishte në përmasa të tilla që mund të gllabëronin gjithçka, pa e përtytur. Ishte e pabesueshme liria e shprehjes, mendimit, veprimit që individi “fitoi” në post komunizëm e kjo solli me vete “hapjen” e madhe.

“Tregimet e tranzicionit” i Stefan Çapalikut
(Botimet Fishta)

Rrugëtimi i individit përgjatë tranzicionit

Nga Xheni Shehaj

- LIBRI I DYSHIMEVE

Në librin e dyshimeve përfshihen katër tregime. Pas rënies së diktaturës njerëzit të frikur, të shuar nga ajo që kishin kaluar dyshonin edhe tek vetja. Në tregimet në fjalë lexuesi përballlet me boshllëkun, dyshimin, zbrazëtinë, mungesën e guximit. Personazhet e Çapalikut janë individë të bjerrur që thellë i tremben dhe hijes së tyre. Në tregimin “Zhurmat e katit sipër” personazhi kryesor dëgjon për çdo natë zhurma nga fqinji i tij që banon lart. Mirëpo kur e pyet se çfarë zhurmash janë ato, fqinji i thotë se nuk ka asnjë lidhje me zhurmat që ai dëgjon. Krimbi i dyshimit e çon personazhin te apartamenti i fqinjit. Boshësia, qetësia e zbrazëtia që mbizotëronte atje e frikësuan burrin. E pra, dyshimi mbeti, zhurma apo jo, zbrazëtia e apartamentit përçoi te personazhi frikë dhe mbolli dyshim.

Mungesa e guximit është një element që mbështjell kryq e tërthor tregimin me

titull “Vetëvraska e mbasditës”. Gjergj Mbasditja, personazhi kyç i tregimit, në rininë e tij kish dashuruar Anën, një shoqe shkolle. Gjergji kishte një cen, i merrej pak goja dhe kjo e kish bërë të pashoqërueshëm dhe vetmitar. Anës nuk i tha kurrë se e donte. Dyshonte se shoku i tij Viktori kishte përparuar në lidhje me Anën. Ky dyshim iu rikthye vite më vonë kur nga ballkoni pa Viktorin me të shoqen e fëmijët tek parku i lojërave. Tortura që i shkaktoi dyshimi i vjetër, bëri që Gjergji të “sajonte” me mendje një film të tërë. Krimbi i dyshimit i bren personazhet deri sa i asgjëson së brendshmi

Pikën kulmore “Libri i dyshimeve” e arrin me tregimin “Po sikur të kem qenë spiun?!”. Tregimi është shkruar në vetë të parë dhe subjekti, në dukje është i thjeshtë. Personazhi po aplikon për një vend pune dhe i duhet të plotësojë një formular ku deklaron se nuk ka bashkëpunuar me Sigurimin e Shtetit gjatë diktaturës. Tema e bashkëpunimit me regjimin është

një nga ato temat e nxehta që djegin në çdo kohë e veçanërisht gjatë tranzicionit. Personazhit i lind keqas dyshimi nëse ka qenë spiun (ndoshta pa e ditur fare) e mbase ka qenë i survejuar e sërish nuk e ka ditur.

Autori heq një paralelizëm mes vendit tonë dhe Çekisë, aty ish-spiunët kryenin një katarsis kolektiv gjë që tek ne nuk ka ndodhur.

“Kur isha në Pragë, si student pasuniversitar më 1993, dëgjoheshin gjithfarë lajmesh, për njerëz që thërrisnin me të madhe nëpër kishat e Çekisë se kishin qenë spiunë. Kjo ndodhte kryesisht të dielave dhe më së shumti në kishat e fshatrave dhe qytezave periferike. Aso kohe shihej qartë se po ndodhte një katarsis kolektiv. Ata gjenin vendin më të përshtatshëm për t’u rrëfyer dhe për të kërkuar falje në sy të të gjithëve. Kishte prej atyre që kërkonin dhe ndëshkim”.

Takimi i personazhit me një mik i cili i rrëfen rastin e një piktori që doli spiun pa e pasë ditur e shton ankthin dhe dyshimin. E pra siç e thotë dhe vetë personazhi: “Po jetojmë kohë të mbrapshta”.

- LIBRI I DËSHTIMEVE

Përmban vetëm dy tregime dhe në thelb të tyre qëndron dështimi. Është fjala për dështimin si individ, si shoqëri, dështimi në të gjitha format. Të dy tregimet përveçse lidhen me dështimin lidhen në mënyrë direkte edhe me vdekjen. Tregimi “Ditëlindja e fundit” ngërthen një mori personazhesh të cilët në një farë mënyre kanë dështuar në jetët e tyre. Futja e një qenieje të abortuar, një individi të pafaj por të dështuar nënkupton dështimin madhor, atë që ne si shoqëri e ndjejmë dhe kultivojmë dita-ditës.

Ai është një fëmijë i abortuar, një dështim. Polici Marin Shkurti që merret me çështjen e Tij është një individ po aq i dështuar. I divorcuar, me një djalë të vogël, ai humbet punën, detyrohet ta dërgojë të birin tek e shoqja dhe përfundon duke ia hequr vetes me revolverin e vjedhur në depon e policisë.

Grupi i pseudo shkrimtarëve, artistëve që mblidhen te bar “Lux” dhe bjerrin ditën me “mendime filozofike” janë po aq të dështuar.

Mark Bashkia, prokuror, narcizist, bashkë me të shoqen Liza Kopin, pedagoge, kanë zgjedhur të mos sjellin fëmijë në jetë. Zbulimi i fëmijës së abortuar e çon Markun në polici për ta parë. Dhe tek tiparet e fëmijës sheh Lizën. Bindet se është fëmija që ata abortuan para disa muajsh. Të dy vendosin ta adoptojnë dhe ashtu ndodh. Njerëzit nga kurioziteti dynden të vizitojnë shtëpinë e Markut dhe Lizës. Të gjithë duan të shohin Atë, të abortuarin.

Kulmi i vizitave arrin kur grupi i pseudove shkon te shtëpia e Markut për të njohur djalin. Sipas llogaritjeve të tyre Ai e ka datëlindjen më 10 gusht. Ata ja behin më 20 gusht bashkë me urimet më të mira për datëlindjen e Tij. Bash kur kërkojnë të dinë nëse i kanë vënë emër, Ai shkëputet prej tyre dhe zhduket.

“Unë u tregova i singertë me ju kur ju thashë pak më parë se nuk kam as emër, as ditëlindje dhe natyrisht as vendlindje. Mos u çuditni. Ju jeni i pari që po mësoni prej meje se unë jam një njeri, ose diçka e tillë, i abortuar, domethënë i dështuar”.

E pra, individi, shoqëria jonë po jeton ende tranzicionin që duket e kemi me merak ta zgjasim sa më shumë. Dhe dihet se kjo gjendje “midis” na çon drejt një destinacioni : dështimit.



1 *maestoso*

Fryn erë e dimrit, fishkëllen si bishë
Që nga Gjykatë e Lartë në Parlament.
Tirana gdhin, aq pabesisht e hijshme,
Sa s’di ç’ta marrësh, delir apo qytet.

Zgjohet sërish, me atë emër të tmerrshëm,
Që një mijë vite rreh ta heqë më kot.
Vërtiten gjethet dantealigjershëm
Si shpirtra që nuk patën trupa dot.

Përballë tyre, zyrtarë të pashpirt,
Në varg veturash rendin, s’dihet ku.
E verbër si të tjerat ngjan kjo ditë
Ngaqë askush s’beson askënd, askund.

2

Në një mëngjes të tillë ç’të bësh më mirë,
Se sa të shkosh në klubin “Davidoff”?
Të zësh një kënd mu te qelqnajë e ngrirë
Dhe mendjen mundësisht ta çosh në off.

Në kafene ka për çdo punë një qasje,
Të tillë që kurrkënd nuk e gjen dot.
Për tri mijë euro porosit një vrasje,
Për katër mijë, titullin vikont.

Për gjithçka flitet, pronat, asgjëkundin,
Çmimin Nobel a një veturë të re,
Për zgjedhjet dhe dekretet krejt të fundit
Të zotit president me emër hebrë.

Flitet për mllefe, për kupën që u mbush,
Për Jezu Krishtin a ndjesën fill pas kobit.
Në njërën nga tryezat shpall dikush
Një skicë të re të historisë së kombit.

Pas tij, kur etërit tanë një vjeshtë dolën për pré,
Një shkabë rrëmbyen në trojet e mëdha.
Më lehtë u merrje shpirtin se atë shpend,
Ndaj bota u lodh e shkabën ua la.

Krenarë që Romën e Bizantin zhvatën,
Jo një kasolle vllahu në Ballkan,
E vunë në flamur të tyre shkabën
Dhe bij të saj u shpallën anembanë.

Kështu në kafene kjo punë merr qasje
Me “kundra” e “pro” të bujshme, natyrisht.
Okej, për tri mijë euro, thotë vrasësi,
Për dukën dhe dukeshën bashkë, dyfish.

3

Mesdita ia beh, si grua e dehur tapë.
Temperatura e dollari zbresin prap.
Po shqyhen celularët: okej, shkërdhatë,
Rrofsh, je yll bote, e tung, e top, e trap.

A shqip është kjo llahtarë apo dreqnisht?
Për gjithçka flitet, heshtet për gjithçka.
Ja të dy palët, xhelatë, viktima e ish,
Kujtime shkruajnë netëve me mllefe të mëdha.

Po ç’është ky popull që në gropë i shtrirë
Kujton aq krenarisht se është në majë?
Dhe kur përkundër, nga gropa del i lirë,
“Jam i rrëzuar!” klith me thirravaj?

Një makth i dalë nga një gjumë i marrë
Më i zbërthyeshëm se ky komb do të qe.
Ca trumba zogish me curle e celularë
Që nëpër mjegull klithin, nëpër re.

4

Pse gjethet befaz prarim kurore marrin,
Tek shtrohen si qilim mbi bulevard?
Kambana e katedrales së Shën Palit
Trishtueshëm bie si me peng e aht.

Ç’nuk pjell ky vend, horra, shenjtorë e tmerr,
Zonja Makbeth e pranga, e perla, e hekura.
Dhe ja tani njëra pas tjetrës nxjerr
Dy mbretëresha, që të dyja të vdekura.

Ismail Kadare

TIRANA NË DIMËR

Nuk qenë robina jo, rrëmbyer vonë,
Pas dokeve kreshnike a në pritë.
Kanë ardhur vetë, ndonëse qenë në fron
E para veç një vit, e dyta as një ditë.

Dhe katedralja i përcjell me vaj
Dy mjellmat e gabuara, të mekura.
Ato që s’erdhën për kurorë, veç për varr,
Të brishtat zonja, mbretëreshat e vdekura.

5

Në klubin “Davidoff” qelqnajë e ngrirë
Dremitje dite sjell s’di se nga ku.
Një si madonë e lodhur më është përhirë,
Që italishtja gjuhë mund t’ishte gjithashtu.

Lehonë e zbehtë pas lindjes së kaltëreme,
Në të njëmjitin e treqindin vit,
Më shumë se Krishti madonën, kjo poemë
E lodhi ndoshta gjuhën italisht.

O, këto pamje i njoh dhe nuk i njoh,
Këto tri kate, rrathët, ashensorët,
Ku hypin, zdrypin, klithin obobo,
Rrufjanët, mëkatarët dhe mizorët.

Të gjithë janë aty, rrahin më kot
Të ndërrojnë katet, por katet s’ndërrohen kurrë.
Të zez, në mjegull shtyhen sindozot,
Ish-korbat e së zezës diktaturë.

Nga bie dalja? Ku ndodhet Purgatori?
Nga pyetjet sheshi gumëzhin si zgjoi.
Shkodran je ti? Ç’plenum i zi të polli?
Më ngriti i dyti, i gjashti më rrëzoi.

Një zë gjëmon: këndeje plenumi i katërt,
Piktorët andej, i pesti rreth u mbush.
Shkrimtar spiun je ti? Rend te i shtati.
Në s’do të digjesh te i teti shkrumb.

Rendni, fatzinj, mëshirë për ju nuk ka,
Ashtu siç ju nuk patët për askënd.
S’ka vend ndërkaq te Tmerret e Mëdha,
As te Politbyroja nuk ka vend.

Me ngut po shtohet një Gropë e Hon i Ri,
Bri Lugjezezës një tjetër Lugjezezë.
I nënti rreth po mbushet, dhe ai.
S’ka mbetur veç një vend për Zonjën e Zezë.

6

Në kafene ka rënë njëfarë qetësimi.
Shpirti pushim kërkon, e ndoshta mall.
Anëdete blu, plazhe të shkreta dimri,
Hotele ku nuk mbërrin i ftohti i madh.

Një grua e mjegullt, shfaqur te qelqnaja
M’u duk se më kujtonte një premtim.
Vdekja s’më la, atë premtim të mbaja,
I thashë më në fund plot pikëllim.

Ajo më pa habitshëm që pas qelqit:
Nuk të marr vesh, kjo gjuhë më bën ujem.
Në qoftë se ti, siç thua, je i vdekur,
Atëherë mua ç’më mbetet që të jem?

S’e di, i thashë, me habi të ftohtë,
Tek shpirti prapë me pikëllim m’u mbush.
Dikush nga ne të dy s’është më në botë,
Po cili a cila, këtë s’e di askush.

Një copë herë me shenja morëm e dhamë.
S’kuptoheshim, veç kishim mall e mund.
Gjersa ajo u tret te qelqi i madh
Dhe unë mbeta shkret në kundaskund.

7

Mbrëmja po bie. Tirana rrotull bllokut
Nis të stoliset për ballo a për orgji.
Një foshnje e rastit, e paligjshme e Nju-Jorkut,
Një ëndërr xhuxhe a shkërbim i tij.

Në borxhe e gjyqe rrokaqiejt vërtitin
Drita dhe bare rrotulluese lart.
Poshtë tyre, luanesha të përgjumura në pritë,
“Amerikan”, “Raiffeisen” e “Credin’s Bank”.

Por s’do t’ia dijë askush për borxhe a gjyq,
Të dehur qejfit krejt a marrja e hakut.
I gjatë, si natë e anktshme n’udhëkryq
Shfaqet mes brymës kryebashkiaku.

Kull’ e Sahatit po tregon një orë,
Që ndoshta kundërshtohet si çdo gjë.
Në sallat e muzeut të fundit vizitorë
Ja muzgu si në kurth befaz i zë.

8

Kështu në një fund dite ajo m’u shfaq
Fantazmë e kombit si e Hamletit mbret.
Kish ndryshk e gjak mbi parzm e et për shpagë
Dhe kumt të frikshëm kish në sytë e vet.

Unë ia besova fjalët, kumtin, ahtet,
(Gjithmonë ka një fantazmë që lyp diçka prej nesh),
Pastaj ajo kërkoi atë që s’lypet, artin,
Tek fjalën “popull” tundtte si rrebesh.

Të falem për ç’më dhe, veç mos më lyp ti, mos
Një borxh që nuk ta kam. Të kërkoj ndjesë
Që dot s’të mbrojta, s’të mbrojta sidomos,
Prej vetes tënde, armikut tënd të tmerrshëm.

Ti rrugën tënde ke në këtë botë të ftohtë,
Shkrimtari do a s’do ka rrugën e vet.
Të mbroftë Zoti, a marrëzia të mbroftë,
Tjetër hyjni unë kam. Pra mirëmbetsh!

S’ka “mirëmbetsh!” fantazma klithi. Mejet
Ti s’ndaresh dot, mbi tokë apo nën tokë!
N’u ngritshim lart, të dy do çajmë retë,
Në rënçim në humnerë, do biem tok.

Klithmën e saj kaq kohë pata në vesh,
Herë si rënkim, si urdhër a si vaj.
Kërkonte që gjithkund ta mbart si peshë,
Porsi Ankizin at mbi shpinë ta mbaj.

Të gjithëve kjo klithmë na ndjek si nëpër gjumë.
I vogël është planeti sigurisht,
Si një shtëpi e ngushtë, ku në bodrum
Dikush klith “ndihmë!” dhe ti s’di si ta ndihsh.

9

Ra nata. Era prapë fryn e ofshan
Nga Parlamenti te Arkivi i Shtetit.
S’është era, janë shpirtra në tufan
Që diç kërkojnë prej Zotit a prej vetit.

Duan të dinë të fshehtat dhe mynxyrat,
Ndaj shfryjnë zyrë më zyrë e hon më hon.
Thua se erë e Grykës së Këlcyrës
Malit me Gropa djemtë po ia kërkon.

Mesnata shkon, Tirana dot nuk fle.
Po flet përçart si shpirt që kërkon ndihmë.
Një metropol me kryet krejt në re,
Kryeqytet me emrin krejt enigmë.

Në ç’makth e gjete, ç’kumt në të ke ndryrë?
Ç’urdhër ke fshehur, kë do trembsh me të?
Fryn erë e dimrit, si ulkonjë e ngrirë,
Ajo që s’jep përgjigje për asgjë.

Më në fund Koleksionin e tij të mrekullueshëm e gjeta në një ankand në Paris. Ende s'ishte shitur. Isha kurioz për çmimin. Lulet e mullagës me brymë e gjeta rastësisht në Bernë në një sallon pikturë. Ndërsa Borsalinon, njeriun pa fytyrë e pashë në dhomën e pritjes të Kryetarit të Bashkisë në Kanë.

Qëndrova në Paris dhe dy ditë të tjera për të parë si do të shkonte puna me Koleksionin. E bleu një armen, një burrë shumë i shëndoshë, shulak me kipte në majë të kokës. Thoshin se e priste avioni përjashta. Bisnesin e kishte në Paris, por jetonte familjarisht në Ishull.

Borsalinon, njeriun vetë, e kishin harruar. Ai ishte piktori. E kishin shtënë në varr me kancerin e tij. Ishin kthyer në shtëpi dhe kishin hapur kasollen në kopsht ku kishte studion. Aty ishin punët e fundit, rreth shtatëdhjetë portrete, peizazhe dhe natyra të qeta. Gjetën një letër. Ja, ç'shkruante: "Mos u nxitoni të m'i shisni. Nuk fitova kurrigjë nga pikturat e mia, veç pesë vjet burg. Mos urreni njeri. Doja të hapja ekspozitën e fundit, me shpresë se do të ringjallesha si Shën Llazari, po kisha shenjë 666. Dhe kështu ndodh. Këto punë janë frut i pesë vjetëve në qeli. Atje u bëra piktor prej kohës dhe durimit, vuajtjes dhe urisë. Prej mungesave më elementare. M'u dha mjeti i skajshëm si një armik i përbetuar dhe unë e ktheva në mik. E bëra vëlla. Kjo më shpëtoi. Prej tokës së zezë gurishte nxora këto dritëza. Nuk di sa do të ndriçojnë, por di se janë frute të mizerjes. Mos m'i shisni, megjithëse ju vuani për bukën e gojës. Një bukë, një pikturë, kështu ka për të ngjarë... Atëherë ndajini në pjesë, tre vajzat dhe dy djemtë, më e vogla të trashëgojë koleksionin. Atë ndjej më dhembshurisht se është ende e vogël. Ju dhashë bukën, po verën? Verë s'ka, se Krisht s'u bëra dot. Iki nga kjo botë pa e hapur ekspoziten e fundit që t'ju tregoja kolegëve se jam bërë dhe më i fortë, po ç'duhej tek e fundit ky gjest kryeneç për të ngjallur zili dhe mëri, më mirë kështu, i poshtëruar prej burgut, i ligështuar prej kancerit, i harruar me gjithsej... Borsalinon ia lë gruas që më duroi trimërisht gjithë ato maniera që i quaja brilante, po s'ishin veç tryzni e dhunë për një të gjorë grua aq të brishtë që më shërbeu me përlulësi fisnike një jetë të tërë. Unë qeshë tiran, sepse forcën e pikturës që më ndriçonte e ktheva në errësirë për të afërmin, miqtë. Shumë hoqën të më duronin. Tani që po iki, kam nevojë për shumë dhembshuri, po ajo më jepet për forcë zakoni dhe fytyrat kanë vënë maskë, se dhimbja më fort sajohet sesa ndjehet. Kam jetuar një jetë me veten, me emocionin genuin, larg shqetësimeve të vogla, harrues i vogëlimave njerëzore, i përpirë nga ëndrra për lavdi. S'kam qenë i pranishëm në asnjë lindje të fëmijëve të mi, as dija që gruaja kishte nevojë për mua, goftë dhe për një banalitë si blerja e qumështit, e gazetës, e cigareve, sepse unë i prisja të gjitha prej të tjerëve. Jetoja thujse me veten në studion time. Si në një ishull. Lexoja shumë. Pija pa masë. Më pëlqenin skandalet, isha i pacipë. U bëra i padurueshëm. Sepse isha në krizë. Kjo periudhë vazhdoi gjatë. Vura dorë mbi gruan. Fëmijët dridheshin para meje. Kërkoja para borxh dhe s'i ktheja. Çoroditje pa anë e pa fund, shkaku ishte kriza në pikturë. Terri i burgut më ndriçoi. Atje e kuptova se po kapërceja diçka të plotësuar, po dilja matanë të zija fillin e një zanafille. A mund t'ia nisja nga e para, nga e thjeshta e harruar, nga e veçanta dhe konkretja, nga emocioni i një gjesti njerëzor të harruar? Iu vura të ndjek nga pas atë që s'dija ta shikoja ashtu i mbyllur në studion time, jetën në atomin e saj, këqyrjen e harresave që kanë shkarë prej xhepit të grisur të kujtesës. Iu riktheva emocionit. U bëra lëng loti, u zbrujta prej ngashërimeve që i kisha patur, po s'i kisha vlerësuar prej majës që më priste. S'kishte majë, po fund. Dhe

BORSALINO

tregim nga Roland Gjoza

fund është elementi i vogël. Ose jeta e parë milimetër për milimetër. Isha filigranisti kinez, ai piktori i perandorit që mori urdhër prej tij që të bënte peshkun më të bukur. Kërkoj pesë vjet kohë. Qëndroi në meditim pa guxuar të hedhë gjë në letër. Pastaj kur po mbyllej viti i pestë, me një levizje të shpejtë vizatoi peshkun më të bukur në botë. Mendoj se këto shtatëdhjetë punë kanë diçka të ngja-shme me këtë histori. Po sikur të vdisnit nga uria dhe të mos m'i shisnit për një kothere bukë këto vepra? Ah, sa do t'ua dija për nder. Se ju jeni qorra, s'dini ç'po bëni. Më mirë lypni, po mos vini dorë mbi pikturat. Ose po i shitët, 1000 dollarë copa, jo më pak. Me kohë do ta kuptoni se ç'keni bërë, por do të jetë tepër vonë. E di që 666 më është vënë damkë. Kështu do të shuhem, po qoftë amshim.."

Këtë letër e bleva unë. Se atje asgjë s'kishte mbetur. Të shtatëdhjetë punët ishin shitur për 30 aspra, siç thonë.

E takova armenin në hotel dhe e pyeta për Koleksionin.

E bleva për gruan, me tha. Borsalinon e kishin blerë para se të vija unë, po do ta shtij në dorë. Do t'ia shpie gruas për ditëlindje. Ky është piktor i çuditshëm, seç ka një mister, si impresionistët, i rritet vlera dita ditës. Unë jam koleksionist, s'gaboja kollaj kur i them këto fjalë.

Ç'ishte Koleksioni? 40 ditët e një fëmije të sapongritur në këmbë, në të gjitha fazat e lëvizjeve gjersa mbërrin te uturaku. 40 pamje me një forcë si prej Mikelanxhelos në muret e Kapelës Sistine.

Unë kam letrën, i thashë.

Ç'letër?

Atë që ka lënë para se të vdiste.

Ai u mendua.

Ajo s'ishte në ankand.

Ia kam blerë së shoqes në Tiranë.

A e dini që gruaja ime është shqiptare dhe ka jetuar në Shqipëri gjer në moshën 26-vjeçare? Ajo e do shumë atë vend.

E njoh gruan tuaj. Është shumë e talentuar.

O, sa më bëhet qejfi. A biem në ujdj për letrën? Ajo ndoshta shkruan diçka për këtë piktor.

Më në fund u takova me Amalinë në një kështjellë. Ajo kishte mbetur po aq e bukur, tejet e zgjuar, me një fisnikëri fine. Ia dhashë letrën dhe ajo e lexoi. U përlot. Ai kishte blerë dhe Borsalinon, autoportretin ku dukeshin vetëm buzët e shtrëngura dhe një cep syri përplot mistikë. Ishte një borsalinë e jashtëzakonshme ku rrotulloheshin gjithë mundimet e jetës së një burri. Në atë cohë të zezë prej feltri kishte shumë ekspresivitet gjer në ngecje fryme.

Ua kam falur, i thashë për letrën.

Ajo m'u hodh në krahë dhe unë i nuhata me gjithë mushkëritë aroren e parfumit dhe taftin tronditës të epidermes së saj.

Koleksioni ishte vendosur në sallonin e madh të fëmijëve. Unë po e këqyrja me vërejtje, ndoshta dhe me buzë në gaz, se ajo gjithashtu qeshi dhe tha:

Na i kanë kërkuar 500 mijë euro. Ndërsa Borsalinon 1 milion. Nuk i shes, pres kohë më të mira.

Dhe të mendosh se ato u shitën për një krodhe bukë, thashë, po ajo s'ma vuri veshin.

Hëngrëm drekë lart në bedena dhe pamë detin. Pastaj erdhën muzgjet me një dritë të manushaqte dhe dielli i madh i gushtit ishte aq shprehës e i shtangët sa të shtinte frikën.

Të të shkojë mendja te ai piktor që ka vdekur, thashë përsëri.

Piktorët vdesin, tha ajo. Më të mëdhenj janë pas vdekjes. Po ky është piktor i jashtëzakonshëm. Më ka tronditur, veçanërisht me Borsalinon. Një autoportret

aq shprehës me një grimë tipare, një portret borsalino, i humbur në atë borsalino, një njeri si i vrarë nga maniera.

M'u duk se e kishte kapur tipin, atë tipin e njeriut që rrëshqet si gjarpri e zor të kapet plotësisht. Nuk do ta bënte romanin. Jo, nuk më besohej, veç do ta bluante për një kohë të gjatë dhe s'do të ulej kurrë për ta shkruar. Këtu kishte perëndime shumë të bukur. S'të bëhej të ikje.

U ktheva në Tiranë dhe bëra këmbë te gruaja e piktorit. Po ajo shtëpi. Po ai kopsht i lënë pas dore. Studioja e paprekur, e mbushur me pluhur dhe cerga të mëdha merimangash. Atje ishte paleta me bojëra të shtrydhura, të thara, kavaleti, muret bosh, kishin mbetur vetëm gozhdët. Ca gozhdë të ndryshkura, që m'u dukën se pikonin gjak.

S'ju ka mbetur më asgjë?

Asgjë.

Askush nuk ka ardhur më?

Një grua. U ul këmbë mbi këmbë, piu një cigare duke parë muret bosh. Ishte shumë e bukur. Më puthi. Ishte shumë e dashur. Ia dhashë të gjitha fotografitë. Ç'më duheshin?!

Sa fotografi ishin?

Shumë, mbi njëqind. Ç't'i doja, unë jam 88, e sëmure. S'më bëjnë më as syte, as këmbët, as duart. Aty ishin dhe pikturat se ai i fotografonte.

Kaq?

Kaq.

Pastaj iku?

Pastaj iku.

Paska ardhur, mendova dhe paska marrë fotografitë, për të cilat askujt s'i kish shkuar nëpër mend.

O, u përmend ajo, kam borsalinon origjinale, tani m'u kujtua. Po ju bëri punë, merreni.

Ishte po ajo borsalino, e shtypur prej duarve të tij. Do t'ia kisha dhënë asaj, po s'm'u kujtua. Më pyeti e shkreta, po unë isha si përgjumësh. Ju thashë se ishte shumë e bukur dhe dukej grua e zgjuar.

Shtëpia ishte tej mase e varfër, vinte një erë prej asgjëje, më e pikëllueshmja erë, si një grahamë e fundit. Në mure asgjë. Sikur këtu asnjëherë të mos kishte jetuar një piktor i madh.

Faleminderit për borsalinon, do t'ia dërgoj asaj gruaje, i thashë.

Pse, e njihni?

Isha në shtëpinë e saj në Francë, në ishull. Koleksionin e fëmijës dhe Borsalinon ajo i ka blerë në ankand. Letrën ia dhurova unë.

Asaj i shkëlqyen sytë. Ishte një si dritë qesëndie e një njeriu që s'ka besuar kurrë. Tundi kokën. E dija që në atë shitje të nxitim të një copë bukë kishte dhe shumë mëri, hakmarrje për piktorin, që s'i kushtoi vëmendje.

E ku di unë nga këto, shtoi me një padurim nervoz.

Ndoshta ishte koha që të ndaheshim. Po ajo më ndoqi. Bleu në qosk një shishe kos dhe një gjysmë bukë të zezë. Duart, përplot me damarë të kërcyer blu me blana mavi, i dridheshin.

More, pëshpëriti, ajo grua seç më la një si kartë përpara se të shkonte. Shikoje njëherë dhe më thuj, se s'më bëjnë sytë.

Ishte një çek prej 70 mije euro. 1000 euro për çdo punë, siç e kishte lënë piktori në letrën testament.

Belbëzoi diçka nëpër dhëmbë, bëri kryqin dhe u zbut e u bë si foshnjë. Iu kthjellua të parit, iu hollua lëkura, i ndriti si nëpër mjerim një shkëndijëzë përdëllimi, natyrisht për atë që kish patur burrë dhe s'i pat besuar.

Ndoshta ishte hera e parë që po i besonte.

Ia dërgova borsalinon Amalisë dhe ajo më ktheu këtë përgjigje, pasi më falënderonte për gjestet e mia altruiste: "E shita 2 milionë..." E kishte fjalën për autoportretin.

Piktori ende s'kishte varr, vetëm një tra kryq ku qe sajuar me gozhdë emri i tij.



Kur nëna ime më lëshoi në këtë jetë, tre të tjerët prisnin pipth përpjetë të qarën time të parë. Thonë që nuk qava, biles brenda një ore thitha si i babëzitur një llokum, mbështjellë në një napë. Qumështi i gjirit sime mëje i erdhi pas pesë ditësh. Si fëmija i fundit më mbanin në dorë topt, deri kur ulërija me të qara për vaktin e radhës, ose kur pelenat i mbushja plot. Këtë e kam të fiksuar nga gjyshja ime. Sa herë mendohej të më bënte për të qeshur, më tregonte se unë kisha qenë një foshnjë e bukur, që nuk duroja dot urinë, por as mutin. I bie të kem pirë më shumë se ç'duhet, duke i bërë dëm vetes, por dhe nënës. Ajo lante e shpëlante gjithë pasditen pelenat, tek përroi në fund të shpatit. Mirëpo nuk qe kjo hataja. E tmerrshmja qe, se unë nuk isha si gjithë të tjerët. Kur dola pelenave dhe nisa të ec, të rriturit vunë re që diçka nuk shkonte tek unë. Shpatulla e majtë ishte pak më e ngritur dhe në fund të saj, ditë pas dite nisi të më rritej një gungë. Në fillim nuk u mërzhita, ishte koha kur ende më donin. Mirëpo verën e dhjetë të lindjes time, kur të gjithë po prisnim me padurim të ktheheshim nga stani, im atë urdhëroi që mua të më hipnin mbi nje pelë të vjetër. Ajo nuk bënte romuze dhe do të ishte më e rehatshme. Vura të ndjenjurat në shalë dhe drejtova sa munda shpinën. Ishte hera e parë që po hipja mbi një pelë. Zakonisht fëmijëve na hipnin mbi një qerre. Ishte torturuese gjithë ajo udhë, mbështjellë me dembelizmin e dy viçave, që herë pas herë ngrinin bishtin dhe lëshonin bajga. Kur pela sosi udhën, pak para reshtit të qerreve, unë po fluturoja gëzimit. Por, vëllai i mesëm, një hundëmadh, që nësë do ishte me të zgjedhur, nuk do ta zgjidhja kurrë për vëlla, më pa vëngër nga qerrja dhe më tha: “Mos u krekos kot, Gungaç!”. Zbrita i pikëlluar pelës. Që nga ajo ditë, një trishtim i skajshëm do të lëshonte degë nëpër qënien time. Në fillim u mbylla në vetvete, nuk flisja me asnjë, përveç nënës. Më pas lashë dhe atë biçim shkolle, një njëkatëshe që kishte një banjo të gjatë, pa dyer. Më duhej që gjatë gjithë mësimit të nuhasja erë e mut e shurrë.

Jeta ime u terr si një mot i lig. Dilja çdo ditë bri xhades e prisja me padurim Berën, një burrë shpatullgjërë, që vinte përpara një tufë kuajsh e nisej përpjetës. Por, dhe qëndrimi im bri xhades kishte pikëllimet e veta. Më duhej të duroja ngacmimet e moshatarëve. Kur kalonin në këmbë nuk më ngisnin, madje më shihnin me dhembshuri. Por, kur kalonin hipur në ndonjë karrocë ose qerre, vinin dy pëllëmbët gojës dhe thërrsinin në kor “O Gungaç, ik ujku. Ulja kokën dhe ngashërehesha në lot. Më pas e mblidhja veten dhe vrisja mendjen, ç’kuptim kishte ajo fjali “O gungaç, ik ujku”. Unë nuk i kisha frikë ujqërimit, biles dy herë kisha marrë guximin dhe kisha dal në pyll krejt i vetëm. Isha rrekur të gjeja llavën e lig, që më hëngri një mëz të zi. Imë më më thoshte, që kur mëzi të rritej, unë do të shërohesha. E laja çdo ditë me lot ahurin e tij, jo vetëm nga dhimbja, por edhe nga makthi se nuk do të shërohesha kurrë. Gjithsesi, dhe pse xhadeja më bënte të përballesha me grupe të çmendura njerëzish, unë dilja çdo ditë bri saj. Ishte mëzri e tmerrshme të rrija mbyllur në një shtëpi të vjetër, sovatar me botë të kuqe. Drita në të nuk hynte shumë, sepse nga të gjitha anët rrethohej nga degë hardhishë, që për dreq kishin vite nuk bënë ansjë bistak. Makthi arrinte kulmin, kur kalonin “djemtë e çmendur”, që vrisin thëllëza me kërrabë. Pluhur e mllef linte pas vrapi i tyre. Shpeshherë bënë sikur gjuanin në degën e arrës, bri xhades, por shënjestronin gungën time. Në këto raste jo vetëm qaja, por kthehesha me vrap tek pusi i vjetër në mes të oborrit dhe ngjitesha mbi murin e tij. Isha i sigurtë, që përveç gjyshes që kotej rrëzë oxhakut, të tjerët ishin pas punëve. Bëja të hidhesha e t’i jepja fund jetës, por pikërisht gunga më pengonte. “Po sikur ajo të kapej



GUNGAÇI

Tregim nga
Shqiponja Axhami

në ndonjë të çarë të murit të pusit?”, thojta me vete. I bie që të mos bie në ujë. Do të më nxirrnin me ndonjë kërrabë druri. Imë më do lemeritej, por të tjerët do të thonin që unë nuk qenkam i zoti as të vdes. Jo pak herë, të lodhur nga punët e stinëve vëllezërit më shanin, “ngordhalaq”. Së fundimi ata e a patën kuptuar dhimbjen time. Nuk me thonin më gungaç, as nuk më urdhëronin për ndonjë punë, por kjo ishte torturuese. Më dukej vetja i padobishëm për asgjë. I shihja tek punonin me vrull dhe trrusesha edhe më në gungën time. U tjetërsova, nga një djalë i bëshëm u ktheva në një kufomë te verdhë, me gjymtyrë të gjata. I vetmi gëzim për mua ishte, nëna ime. Në darkë, pas punëve të lodhshme të ditës, më merrte pranë vetes. Më përkëdhelte duke më thënë, që Zoti kishte vendosur për një qëllim, që unë të isha ndryshe nga të tjerët. Këtë unë duhej ta merrja si shenjë. Mirpo, edhe ky ngushëllim zu u shua. Brenda brinjëve të mia përsiatej një terr i tmerrshëm, që po më zinte frymën. Edhe pse i kisha kaluar të tetëmbëdhjetat, jeta ime ishte si jeta e një fëmije. Zgjohesha pa asnjë motiv, nuk kisha asnjë detyrim, asnjë punë, vetëm të ulesha bri xhades. Bera vdiq dhe tufa e kuajve, që më bënin të ngazëllesha, u shpërnda. Mbaj mend, që i dërguan në një fshat të largët. Bri xhades njoha dhe Marën, të bukurën Marë. Ajo shkëputej gjithmonë nga shoqet dhe vinte pranë meje. Qëndronte aq minuta, sa të më linte në duar një kulaç të ngrohtë, ose ndonjë frut të stinës. Më pas largohej duke më thënë “Mos u mërzhit”. E dashuroja si i marrë dhe mezi prisja të dilte mëngjesi e të shkoja bri xhades. Por, një ditë, kur shoqet i klithën duke i thënë se ishin vonë për shkollë, e dëgjova duke u thënë: “Më dhimbset, është gungaç”. Më therën si thikë fjalët e saj. Unë mendoja që edhe ajo më dashuronte. Dy javë nuk dola përjashta. Qaja dhe dridhesha trrusor në minder, si të më kishte rënë lija. Por terri i të mbyllurit brenda, ishte më i ethshëm se çdo dhimbje, ndaj nisa të dal prapë bri xhades. E tillë qe jeta ime, derisa një ditë tek po shihesha në pus me inatin e ethshëm, që nuk mund të merrja guximin as të vdisja, një klithmë e motrës më drodhi deri në placë. Nëna ime kishte dhënë shpirt. Prej disa muajsh vuante nga një dhimbje e tmerrshme e shpinës. Edhe pse e sëmurë, ajo mblidhte

forcat dhe më merrte pranë vetes si të isha ende fëmijë. Më thoshte se do ia dal nëse nuk dorëzohem, e të tjera si këto. Vdekja e saj e ktheu terrin tim në helm. Ndieja që i gjithë trupi më gëlonte vrer. E varrosën të nesërmen. Ishte dimër. Një dëborë e madhe pati rënë, ndaj mua nuk më morën tek varrezat. Për dreq dimrit gunga më therte si thikë. Kjo stinë ishte makthi im, nuk dilja dot as bri xhades. Gjithsesi, pasi ngashëreva me orë në minder dhe nuk pranova të ha asgjë, edhe pse gjyshja nuk la gjë pa nxjerrë nga sënduku i saj, u ngrita kur të gjithë flinin dhe u nisa drejt varrezave. Dëborat kishte mbuluar gjithçka, por një hënë tmerrësisht e bukur më acaronte. Të fshatit kishin hapur rrenë dhe në anët e saj ngriheshin shpatet e dëborës, gati 1 metër. Unë nuk kisha frikë. Një dëshirë e ethshme më vlonte përbrenda, që t’i hidhesha sipër varrit të sime mëje. Kisha një ndjesi që ajo do më shihte dhe do m’i fliste prapë ato fjalë. Hëna ishte e plotë dhe shquaja shumë mirë rrafshinën e varrezave. Kur u afrova bukur shumë, një gjë e zezë m’u shfaq përpara. Hëna ishte e plotë dhe unë e shihja fort mirë, gjëja po lëvizte drejt meje. Kuptova që nuk ishte njeri, por kafshë.

Pashë dy sytë e tij fort mirë, shkëlqenin drite. U shtanga, ndala hapin, por ai po afrohej drejt meje. Ishte një ujë. Kisha dëgjuar që ata kishin bërë kërdrinë në fshat dhe nuk kishin lënë qen e vathë pa shqyer, por nuk u tremba. Fundja unë kisha kohë që miklohesha nga vdekja. Ato çaste vetëm përpiqesha të imagjinoja, se sa e fortë do të ishte dhimbja e dhëmbëve të tij dhe sa orë do të më duhej të më dilte shpirti. Gjithsesi, edhe pse vdekja më kishte mikluar prej kohësh, përpiqesha t’i jepja vetes ngushëllim. Gjyshja më thoshte gjithmonë, që pas vdekjes shpirti ikën shëtit në një fushë me grurë, rrethuar nga mana të kuq. Unë i adhuroj manat. Tek përpiqesha të gjeja në mendjen e mpirë diçka që më largonte nga ajo gjendje, shtërngova deri në dhimbje sytë. As vetë nuk e kuptoja se pse nuk doja ta shihja kafshën, duke u afruar drejt meje. Por kjo nuk do shumë shpjegime, unë isha i frikësuar deri në palcë. Pas vetëm pak sekondash, kafsha m’u afrua pranë, duke nxjerrë një hungërimë mbyhtëse. U trrusa dhe më në gungë krejt pa frymë, por për çudi nuk ndodhi asgjë. Kafsha ulëriu

disa herë me kokën lart. Këtë e kuptoja ngaqë nuk e ndieja frymën e saj në palë të qafës. Nuhati disa herë rreth gungës time dhe iku duke u larguar me një vrap shigjetë. Sytë mu mbushën me lot. Dhjetra vegime m’u shfaqën para syve, gjyshja, pusi, tufa e kuajve, nëna e vdekur, turma që më gjuanin me kërrabë, Mara, mëzi i zi. Doja të pëlcijsa nga frika, tmerri, dhimbja, mllef. A thua isha kaq i pështirë sa nuk më preferonte të më hante as një ujë?

Pas një copë here mblodha veten dhe u nisa drejt varrit të nënës. Një brejtje e brendshme më bënte ta urreja dhe atë. Përse më kishte gënjyer? Të nesërmen lajmi u hap në gjithë fshatin, se unë na qenkësja Shenjt. Kjo, sepse më gjetën të ngrirë mbi varrin e nënës, rrethuar nga një llavë ujqërish. Fakti që ata nuk më kishin shqyer, i bënte të mendonin se unë kisha diçka të pazakontë. Nuk kaluan as tre muaj, në fillimin e praverës, bri xhades, të tjerët do shihnin shenjtin. Më përsëndetnin gati me përulje. Çmenduria arriti deri aty, sa nuk më kthenin menjëherë shpinën. Një shenjt nuk i kthehet menjëherë shpina. Më largoheshin duke m’u përkulur. Për herë të parë në jetën time më dukej vetja ndryshe, por e gjitha ishte qesharake. Unë nuk isha shenjt dhe llava e ujqërve nuk më kishte ngrënë, se mbase mund të isha i pangrënshtëm. Atë verë im atë u martua. Njerka, një grua e gjatë me llërë të forta, por aspak e bukur më bëri gati dhomën e miqve. “Ti je shenjt, shumë shpejt do na vijnë nevojtarë” më tha, pa lënë t’i shpjegoja që kjo nuk ishte aspak e vërtetë. Ajo vari në faqet e murit disa libra të vjetër. Më rrasi në kokë një tip qelleshje dhe më porositi disa here, që sa herë të vinin njerëzit të numëroja tespijtë. Kjo është çmenduri i thashë tim etj, unë nuk jam shenjt, jam thjesht një gungaç. Por ai vuri buzën në gaz duke më thënë vetëm një fjali

“Mos fol bir”, vetëm shërbeju njerëzve.

Kështu nga një gungaç i mjerë, unë isha një shenjt. Jetoja mes dy maktheve, pikëllimit tim të ethshëm prej gungaçi dhe pamundësisë për të bindur të tjerët që nuk isha shenjt. Në të vërtetë, vetëm pas pak ditësh, njerëzit u dyndën në shtëpinë time. Vinin për halle të ndryshme. Dikujt nuk po i mbinte farë e grurit, dikujt lopa i thithte veten, dikujt tjetër nuk i ngjizej gruaja etj. Detyra ime ishte, t’i prekja me tespijë tek koka dhe t’u jepja pak ujë nga një polik, që njerka ime nuk harronte ta mbushte sa herë boshatisej. Ajo që më llahatariste më shumë ishte se çdo darkë, kur lëshohesha në minderin tim i stërlodhur, njerka ime qeshte gati me të madhe, lumturuar nga sukseset e mia. Gruri i Gjetajve kishte zënë të mbinte, lopa e mullixhinjëve nuk e thithte më veten, nusja e Palajve ishte ngjizur ding etj. Si ka mundësi përtypja me vete, duke parë i xhindosur gjashtë të tjerët, tek u turrreshin kavanozave me mjaltë që sillnin hallexhinjtë. Edhe pse nuk e besoja të qenurit shenjt, nisa të bëj i detyruar jetën e një shenjti. Njerka më porositi një çallmë të gjatë, duhej të isha i veshur bindshëm. Kuptohej, ajo donte që magjia e saj të ishte plot. Hallexhinjtë ç’nuk sillnin, mjaltë, pula, vezë, shpesh herë dhe para. I stërlodhur nga ajo jetë i kalova të tridhjetat, por të më krahasoj me moshtarët e tjerë, ngajaja shumë më i plakur. Për të thyer pak monotoninë e atyre vizitave, që çdo ditë e me shumë shtoheshin, nisa të kem interes e të njoh se kush ishin hallexhinjtë. Një natë, erdhi një grua rreth të pesëdhjetave. E njihja fort mirë, ishte nëna e Palit. Disa herë i kisha shkuar në shtëpi dhe isha ankuar për të birin. Jo pak, por tri herë më pati qëlluar në gungë. Desha t’i ulëras, por e mbajta veten. E dëgjova më vëmendje hallin e saj. I biri, Pali edhe pse ishte burrë i madh urinonte në shtrat. “Duhet të pijë për katër muaj çdo të martë shurrën e vet” i thashë. Ajo brofi e lehtësuar. Pas pak e ndoqa më të ngashëryera, që t’i thoja që isha tallur, por ajo qe larguar. Pas katër mujash erdhi

bashkë me Palin dhe një qengj të zi dhuratë. Pali nuk kishte urinuar më në shtroje. Nga njëra anë më brente ndërgjegjja , nga ana tjetër nisi të më rritej një dëshirë e ethshme hakmarrje, kundrejt të gjithë atyre që më kishin lënduar. Kështu vëllait të mesëm, që i dilte në ëndërr çdo natë një cjav i egër duke e tmerruar, i thashë që duhej të më mbante tri herë në shpinë, deri tek rrafshina e varrezave. Djemve të çmendur, që tashmë ishin burra dhe të gjithë kishin nga një hall më vete, dikujt nuk i ecte gjahu, dikujt pjella , dikujt martesë, i vura përpara detyrave qesharke si: Të më rruanin qimet në të gjithë trupin, të flinin një natë poshtë të ndjenjurave te mia, të më puthnin gungën, të shkonin në majë të malit e të bënin dyzet lëndë ahu etj. Fjala ime ishte ligj, ama edhe ata u gëzoheshin halleve që unë ua zgjidhja. Ishte e pakuptimtë dhe paimagjinueshme ajo që po bëja , duke qenë i bindur që unë nuk isha shenjt. Isha kthyer në një krijesë të dyzuar, nga njëra anë një hakmarrës i shpifur dhe i lig, nga ana tjetër shembesha përmbrenda i mbytur në faj. Çdo ditë që kalonte, edhe doja të vdisja, edhe doja të jetoja. Nisa ta doja me shpirt kohën e vjetër kur isha thjesht një gungaç. Një natë dimri, zhytyr në postiqet e mia përgjumur, m'u shfaq në derë Mara. Martuar prej dhjetë vitesh, nuk kishte lindur fëmijë. Sytë mu mbushëm me lot kur e pashë. Mezi nxora një fjalë “ ulu”. Nuk di nga ç'forcë e tmerrshme a ç'kthinë e terrtë e trurit, iu binda dëshirës që atë natë të flija me të. “Marë, duhet të më jepesh mua sonte, nëse do fëmijë ” i thashë dhe mbylla sytë duke numëruar tespijtë. Nuk kisha prekur kurrë grua me dorë dhe as që e dija se çfarë ishte të bërit dashuri. Prita një copë herë symbyllur çdo të thoshte, por nuk bëzajti. Kur hapa sytë, e pashë të zhveshur cullak para meje. Iu hodha sipër si një copë buke të ngrohtë, kur je fort i uritur. Nuk e kuptoja nga po me vinte gjithë ai epsh. E mbështolla poshtë vetes, duke u jaragavitur mbi të plot dëshirë, megjithëse gunga më therte hesë pas here. Vure re që ajo mbylli sytë, por unë iu hakërrova duke i thënë, që nëse i mbyll sytë nuk do të ngjizte kurrë një fëmijë. I hapi dhe më pa thellë në sy. I afrova buzët, duke i pëshpëritur që e kisha dashur gjithë jetën. Pas pak edhe ajo m'u dorëzua dhe nisi të më puthte e përkëdhelte me shumë dëshirë. Në fund me tha, që kurë nuk kishte ndier aq zjarr dhe aq dëshirë. Isha kthyer në monstër. Çdokujt që vinte i jepja jë dënim dhe pas kësaj ngashërehesha në të qara si fëmijë. Për Marën mora vesh që qe ngjizur dhe për katër vite bëri tre djem të bëshëm, si kokrra e mollës. Këto i dëgjoja nga njerka, që duke iu trembur shendetit tim, më mbushte kotruven me qumësht dhe mjaltë, çdo pasdarke. Padyshim që i duhesha. Përfitimet nga puna ime e ndyrë na ndryshuan jetën, por askush nuk e kuptonte dhimbjen time të brendshme. Po sfilitesha. Kështu vit pas viti, derisa arrita rreth të pesëdhjetave. Kisha mbetur një grusht kockash. Ndihesha i stërlodhur dhe drejt fundit. Nami im si shenjt kish marrë dhenë, vinin nga fshatra të ndryshme. Një natë kur të gjithë flinin , hoqa çallmën jeshile , qeleshen dhe ula të pi kafen e fundit. E kisha vendosur, do hidhesha në pus. Nuk e di pse prita të zbardhte agimi. Mbylla sytë duke përfytyruar ato pak çaste të bukura të jetës time dhe bëra të ngrihem vrellshëm drejt derës. Në ato çaste dera u hap me forcë, si ta kish shtyrë një stuhi e papritur. Në derë u shfaq një djalë rreth të njëzetave. Ishte i gjatë, zuri gjithë derën, por edhe ai si unë rrinte shtrembër. Ishte gungaç. Nuk dija ç'të mendoja më parë. A mundesha unë të shëroja një gungë tek njerëzit? Këtë nuk e kisha menduar kurrë. Unë nuk isha një Shenjt. Përse m'u shfaq ky njeri përpara se të përqafoja vdekjen? Djali më vështronte plot urrejtje. Kjo më çuditi. Desha ta pyes kush je , por jë krismë çau ajrin e ndenjur të dhomës. Më vrau. Tani nuk e di, duhet të jem në gjendje kome. Arrij të shoh çdo gjë, por nuk mund të flas. Njerka vjen vërdallë me disa enë bakri me ujë të ngrohtë. Ia kërkon një mjek që po merret me plumbat e mi. Vërej se im atë dhe vëllezërit qajnë. Nuk di nëse do të vdes, apo do i rikthehem jetës, por asgjë nuk me bën më përshtypje. Vetëm dua të di me shpirt, kush ishte ai djalë që më qëlloi. Kur mjeku lëshon plumbat në një pjatë alumini, dëgjoj pëshpërima nga ana e majtë e trupit, “ E vrau kopili i vet”. Nuk e shquaj saktë se kush flet, por nga zëri kuptoj që është njëri nga kurshërinjtë. Përpiqem të shtërngoj sytë dhimbje, por nuk mundem. Unë paskam një djalë! Unë vdiqa prej tim biri! Dua të shpërthej në lot, por as këtë nuk e bëj dot. Gjendja e komës qenka më e tmerrshme se vetë vdekja. Dëgjoj mjekun që përsërit, “valium, valium”. Nuk shoh më asgjë, vetëm një hapësirë të bardhë, të gjërë. Është rrafshina e varrezave, ajo borë e asaj nate, ajo hënë. Unë jam në mes të një rreje. Jam një gjë e zezë, e madhe, jam një ujë. Nga larg dalloj tim bir që avitet, mbase po më vjen tek varri. Mbase nuk kam vdekur ende, mbase jam në gjendje kome. Por, e njoh fort mirë është djaloshi i mëngjesit, që gjuajti mbi mua jo pak, por tri herë. Shndërruar një një kafshë të lig ulërij para tij. Kam dy mundësi ose ta shqyej, ose ta fal. Një ulërimë vjen nga pylli i errët më dhe bën t'i largohem e të shkoj të ndjek llavën që më hëngri mëzit tim të zi, që nuk arriti të rritej e të më shëronte kurrë. Kur kaloj rreshtin e parë të pishave, nga lart, shoh tim bir plandosur mbi varrin tim , duke qarë.

PËRKUJTIMI

tregim nga
Shqiptar Oseku

Ierdhi keq që Arlinda po e shikonte prapë në këtë gjendje, Ipor s'ishte e zonja të ndryshojë diçka. Më fal që ta prisha prapë natën, i tha pa e këqyrë në sy, por s'dijsha kah me shku. Zëri i Arlindës qe i qetë, rehatues. S'më prishe moj natën, bane mirë që erdhe. E di që kjo javë asht e zorshme për ty. A do me pi?

Ajo adhuronte këto çaste me Arlindën, këtë ritual të përvitshëm të shoqërimit. Një botile whisky, dy pako cigaresh, divani i rehatshëm në dhomë të ditës. Rrëmuja e dhomës, që dëshmonte për një jetë familjare, e mbështillte gjithmonë me një ndjenjë rehatie.

Ishin njohur që në banga të fillores, gërshetat e Arlindës i kujtoheshin si sot, e ishin shoqëruar ndër vite me pak shikëputje. Pas luftës, Arlinda kish zgjedhur jetën në familje. Ish martuar me një koleg, kish bërë dy fëmijë. Ajo tashti mbahej zonjë, me fustane të shtrenjta e rruaza perlash, ja kështu si sonte, e duar të qëmtuara me manikurë. Por dikur ato kishin luftuar të dyjat në front. Dhe kjo u kish krijuar një lidhje të fortë, çfarë e kanë vetëm veteranët.

Sa mirë që nuk janë Goni me djemtë këtu, i tha, më kish ardhë siklet me pasë qenë. Arlinda mbushi dy gota dëng. U shtoi nga një pikë ujë, i tundi pak, e ia zgjati njëren në heshtje. I ke fort të mirë, Zoti t'i ruejtë, por ti e di si po mendoj. Arlinda piu ngadalë një gllënjë, i dha vetes kohë që ta shijojë, mandej ndezi një cigare. U kënaq me tymin gjatë, gjatë, para se të fliste. E di Edonë, tha dikur, e di; shyqyr që shkuen, se më patën luejtë mendjen e kresë. Edonës i plasi gazi. Djemtë e Arlindës ishin të gjallë, si e ama dikur. Të kanë ngja ty, i tha. Qeshën të dyjat. Çuan në heshtje gotën e dytë, e të tretë. Një dorë e padukshme filloi t'ia zgjidhte Edonës një nyje në krahëror: një, nga shumë sosh.

Goni shkonte çdo prill te prindërit e vet në fshat, për të kremtuar pranverën. Katunar hesapi, tallej Arlinda, por ai kish dëshirë që djemtë të prisnin pranverat në fshat. Kjo përshtatej fort mirë për Edonën, se java e dytë e prillit ish re e zezë sterrë për të. Zbrazti gotën prapë, e ndezi një cigare. Arlinda po e këqyrte nga këndi i vet. Xhinsa blu të vjetër, një triko jashtë mode, flokët kaçurrela në një bisht të pakrehur. Edona dukej e thyer, e lakatur nga jeta. Çdo prill e njëjta torturë.

Celulari i Edonës ra dhe ajo brofi ta hapte. Arlinda kafshoi buzën, kjo na duhej. Kush asht, tha Edona gjithë nerva. Kush asht. Por thirrja u ndërpre. Edona përplasi telefonin në tryezë. Imagjino të lutem, çdo përvjetor kështu a. Thirrje pa nam, e pa nishan. Arlinda ia mbushi gotën prapë, pa e pyetur. Mos u ban budallë Edonë. Normal që gjindja i bien gabim telefonit. Por Edona ishte shashtisur tashmë. Por çdo vit njësoj a, mu në këtë ditë. Si s'bani vaki një herë mos me ndodhë, a. Një herë mos me ra kot, ai dreq celulari.

Arlinda psherëtiu. Kur Edona të niste monolog me whisky, s'kish njeri që ta ndalë.

Imagjino a, çdo herë e njëjta gja, bie ky i zi celular e kurrkush s'folë. Është si thirrje nga ana tjetër, a merr vesh. Është sikur më thërret ai, nga ana tjetër. Edona çoi gotën me fund; Arlinda ia mbushi menjëherë. Pasha besën është si me qenë ai Arlindë, si me qenë ai që më thërret çdo vit. Ma kujton që e kam pre në besë. Arlinda deshi të flasë, por s'arriti.

Celulari ra prapë dhe Edona e hapi prapë, duke këqyrë e flakëruar nga Arlinda. Kësaj radhe nuk tha gjë, vetëm e mbajti celularin te veshi. Arlinda mund të dëgjonte ca si krikëllima, si kërcitje në radiolidhje. Por jo ndonjë zë njeriu. U zgjat, e ia hoqi Edonës ngadalë celularin nga dora. E fiku, e ia la afër në tryezë.

Edona zbrazti gotën prapë e nisi të lëkundej si lavjerrës, ulur tek ishte mbi divan. U desht me ia ble ato pllakat e namuna kur e pata rastin, Arlindë. U desht me ia ble, që mos me më ndjekë kështu vjet për vjet. Po harrova, emni m'u harroftë. Më dhanë leje nga komanda mue me shku në Kukës, Arlindë, e me hasë familjarët e mi, kishin ardhë atje si refugjatë si tanë tjerët. E mbaj mend si sot: e martë,

6 prill 1999. Hej mos harro me m'i ble pllakat, më thotë. E unë i them, hajt Ben mos ban dramë se shihemi prapë. E ai më lutet, amanet më blej një aso qafore, me pllakat ku skalitet emri, se s'due me humbë pa nam e pa nishan. E unë baj hajgare me të Arlindë, a merr vesh a jo. Baj hajgare me të. Hajt Ben se s'të do ty as dreqi. Hajt Ben se s'bjen rrufeja ndër hitha. Hajt Ben se s'të ha ujku ty. Luej me të Arlindë, a merr vesh a jo. Luej me të.

E mandej harroj Arlindë, harroj, he ma harrofshin emnin. Harroj me ia ble atë qafore të mallkume. Më kish marrë malli për familjen Arlindë, për mamën. Kish dy vjet që s'ishim pa, qyshkur pata dalë ushtar. Ti e di vetë si të merr malli në front, e ke provu vetë. Kaluen dy ditë si mos me qenë. E të premtën nadjë herët më 9 prill, Beni me shokët ndezën luftën në Koshare. Aty kuptova Arlindë. Aty e dita, se më paskan dhanë leje për me më nisë prej frontit. Se u ka thanë Beni, me m'largu matanë. E mue m'u errën sytë kur ndiva radion. E dita n'vend se çka po bahet. U ndava prej familjes tue true e tue sha me za të naltë, Arlindë, a e merr vesh a jo. Tue true Benin, tue sha Benin. Ah pritmë Ben zeza sa të vi, se ahëre sheh luftë me sy. A më beson Arlindë, u nisa nga mama tue true Benin. U ndava tue sha Benin. E aty harrova me ia ble atë qaforen. Atë qaforën me pllakëzat e vogla, Arlindë, ku u shkruenjë emnat ushtarëve. Harrova, emni m'u harroftë!

Edona heshti, e i ktheu shpinën. Çdo prill përsëritej e njëjta torturë. Baj mirë që i nis prej këtu Gonin me fëmijët, mendoj Arlinda, duke ndier një sëmbim në krahëror. Një bollë e paemër e shtrëngonte, si kafshim në errësirë. Unë kam familje. Kam një burrë i cili më do, kam fëmijë. Jetë pa probleme s'ka askush, por unë së paku kam një jetë. E Edona? Ajo ka vetëm një kujtim, që i flen në Koshare.

Rëndesa e kësaj padrejtësie të paanë e shtypte çdo vit, sa herë që i trokiste në derë Edona. E ajo i trokiste në derë rregullisht, çdo prill në të njëjtën kohë. Ashtu si stina e pranverës. A si kthimi i shpendëve shtegtarë.

Kot e mundon veten Edonë, i tha me zë të ulët, sa për t'i thënë diçka. Zëri i doli i mbytur, iu kish mbledhur një si komb në grykë. Beni s'u vra pse nuk pati pllakëza, ti e di. Thjesht aty e ka pasë të shkrueme.

Celulari i Edonës ra përsëri, si bombë. Edona u drodh, por s'kish më fuqi të zgjasë dorën. Një herë. Dy herë. Tri. Arlinda u zgjat vetë dhe hapi celularin. Alo? Kush është, alo? Alo?

A asht Edona aty. Burri nga ana tjetër mezi kuptohej mes kërcitjesh. Po asht, tha Arlinda duke ngritur zërin, por asht pak e zënë. Kush e kërkon? Alo? Alo? Kërcitjet vazhduan ca kohë, pa u ndier më njeri. Pastaj lidhja u këput.

Edona kish ngelur e kthyer matanë, me shpinën nga Arlinda. Ka me m'thirrë Beni prapë Arlindë, i tha me zë të mbytur. Ka me m'thirrë prapë, sa herë të vjen pranvera. Se do me ia lanë te kryet qaforen me pllakëzat, e di. I kam ble, i kam këtu te zemra. Por s'mundem me ia lanë te kryet Arlindë, nuk mundem.

Pse, pyeti Arlinda. Pse s'ia le emnin te kryet.

Se atëhere Beni s'më thirrë ma.

Edona u shtri ngadalë si zombie e dehur në divan, ashtu siç ishte, dhe Arlinda ia mbuloi shpinën sipër me një mbulesë që ish afër. Flej shoqja ime, flej. Flej se ta ruej shpinën unë. Celulari ra prapë, por këtë herë Arlinda ia fiku tonin.



Gano rrinte ulur në karrige dhe vështronte lojën e rrezeve të diellit në perden e dritares së zyrës. Trokiste gishtërinjtë në tavolinë dhe vërshtëllente një melodi të njohur me një ritëm të ashpër. Kishte një javë që s'kishte bërë ndonjë punë, me përjashtim të dy ditëve, kur kishte qenë në një kooperativë, për të sqaruar një letër anonime, të cilës nuk i doli njeri për zot dhe ai e mbylli këtë ece-jake me një drekë të bollshme, por të mërzitshme. Sa koha kalonte, atë e kaplonte një boshllëk i vazhdueshëm dhe ai, kryetari i komitetit ekzekutiv, e ndjente stresin si një gjëmë e pathirrur, por që duhet duruar. Sidomos, nervoz bëhej kur dikush i vinte në zyrë dhe i qante hallin dhe ai detyrohej të dëgjonte një zhargon njerëzish të pagdhendur, të cilëve, në fillim u tregonte ndonjë anekdotë e pastaj i thumbonte me marifet, duke treguar një sqojtësi të hollë prej intelektualit, që di të kripë llafin me terma të zgjedhura.

Kur dikush me guxim mundahej të përballte fyerjen, kryetari i nderuar e ndjente për detyrë të tregonte epërsinë e postit të tij, duke i ulëritur se do të jepte urdhër për ta lidhur, atëherë guximi i tjetrit shkrehej ngadalë- ngadalë dhe kryetari e qortonte, duke ndërruar taktikë, për t'i treguat se mendja e tij ishte e papërballueshme. Njerëzit e shkretë vinin për vetulla e nxirrinin sytë dhe ai s'e kuptonte këtë, duke humbur ndjesinë e të qenit njeri.

E pra, ai dikur kishte qenë një masovik i palodhur, që u hidhte dorën në qafë fshatarëve, u jepte kurajo dhe optimizëm revolucionar dhe, për këtë, katapulta e karrierës e ngriti, nga një veteriner mediokër, në postin e kryetarit të komitetit të një rrethi industrial.

Duke parë rrezet e diellit që loznin me tylin dhe perden e trashë, ai ndjente një squllje të habitshme. Por sakaq nga koridori vinte një zhurmë me luhatje.

Shtypi butonin e ziles dhe në derë u shfaq Avniu, sekretari i tij.

-Ç'është, mo!...

Këtë pyetje e përsëriste ,si një shprehje që i vinte vetiu,edhe kur në korridor ishte qetësi.

Sekretari ishte i zverdhur në fytyrë, por e mblodhi veten.

-Shoku kryetar, një fshatar...

-Një fshatar, ç' do ky?

-Kërkon t'ju takojë.

-I thuaj se nuk pres njeri sot!

Dera u mbyll ngadalë, por, pas një minute, zhurma u shtua edhe më tepër. Ganos iu duk se rrezja e diellit u drodh dhe, për një çast, ajo sikur i erdh afër si tel i skuqur. Zhurma herë ngrihej e herë ulej, me një ritëm çmendurak... Shtypi me forcë butonin.

Avniu menjëherë u duk në derë.

-Hë?!...

Nuk shkulet nga dera, shoku kryetar!

-Përzëre!

Tjetri u zverdh si meit.

-Hë qullash, fute brenda, se më erdhi në majë të hundës!...

Sapo tha këto fjalë ,fshatari u duk në derë.

Ai u ul menjëherë në kolltuk, pa i thënë kush se duhej të ulej. Kryetari e pa me vëmendje dhe rrudhi buzët, duke mos i ardhë mirë që ky kokorocc ulej si në shtëpinë e tij .

Ishte një burrë i bëshëm;në fytyrën e tij rrudhkat e thella tregonin vuajtje. Dukej i paepur dhe këmbëngulës.

-Nuk kam kohë për muhabet shtruar, por fol si e ke hallin?

-Kam 15 vjet që punoj në minierë e kam 6 kalamanj të vegjël ,që duan të hanë!...

-Nuk të jap unë bukë, bukë të jep puna!

-Aty e kam fjalën, më ka hequr nga puna kryetari i këshillit të fshatit dhe ka futur në vendin tim kunatin e motrës së tij.

-Kjo, more vëlla, është kompetencë e këshillit, ti i di ligjet, unë këshillin e fshatit nuk e urdhëroj dot.

-Pikërisht, kryetari i këshillit ka shkelur ligjet, këshilli ka votuar për mua, si njeri hallexhi, ndërsa ai ,në mënyrë të fshehtë, letrën ia ka dhënë kunatit të motrës.

Kryetari e kuptonte se kështu ishte, po si mund të hidhte poshtë mikun e vet, Zaim Zarën, me të cilin dilte herë pas here për gjah, shtrohej

KALI I REXHËS

Tregim nga Qazim Shehu

në darka e në dreka të paqme dhe kishte kohë që ndjente ngrohtësinë e respektin e tij në formën e dhuratave, jo pak të leverdisshme.

Ndërsa mendonte kështu, fshatari e ngriti tonin e zërit:

-Ju duhet të merrni masa për atë zyrtar të poshtër që shkel ligjet. Që sot unë dua nga ju letrën, për të shkuar ne vendin tim të punës!

-Shko, puno një vit në kooperativë, nuk bëhet kiameti, kooperativën nuk do ta mbajnë vetëm gratë e gjora, - foli butësisht kryetari.

-Nuk i mbaj dot fëmijët me një tre- lekësh për ditë pune, - tha fshatari dhe në zërin e tij një drithërimë sikur ia zbriti ngrefosjen e fillimit.

-Largohu tani, më duket se të sqarova.

-Si mund të largohem, shoku kryetar, ku të mbytem?! Të punosh sa vite në minierë, të marrësh kaq medalje dhe të të heqë një maskara prej pune, kjo është ç'është!...

-Si mund të thuash kështu për një kuadër që e ka zgjedhur populli? — ngriti tonin e zërit kryetari.

-Por partia s'thotë të bëhen padrejtësi dhe ajo u ka vënë ju këtu,për t'u zgjidhur hallin njerëzve.

Ky fshatar ishte brisk nga goja dhe arsyetimet e tij po e nervozonin . Nuk i kishte ndodhur ndonjëherë, që hallexhinjtë e shumtë të flisnin pa u lutur,me një këmbëngulje kaq krenare në të tyren. Kryetarit i ishin skuqur majat e veshëve dhe ndjente një buçitje në tru.

-Dil jashtë!,- i ulëriu.

-Dil ti, kjo është zyrë e popullit!

-Këtu populli më ka vënë mua, kur të bëhesh ti kryetar, vepro si të duash!...

-Ti nuk e kryen mirë detyrën.

Jo kjo nuk durohej!Do të lajmëronte policinë,por shpejt e mblodhi veten.

-Të lutem shumë, shoku punëtor, unë zgjidh atë hall që zgjidhet!.

-Halli im është i zgjidhshëm, më jep letrën të shkoj në vendim tim të punës!..

Si të bënte? Ishte hera e parë që binte në një pozicion të tillë.

“Mirë, -tha kryetari,- rri në zyrën time, unë po dal, rri me Avniun e tregoni anekdoda”.

Kryetari u mat të dilte, po ndërkohë u çua edhe fshatari. Ishte zverdhur në fytyrë dhe i dridhej buza e poshtme.

-Fillova të kuptoj se ti nuk ke faj, shoku kryetar...

-Kështu pra, bëhu i arsyeshëm,- murmuriti kryetari.

-Jo, shoku kryetar, ti nuk ke faj, ti që vrave Rexhën, nuk pyet për asnjeri në këtë botë.

-Rexhën? Cilin Rexhë?!...

-Po, po, ti ke vrarë Rexhën!, - ngriti tonin e zërit fshatari, duke iu drejtuar atij me gishtin tregues dhe ,me një hap të shpejtë, doli përjashta ,pa përshëndetur.

Kryetari ndjeu një pickim në zemër. Ai mbështeti bërrylat në tavolinë dhe ngjeshi fytyrën midis pëllëmbëve. Ky minator kishte biseduar me të si i barabartë, por, edhe tani, duke hedhur një shashkë, e akuzonte për vrasje. Para dy vitesh, dikush ishte vrarë në gjueti dhe vrasësi nuk ishte gjetur akoma. Mos vallë ky i poshtër kurdiste ndonjë rreng, shkruante ndonjë letër anonime dhe Sigurimi, për të mbuluar mos-gjetjen, e piketonte atë ,si autorin real të vrasjes? Për disa minuta, i mbeti mendja tek ajo fjalë, e thënë në kalim,ndoshta si shaka, si një rrufe në qiell të kthjellët.

Ngriti kokën dhe pa Avniun që po rrinte si i ngurosur, me sy të largët s'dihej se ku. Ai shtrëngoi stilografin në dorë ,sikur aty të ishte enigma e asaj shprehjeje të tmerrshme.

-Po ti, more, ç'më rri si buf, dil gjeje atë të mallkuar dhe pyete se çfarë ishte ajo fjalë?

Lehtazi sekretari u prapësua rrëshqitas në ecje. Veshët i shungullonin nga replika të ashpra, po, kur doli në ajër të pastër, e mblodhi veten. Si nëpër tym iu kujtua gjithçka dhe si mund të shkonte i ziu, pa gjetur, atë, fshatarin kapriçioz, i cili kishte thënë një fjalë kaq të tmerrshme, të padëgjuar ndonjëherë? Duhej të nxitonte, ta gjente, ta luste, ta qiraste, ta zbuste, në mënyrë që t'i nxirrte sekretin, atë sekret që po e torturonte kryetarin në zyrë.

I kërkoi lokalet me radhë ,por nuk e pa. Vrapoi nëpër rrugë, hiç gjurmë njeriu... Vendosi të kthehej, po ku? “Shkoj në mal më ha ujku, shkoj në shtëpi më rreh gruaja”-iu kujtua një thënie e popullit. Koha kalonte e ngecte në vend ,sikur për atë të mbaronte gjithçka. Ishte i lodhur nga bredhjet, kur pa në një stol lulishteje, atë, fshatarin,i cili kishte hapur mbi stol një gazetë, bukën dhe po mblaçitej në qetësinë e vet. Përtypej ngadalë dhe, herë pa here, kafshonte një copë qepë.

-Të bëftë mirë!,- uroi Avniu.

Fshatari nuk i ktheu përgjigje. Mblodhi thërrimet e fundit, i futi në gojë, pastaj palosi gazetën dhe e futi në xhep;ngriti kokën dhe e pa mirë në fytyrë ,sikur ta shihte për herë të parë.

-Erdhe?,-i tha,- ç' do?!

-Të kërkon kryetari.

-Ik, more me gjithë kryetar. Do të shkruaj lart!.

-Mirë, shkruaj, po kryetari ka një fjalë me ty.

-I thuaj nuk vij, kryetari ka vrarë Rexhën.

-Fja pimë një kafë,kryetari nuk është burrë i keq.

Fshatari u ngrit dhe i zgjati dorën për të ikur, po Avniu menjëherë i futi krahun dhe, me përgjërëm, iu lut:

-S'shkoj dot te kryetari, bëje për mua. Të lutem!

“Kafen e pimë, -pranoi fshatari, por iu kthye atij afër në fytyrë:

- Tek kryetari nuk vij!

Ata u futën në restorant -turizmi dhe Avniu iu përkul, gati duke murmuritur: Çfarë do të pish?

-Pelin!

-Dy dopio raki nga ajo e mira!-poroiti Avniu.

Pas pak kamarieri solli dy dopiot dhe dy pjatat me mëlçi- kapulë.

-I keni nga Faja, -tha ai dhe u largua plot respekt.

Aromë e mëlçive të skuqura iu fut fshatarit në vrimat e hundës. “Eh, si jetojnë këta!”, tha me vete.

-E po gëzuar shoku..., më fal i ta thonë emrin?

-Asllan quhem.

Avniu çakërroi gotën ,po minatori nuk e ngriti. Sekretari përkuli kokën mbi pjatë dhe kollofti një copë mëlçi. Asllani e ngriti gotën papandehur dhe kjo ishte një sihariq për tjetrin.

-Ne po hamë mëlçitë e kalit të Rexhës, që ka vrarë kryetari, -tha ai.

-Jo,-tha Avniu,- nuk janë mëlçi kali, po mëlçi viçi të freskëta.

-Ku merr vesh ti!, -iu hakërrye fshatari.

Ndërkohë sekretari e kishte mbaruar pjatën.

-Nuk e kuptoj pse nxitoni kaq shumë,- tha fshatari,- sado të nxitosh ti, nuk e gjen dot pse kryetari jot ka vrarë Rexhën

-Atë do ma thuash ti, përndryshe mbaroi karriera ime.

Fshatarit i erdhi keq kur pa fytyrën e Avniut që mbyllte në trishtim .Ai mendoi t'ia rrëfente enigmën atij.Fundi,çfarë do të humbte?

-Dëgjo këtu more !..., -i tha bashkëbiseduesit: Është një këngë e njohur kosovare, që rrëfen për një Rexhë të shkretë, i cili ,ditën e dasmës, vajti të merrte kalin e nuses. Kali qëlloi me shkelm Rexhën , i cili priste të bëhej dhëndër.

-Pra kryetari nuk e paska vrarë Rexhën?

-Natyrisht që s'e ka vrarë, po ti,nuk e kupton akoma,që ai e ka vrarë një Rexhë?

-E vrau s'e vrau! E lagu s'e lagu! S'të kuptoj!... Eja me mua dhe thuaja vetë kryetarit!

-Jo. Në qoftë se shkon ti dhe i merr premtimin se do më japë letrën për të shkuar në punë,atëherë...

-Shkoj,- tha sekretari dhe u ngrit e doli përjashta. U vonua pesë minuta diku, pa qenë te kryetari dhe u kthye.

-Më premtoi kryetari, -tha, -eja!

-Ti nuk ke qenë, se je frikacak, megjithatë shkojmë!.

Pas dy tre minutash , sekretari i tha fshatarit të priste në paradhomë.

Kryetari rrinte si i ngurosur dhe shihte rrezen e diellit që po perëndonte.

-Çfarë ishte ajo mesele, mo Avni!?, - pyeti ai.

Sekretari uli sytë , si një nxënës i zënë në faj.

-Si të them, shoku kryetar...

-Avni, ne jemi shokë, ajo që ngjau, ngjau, vetëm mos e marrë vesh kush!

Sekretari i tregoi historinë e Rexhës, i cili ,ditën e dasmës, u vra nga kali.

-Ai maskara më paska dhe unë s`e mora vesh?! Fute brenda shpejt!

Fshatari u ul në kolltuk, pa i thënë kush. Në fytyrën e tij ndihej lodhje e qetësi. Kishte arritur të mposhte këtë njeri të gurtë dhe s' kishte rëndësi në do ta merrte letrën a jo .

-Avni!- thirri kryetari,- plotësoi letrën këtij malukati të shkojë në punë!

Balli i digjte dhe i shkonin djersë...



Nëse liria është një konstrukt biologjik apo shoqëror, filozofia, si maja e arsyes njerëzore, ka provuar t’i japë përgjigje, duke u sjellë me të si me një lavjerrës që herë anon nga njëra anë, e herë nga tjetra. Pra, liria lind para vetëdijes apo vetëdija lind për hir të lirisë? Zoti e krijoi njeriun të lirë, por lirinë ia kufizoi kur i tha çfarë nuk mund të bënte. Dhe njeriu u prir drejt saj, sepse tundimi për ta shijuar të palejueshmen e ngacmoi e vazhdon ta ngacmojë akoma edhe sot. Kështu, bota eci përpara. Kështu, bota ecën përpara.

Por kjo është vetëm njëra fytyrë e lirisë, ajo e dukshmja, ajo përballë së cilës ndriçon dielli. Tjetra, të cilën për ta parë duhet të vendosësh syzet e shpresës e të solidaritetit, tregohet aq mirë në romanin “Gërsheti” të autores Laetitia Colombani, botuar në shqip nga “Toena” nën përkthimin e Blerta Hyskës.

Janë tri gra, në tre realitete të ndryshme, në tre kontinente të largët njëri prej tjetrit, me tre formime që nuk ngajnë kurrkund. E çfarë i bashkon? Forca! Përballë kujt? Cënimit të asaj që i identifikon. Pra, si rrallëherë, në të veçantën e secilës prej tyre, gjendet e përbashkëta. Janë rrugë të ndryshme me destin të njëjtë.

Jetët e Smitës, Xhulias dhe Sarës i përgjigjen shumë mirë pyetjes që me jetën e saj ngre Penelopa: A ishte ajo e lumtur kur pristte Odisenë? Nëse jo, përse e bënte për sa kohë kish’ lirinë e një tjetër zgjedhjeje? Sepse ajo e dinte që lumturia nuk mund të ishte një çast, por një udhëtim. Shtrohet sërish një tjetër pyetje, lumturia është udhëtimi apo pikëmbërritja? Dhe, edhe kësaj pyetjeje, jetët e këtyre tri grave i japin përgjigje.

I.

Fëmijët e Zotit i quante Gandhi njerëzit si Smita, ata që i përkisnin atij kasti pa të drejta. Prandaj, ajo në të njëjtën kohë e përjeton si gëzim e befasi, lumturi e çudi ditën e parë të shkollës së të bijës. Ajo për vete, asnjëherë, asnjë ditë s’kish qenë në shkollë. E bija s’duhet të kishte këtë fat dhe Smita është gati të bëjë çdo gjë që ajo mos ta ketë këtë fat. Çdo gjë! Sepse, çfarë asaj i mungoi, gjithmonë sheh një mënyrë ta realizojë te vajza e saj. Cili prind s’do të donte ta kishte fëmijën të atillë që, identifikimi me të t’i ngjante më i këndshëm se çdo lloj identifikimi tjetër? Pra, Smita sheh realizimin e saj, si të thuash, fundin e lumtur të një jete krejt të palumtur. Por, në një kontekst shtypës, shterrues e dërrmues, mundet që një fund i tillë të realizohet? Jo! Dhe kjo është pika më e lartë e asaj piramide kokëposhtë të fatit, fatkeqësia e saj më e madhe.

Edhe përballë saj, Smita pranon të luftojë. Ka kaluar një jetë pranuese, në pasivitet e tani është në prag të diçkaje tjetër të panjohur për të: në prag të zgjedhjes! Ajo e bën zgjedhjen e saj: për lirinë e së bijës, që është edhe e saja, sidomos e saja, është gati të luftojë sa e si të mundet. Sepse, sikurse pak kujt ia merr mendja, lumturia e saj gjendet edhe te lufta, pasi jeta, porsi një puzzle me atë copën në qendër që mungon, i ka kaluar e gjymtë. A i arratisesh dot fatit? Sigurisht që po!

II.

Xhulia, si një siçiliane tipike, vazhdon traditën e familjes. Por gjithçka përmbysët, ngadalë në fillim, e mandej thuajse brenda një çasti. Babai i saj, tejet krenar për punishten e famshme të parukeve, pëson një aksident të rëndë. Ama, për Xhulian, tragjedia bëhet pak më e lehtë, pasi ato ditë njeh dashurinë e saj. E kjo, që duhet të ishte pika e ngritjes, përputhet me pikën më dramatike të rënies: biznesi po i falimentonte. E dëshpëruar, sikurse gjithë të dëshpëruarit, i drejtohet diçkaje më të lartë, Zotit, jo pse kishte besim, por nuk gjente tjetër rrugëdalje. Në dashurinë e saj

“Gërsheti” i Laetitia Colombani
“Gërsheti”, një roman që i përgjigjet pyetjeve themelore të lirisë

Nga Andreas Dushi

të re e cila pat’ zënë fill pak ditë më parë, u gjet shpëtimi i saj dhe i të gjithëve. Sikurse rrëfimtaria thotë, Zoti ia dëgjoi lutjet!

III.

Sara, grua kanadeze për të cilën shoqëria s’do ta kursente epitetin “e realizuar” përballet me një sëmundje të papritur, të rëndë e tejet sfilitëse. Çfarë do të bëjë ajo me këtë fat që i ra për pjesë? Ta mbulojë, njëlloj si kokën tullace me kapuç e kështu të pretendojë se sëmundja nuk ekziston? E bën për disa kohë, por e sheh se nuk është e plotë. Atëherë? Vendos të ndjek mësimet e Viktor Franklit, t’i japë kuptim vuajtjes. E pranon, e veç atëherë gjendet përballë saj, e lirë për të pranuar edhe atë që i njëson këto histori: flokët e dhuruara nga një grua indiane, përpunuar nga një tjetër siçiliane, për t’u vënë në kokën e saj, kësaj gruaje kanadeze.

Për nga kompozicioni, kemi një qasje të re e cila nuk anon nga postmodernizmi, çka mund ta bënte tekstin të shihej me dyshim,

por nga ajo që është bashkëkohore, që i përgjigjet modeleve të ditëve tona.

Prologu, i shkruar në vargje, paraqet një tjetër element që të trija këto histori i bashkon në një histori të vetme. Autorja, duke u identifikuar me unin e paraqitur këtu, lëshon një fill i cili, jo vetëm orienton lexuesin për dekriptimin e asaj çka gjendet në faqet në vijim, por flet edhe për procesin e saj krijues:

I dua këto orë vetmitare, kur duart e mia vallëzojnë.

Balet i çuditshëm i gishtave të mi.

Ata shkruajnë një histori gërsheti dhe thurjeje.

Kjo histori është imja.

E megjitatë, nuk më përket mua.

Të trija historitë ndërthuren tek enden në kohë, jo atë natyralen e racionalen, por në atë që i përgjigjet momenteve të njëjta. Mund ta imagjinojmë strukturën e secilës histori si një piramidë me shkallë, njëra nga ato ka hapësirë pak më të madhe mes tyre sesa tjetra, por në fund, kur pjesët e ndryshme mbarojnë, ngjitja jonë ndalet në të njëjtën



lartësi. Është Smita e para që e prezanton gjendjen e saj, mandej shfaqet Xhulia e pas saj, Sara. Ky rend ndiqet deri pranë faqeve të fundit, kur ndodh një e papritur: tanimë densiteti i rrëfimit po ndryshon, Sara mund të presë. Po, por pas pritjes, historia e saj duhet të vijë më e vrullshme, ndaj Xhulia mund të presë. Por Smita jo, ajo nuk pret dot: ka pritur mjaft, tani duhet të veprojë. Asnjë moment i saj nuk kapërcehet, s’ka më as kohë e as kuptim t’i rrëshqasin çastet mes *duarve që po vallëzojnë* të autores.

Poezia nuk i përket vetëm prologut, ajo zë vend edhe në pjesët e treguara të historisë dhe tek epilogu. Është e vërtetë se e gjithë vepra karakterizohet nga një lirisim i cili manifestohet më dendur, në trajtë më të qashtë, te vargjet, në dukje naivë, por në thellësi me peshë të veçantë.


E meqë e përmendëm lirisimin, më duhet të ndalem edhe te diçka tjetër: paraqitja e kanonit femëror të letërsisë në vepër. Kritika feministe e një vepre përqendrohet në “mënyrën se si letërsia përforcon ose minon shtypjen ekonomike, politike, shoqërore dhe psikologjike të gruas” (Lois Tyson “Critical Theory Today” 2006, fq. 83). Nga një e tillë pikëpamje, “Gërsheti” është një vepër që vlen të shihet. Prandaj, në vijim, po ndalemi fare shkurt në një të atillë zberthim të të tre personazheve:

Smita shfaq forcën e madhe përballë deformimeve që synon t’i imponojë një shoqëri e cila e shtyp në dy mënyra, si *dali* dhe si *grua*. Ajo ia del të mos e lejojë këtë, jo për vete, por për të bijën e për rrjedhojë, kemi një vajzë dhe një grua që shpëtohen nga guximi për të kërkuar lirinë, të drejtën që u mohohet pambarimisht. Pra, të katër shtypjet e përmendura nga Tysoni lëshojnë rrënjë, por nuk ngrenë dot kërcell, pasi sapo ai nxjerr kryet, këputet!

Xhulian nuk e shtyp asgjë përveç realitetit me të cilin po përballet aq drejtpërdrejt për të parën herë. Si vajzë, si *seksi i dytë* (po të citojmë Bovuarin), kish’ për t’u rrëzuar, nuk do të mund t’ia dilte dot. Por jo, pasi ajo do të jetë e lirë dhe, duke treguar se Bovuar ka të drejtë kur thotë *një grua e lirë është absolutisht e kundërta e një gruaje të lehtë*, ajo nuk rrëzohet, ama me ndihmë e besim, forcë e përkushtim ia del.

Sarën, nga sukcesi e realizimi, një sëmundje, krejt papritur, e mvesh me dyshime e pasiguri nga më të voglat, deri tek ekzistenciallet. Përballë dyzimit të treguar më lart: dëshpërimit apo luftës, ajo zgjedh luftën! Dhe pikërisht kjo zgjedhje tregon për atë forcë, nën dritën e secilës çdo shtypje e dhunë, pabarazi e pandershmëri ridimensionohet si kalimtare kur lidhet me jetën e çdo gruaje a vajze.

“Gërsheti” ka llojshmëri leximesh. I pari lidhet me atë të shijimit estetik çka rri në themelin e çdo vepre *të mirë*, i dyti me leximin porsi një manifest i lirisë, dhe i treti si manifest i letërsisë feministe. Prandaj, besoj se këtij libri, në secilin lexim i del një tjetër dekriptim. Në fund të fundit, të tillë janë librat që të mbeten në zemër: si lexues, bëhesh pjesë e tij!



Naguib Mahfouz

Çmimi Nobel 1998

DHOMA NR. 12

Tregim

E përktheu nga anglishtja Flurans Ilia

Izoti i bujtinës kujton si një foto që asnjëherë nuk shlyhet kollaj nga kujtesa se si një ditë një grua erdhi dhe rezervoi një dhomë veç për 24-orë. Ora ishte fiks 10:00 paradite.

Pamja kaq trallisëse e pranisë së seksit opozitar që i afrohej krejtësisht e vetme, e bënë bujtinarin t'ia ngulte sytë kureshtar. Njëtrajtësisht, ajo dukej një femër e shkëlqyer e mbresëlënëse, me shtatin e shtalbtë, finesën e tipareve, dhe mprehtësinë e shikimit.

Ajo u ndal te sporteli duke qëndruar drejt nën mantelin e kuq dhe kapelën e bardhë. Nuk kishte asnjë dokument identifikimi, nuk punonte gjëkund, as që ishte e martuar. Për më tepër dukej si e ndarë nga burri apo e ve.

Quhej Bahiga al-Dahabi dhe vinte nga Mansura e Deltës. Bujtinari regjistroi informacionin e nevojshëm dhe e drejtoi drejt punonjësit të sportelit.

Sportelisti në krye të saj duke mbajtur valixhen, më e rënda që kishte mbajtur ndonjëherë gjatë gjithë karrierës së tij, e orientoi gruan drejt dhomës Nr.12 në bujtinën e tyre të vogël. Pastaj u kthye pas një gjysmë ore i habitur në fytyrë. Kur menaxheri e pyeti se çfarë ndodhi, ai u përgjigj hazër-xhevap.

“Ajo është një femër shumë e çuditshme!”

“Shpjegohu, çfarë kupton me këtë?” u sëkëlldis menaxheri.

Sportelisti filloi të rrëfente se si ajo i kishte kërkuar të zbulonte shtratin nga mbulesa, batanijet dhe çarçafët, duke i hedhur në cep të dhomës. Përsa i përket krevatit, i kishte kërkuar ta lëviznin së bashku jashtë dhomës, me justifikimin se kishte fiksion se mos nga hapësira e krijuar poshtë vendit të fjetjes fshihej një njeri. Ai i tha se frika e saj ishte e ekzagjeruar sepse asnjëherë nuk kishin ndodhur incidente të tilla që nga koha kur hoteli ishte bërë bismilah. Por ajo këmbëngulte, kështuqë iu bind vullnetit të saj.

“Duhet të kishe ardhur urgjentisht tek unë o zullap,” tha bujtinari. Sportelisti kërkoi të falur duke shtuar se megjithëse kërkesa e saj ishte e çuditshme, ai nuk kishte anashkaluar asnjë nga detyrat që hoteli kishte si detyrim të përmbush. Më tej e përmbylli historinë me fjalët se si ajo e kishte urdhëruar të hapte të gjitha kanatat e dollapit duke i lënë njashtu. Zëri i saj tregonte se kishte frikë nga dikush që mund të fshihej ose nën krevat ose në dollap. Kështu që i plotësoi të gjitha urdhrat e saj, i buzëqeshi ashtu si ai di të buzëqesh gjithmonë, dhe u largua.

“Pjesa më e çuditshme është se ajo dukej grua azgane dhe trime,” cilësoi bujtinari.

Pas pak e pyeti punonjësin e vet, “A të dha ndonjë bakshish?”

“Një pesçe të plotë.» u mburr tjetri.

“Natyrisht, ajo nuk është një femër e rëndomtë, ndaj nuk besoj se do të kemi ndonjë turbullirë,” plotësoi menaxheri.

“Më shpuri rruga përball derës së saj të mbyllur, kur po shkoja për në lavanteri, dhe dëgjova një zë të lartë të hasdisur brenda në dhomë,” tha sportelisti.

“Ishte e vetme?”

“Gjithmonë, zëri i saj i dalldisur dëgjohej i vetëm.”

“Gjithë dynjaja bëjnë kështu,” tha menaxheri.”Zaten, vetëm pse ti flet me vete nuk do të thotë se je i lajthitur.”

Sportelisti tundi kryet pa thënë kurrgjë. Tjetri e pyeti, “A je në gjendje të rikujtosh gjësend çka thoshte?”

“Jo. përveç shprehjes: Nuk është e rëndësishme!”

Menaxheri i dha të kuptohej për mbylljen e muhabetit. Një grimë më vonë pasi shënoi diçka në regjistër, shtoi në drejtim të tjetrit, “Duhet të jesh vigjilent, kjo është detyra jonë, për çdo rast.”

Gumëzhinë bubullima dhe bujtinari e treti vështrimin te qielli përtej dritares ku gjeti mbulesa të dendura reshë. Moti kishte qenë i ftohtë me reshje të kohë pas kohëshme. Ekzaktësisht në ora 1:00 të drekës grua telefonoi prej dhomës Nr.12.

“A mundet të porosis diçka për të ngrënë?” pyeti ajo.

“Ne nuk kemi ushqim në bujtinë por është një gjelltoze matanë xhadesë, çfarë dëshironi zonjë?”

“Perime të pjekura me mish pule, plus pilaf me tasqebap, gati nja një kile shishqebap të pjekur, një tas me sallatë orientale, mish qengji të mbështjellë me pite të ngrohta, ëmbëlsira dhe portokalle.”

Megjithëse i zoti i bujtinës i porositi të gjitha gjellërat që ajo urdhëroi, gati na nuk luajti nga fiqiri prej sasisë së ushqimeve. Vetëm mishi i pjekur mjaftonte për gjashtë persona.”Kjo qenka fiksion jo vetëm me frikën por edhe me llupësinë,” i tha vetes. “Sidoqoftë, ndoshta do të dalë gjatë pasdites e do t'i hedh një sy dhomës.”

Ushqimi mbërriti. Një orë më vonë i zoti i gjelltores përkarshi erdhi të merrte paratë. Menaxheri nuk i rezistoi tundimit t'u hidhte një sy pjatave. Të gjitha ishin të bëra xixë, përveç

disa kockave të kruara mirë, dhe pak salcë të mbetur. I shkau truri nga e gjithë kjo skenë, asgjë tjetër përveç kësaj gruaje, mënyrës se si ajo vështronte dhe vepronte e shtynë në ngasje. Nuk mund të thoshte se ajo s'ishte e bukur, përkundrazi ajo zotëronte një forcë tërheqëse jo të zakonitë. Kishte diçka e frikshme në raport me atë grua së bashku me gjërat kurioze, madje nënshtruese, që të ngujonin.

Mbi të gjitha e kishte parë vetëm një herë, momentin e parë, atë ditë kur ajo i kishte lënë ndjesinë familjare që vinte së bashku me fytyrën, që mbartte prushin vetijak të kujtimeve të vjetra.

Drejt tij po vinin një burrë dhe një grua.

“A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?” pyeti burri.

Bujtinari pohoi dhe telefonoi që të pyes nëse zonja dëshironte që vizitorët të ngiteshin lart në dhomë. Dukshëm, njerëzit ishin nga sërë e lartë, të kamur nga pikëpamja materiale. Era uturinte fuqishëm përjashta, duke i bërë shandanët të kërcenin në sallën e pritjes. Menjëherë papritur tetë persona të tjerë ja behën, katër gra dhe katër burra, duke përsëritur të njëjtën pyetje: «A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?”

Përsëri bujtinari telefonoi për lejin e vizitorëve të rinj. Grupi, me pamje krenare, që ishin të së njëjtës sërë me çiftin e mëparshëm, u ngjiten drejt dhomës Nr.12. Tash bëheshin dhjetë vizitorë. Ndoshta farefis prej së njëjtës familje, ose thjesht miq, apo gjindje dhe farefis të përzier. E çfarëdoqoftë të ishte arsyeja, nuk kishte asnjë dyshim që Madam Bahiga nuk është një zonjë e rëndomtë. “Si përzgjedhi bujtinën tonë xhanëm?” pyeste veten i shqetësuar. Zallamahia u shpërnda menjëherë nga kthina e barit, ndërsa kamarjerët e hotelit servirnin gota çaji lart e poshtë, kur menaxheri po mendohej të fiksonte disa nga fytyrat e të porsaardhurve. Por, mendoi me vete se gjëja më e mirë do ishte ta fshinte nga truri, gjithçka në raport me Bahiga al-Dahabin. Të nesërmen ajo do të ishte veç njëra nga ato qindra fytyra të humbura në kujtesën e bërë lëmsh të hotelit të vogël.

Përball tij u fanit një grua rreth të pesëdhjetave që zotëronte një ekuilibër dhe sjellje të tejskajshme.

“A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?” Kur ai u përgjigj po, ajo i tha, “Ju lutem, a mundet ta njoftoni se doktoresha është këtu.”

Kontaktoi damën në telefon. Një grimë më tej i shtytur nga një arsye urgjente e pyeti të porsaardhurën, “Cili është tamam profesioni juaj doktoreshë?”

“Gjinekologe,” u përgjigj ajo.

Vërejtj se tjetra nuk ishte prezantuar me emrin e saj por me titullin e profesionit. A po e viziton damën kinse nga aftësia profesionale? Apo mos vallë Bahiga al-Dahabi vuan nga ndonjë sëmundje femërore? Ose ndoshta është thjeshtë me barrë? Nuk kishte kohë t'i jepte përgjigje të gjitha këtyre pikëpyetjeve që e kishin mbështjellë tërësisht kur një burrë shkurtabiq dhe i shëndoshë, nursëz, u shfaq para tij. Duke u prezantuar si Jusuf Qabil, biznesmen ndërtimi, ai sikurse edhe të tjerët pozoi pyetjen tashmë të ripërsëritur, “A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?” Pasi shushuriti në telefon dhe mori lejen e nevojshme që “bossi” i ndërtimit të ngjitej lart në dhomën e saj, shpërvoli një buzëqeshje të përhumbur sarkastike.

Njëri nga sportelistët u rikthye duke u dridhur nga jashtë, copë-copë nga i ftohti. “Errësira, tha, është mbledhur nga të katër anët e qiellit, dhe së shpejti dita do të bëhet natë.” Vështroi jashtë dritares.

Po mendonte rishtas për gruan e dhomës Nr.12. Misterioze. Femër fatale. Filloi të ndiej se si një rrymë paqëndrueshmërie dhe e pavolitshme ishte shpërndarë nëpër hotel qyshkur ajo kishte mbërritur aty. Rrymë që i lejonte ndjesisë së tij të brendëshme, nxitje, të ëndrrave të adoleshencës, madhështinë molisëse të të qenit i pasur, sundimtar mbi botën.

U trondit nga ëndërrimi obskur kur një zë i papritur pyeti, “A qëndron këtu zj. Bahiga al-Dahabi?”

Një njeri trupmadh i mbështjellë me xhybe kashmiri, çallmë të lidhur mbi krye, dorën në dorezën ngjyrë gri të ombrellës. “I thoni se Blind Sajed, Pastruesi i Kufomave, ka mbërritur.”

Gjoksi i bujtinarit brofi nga vendi. Kërcëlliti dhëmbët nga tmerri dhe duke nëpërdhëmbur mallkoi burrin dhe gruan bashkë. Por gjithsesi kreu detyrën duke telefonuar. Për të parën herë mori një përgjigje krejt të kundërt nga të gjitha të mëparshmet. “Ju lutem, mund të prisni në sallën e pritjes, zotëri,” e urdhëroi sipërmarrësin.

Allah-Allah, për çfarë ka ardhur ky edepsëz këtu? Pse nuk pret përjashta por na sjell tersllëk? Punonte për pesëdhjetë vjet në këtë hotel dhe asnjëherë nuk kishte parë diçka të përngjashme me atë që po ndodhte këtë ditë. Ndiante frikë se shiu do fillonte të zbriste poshtë me rrëke e shkullmë dhe do t'i mbante të ngujuar në hotel kushedi se për sa kohë të ardhurit. Për më tepër që tashmë midis të tjerëve ishte edhe sipërmarrësi i Vdekjes!

Myshterinj të rinj mbërritën. Ata erdhën të ndarë, sërë-sërë: pronari i dyqanit të mobilieve të shtrenjta, pronari i supermarketit, pronari i lëngjeve të frutave, pronari i parfumeve dhe asortimenteve kozmetike, zyrtari i lartë i Thesarit të Shtetit, shefi i redaksisë së gazetës më në zë të vendit, biznesmeni i shitjes së peshkut me shumicë, i autorizuari i firmës për mobilimin e shtëpive, këshilltari i një milioneri arab.

Mendoi se mos dama do e zhvendoste bashkësinë e krijuar në sallën e pritjes, por çuditërisht ajo i lejoi të gjithë mysafirët të ngjiteshin lart në dhomë, njëri pas tjetrit. Kamarjerët sollën gjithmonë e më tepër gota çaji dhe karrige, ndërsa ai, bujtinari i bujtinës së vogël, mëdyshej se ku do të gjenin vend për t'u ulur gjithë ky kallaballëk. A e njohin njëri-tjetrin qysh më parë? Dhe çfarë i ka sjellë të gjithë së bashku?

Thërriti sportelistin pranë dhe e pyeti se çfarë dinte më tepër për sa po ngjet.


“Nuk e di, nuk di asgjë vallahi,” u përgjigj sportelisti. “Duart zgjaten jashtë derës duke marrë karriget dhe çajin, dhe firojnë përsëri brenda portës pa na dhënë mundësinë të shohim së ç'bëhet brenda dhomës.”

Menaxheri mblodhi supet. Për aq kohë sa askush nuk ankohej, i tha vetvetes, nuk kishte pse ndihesh keq.

Blind Sajed, Pastruesi i Kufomave u avit drejt tij. “Dua t'i kujtoj zonjës se jam duke pritur,” tha.

“Ajo premtoi se do ju thërrasë në kohën e duhur, zotëri,” i tha menaxheri me një ndjenjë të dukshme mospërfillje. Por tjetri as që lëvizi nga vendi ndaj u detyrua të telefonoj përsëri duke nderur receptorin drejt sipërmarrësit. “Madam, ka kaluar orari i faljes në aksham dhe ju e dini se në dimër dita është e shkurtër,” foli qortueshëm Sajed. U përkul mbi telefon, duke dëgjuar një grimë, dhe më tej e mbylli aparatin e komunikimit duke u kthyer përsëri në sallën e pritjes.

Nga thellësia e shpirtit bujtinari e nëmi burrin në heshtje. S'kishte dyshim se zonja ishte shkaktarja kryesore që kishte prurë një lugat të tillë në hotel. I mendonte të gjitha këto ndërsa shikimin e kishte ngulur në portën e hyrjes plotë mllef. Disa zonja zbritën poshtë nga dhoma Nr.12. Frika që e kishte zaptuar u duk se u pakësua kur ato u drejtuan drejt portës së jashtme. “Ja, më në fund disa po ikin dhe të tjerë do largohen më vonë, gjersa nata të bjerë plotësisht besoj do të jenë bërë firë të gjithë,” e justifikoi vetveten. Shqetësohej sepse vet pozicioni dhe përgjegjësia e tij mund ta shtynin në konfrontim me ata, dhe gjindja i përkiste një klase të



fuqishme. Shqetësimi dyfishohej me erën që fërshëllente dhunshëm jashtë porte dhe ndjenjën e pikëllushme që kishte mbuluar rrugët.

Përtej këtij pikëllimi të pandalshëm ku zemra e tij hovte prej gjoksi, ai vërejti mu në portën e hotelit një grup burrash e grash të veshur me mushamatë e shiut. “Për tek madam Bahiga al-Dahabi?” pyeti duke i çuditur të porsaardhurit. Njëri syresh duke qeshur tha, “Po. I thoni zonjës ju lutem, se delegatët e Organizatës Trashëgimtarët e Rilindjes kanë mbërritur.” Kështu që telefonoi dhe pasi ajo e dha pëlqimin e saj, shtoi ngulmueshëm, “Janë dhjetë persona zonjë e nderuar, dhe salla e pritjes këtu poshtë është në dispozicionin tuaj në rast nevojë.”

“Nuk është e nevojshme, ka vend të mjaftueshëm në dhomë,” kundërshtoi ajo.

Ndërsa delegatët u ngjitën, bujtinari tundi kokën gjithë konfuzion. Herët a vonë do të kemi sherr, mendoi. Si të nixtej prej zallamahisë së kallaballëkut jo të zakonit në dhomën Nr.12, furia e furtunës ishte gati në shpërthim përjashta. I rikthyer në sallën e pritjes, rroku me një vështrim Blind Sajedin - Pastruesin e Kufomave - duke u zvarritur drejt tij. Goditi me njënjë e gishtit tundueshëm sportelin dhe drejtoi aparatin e telefonit nga tjetri përpara se ky të fliste. Menaxheri dëgjoi ankimet e tij drejt gruas fatale. Më tej sipërmarrësi shtoi si për justifikim drejt tij, “Të presësh pa bërë asgjë është me të vërtetë e mërzitshme.” Menaxheri u tërbua dhe u bë gati ta shante kur dama telefonoi në moment, duke kërkuar që ta lidhnin në telefon me gjelltoeren përkarshi. Biseda e saj zgjati disa minuta.

A do të qëndrojnë në dhomë gjer për darkë, peshoi situatën, edhe në qoftë se po, ku do të darkojnë? Sa do të donte t’i hidhte një sy dhomës. Duhet të ishte një skenë jashtë çdo imagjinate, një dalldi e vërtet.

Rrëketë vazhdonin përjashta pa u ndalur. Një grup profesorësh të Universitetit dhe Klerikë të lartë, hynë duke diskutuar ethshëm, aq sa thjesht nuk bëzajti, por i lejoi të shkojnë direkt lartë. Situata ishte shndërruar në makth kur një i panjohur u fut pa pyetur, pa u ndaluar tek sporteli. Bujtinari thirri me zë të lartë për ta ndalur shkelësin e rregullores por ky edepsëzi u ngjit me vrap pa kthyer xhevap. Atëherë drejtuesi i hotelit urdhëroi muhaxhirët t’i qepeshin pas të paudhit, por këta nuk e arritën sepse me të mbërritur përball dhomës Nr.12, ky u zhdruk pas porte si t’a kishte përpirë diçka e vrullshme.

U ndie totalisht i vetëm, kishte humbur kontrollin rrënjësor mbi bujtinën e vet. Po bëhej gati të mblidhte kokë për kokë sportelistë dhe punonjës, kur një burrë u shfaq, ndihma e paevitueshme e të cilit ishte e pazëvendësueshme. Shkëmbyen përshëndetje kur i zoti i bujtinës i tha, “Ju keni ardhur tamam në kohën e duhur, i nderuar z.Inspektor.”

“Tregomë regjistrin,” tha oficeri qetësisht.

“Gjëra të çuditshme po ndodhin këtu,” llogotiti tjetri.

Ndërsa inspektori qëmtoi emrat në regjistër, dhe çoç shkroi në bllok, bujtinari ndërhyri përsëri, “Me sa po shoh ju keni ardhur dhe jeni i interesuar për dhomën Nr.12, zotëri? Allah-Allah, rebelim i madh, hata e vërtetë po ndodh atje.”

“Gjithçka që gjendet në natyrë duhet të jetë e natyrshme,” tha inspektori i ç’përqendruar, ndërsa duke folur u largua nga sporteli, “Po qe se ndokush më kërkon në telefon, do të jem në dhomën Nr.12.”

Sikur i ra damllaja. Një grimë kishte besuar se syri dhe veshi i Qeverisë e dinte se ç’po ndodhte në hotel. Rikujtoi se duhej të mblidhte muhaxhirët kur përsëri shikimi i kapi Blind Sajedin që avitej drejt tij. E humbi durimin dhe nervat, duke i bërë titur, “Zonja të tha se duhet të presësh gjer sa ajo vetë të të ftojë lartë!” Tjetri u ngërdhesh qortueshëm nën servilizmin e zakonshëm ndërsa ndërhyri, “Dakord, por po pres që prej një kohe të gjatë...”

“Ju lutem prisni dhe mos u ndieni. Mos harroni se jeni në hotel dhe jo në bahçen tuaj zotëri!” turfulloi. Tjetri u tërhoq në dukje i qetë, ndërsa bujtinari thirri sportelistin.

“Si po venë gjërat në dhomën Nr.12?”

“Nuk e di, por zallamahi e madhe është duke u bërë.”

“Si nuk shtrydhen brenda? Duhet të jenë në prehrin e njëri-tjetrit tashmë!” tha i matufepsur.

“Aq sa di ti - di edhe unë” u përgjigj sportelisti.

“Sidoqoftë oficeri i sigurimit është atje brenda.” Mendoi bujtinari.

Bujtinari shkoi përsëri pranë dritares dhe vërejti se si nata peshonte rëndë-rëndë në

boshllëk. Drita po fikej plotësisht jashtë mureve të hotelit, me derdhje rraskapitëse ndriçimi drejt e prej atmosferës së lagësht të bymyer nga era zhurmonjëse që ulërinte përjashta. Një batalion i vërtetë kamerierësh erdhën nga restoranti përkarshi, duke mbajtur takëme të mbushura me të gjitha llojet e gjellëve, dhe mpirja e mendjes së tij u rrit edhe më tepër. Dhoma ka vetëm një të vetme tavolinë buke, ku do t’i shtrojnë gjithë këto pjata? Si do t’i hanë gjithë këto ushqime xhanëm? Njëri nga sportelistët i tha se dyert e dhomës tash nuk mund të hapeshin dot, dhe ushqimi po hynte veçse nga dritarja e vogël e ajrimit. Zallamahia e dhomës po pikëllonte krejt hotelin, e gjithë shfaqja ishte thjesht e pabesueshme.

Pas gjysmë ore, njëri nga sportelistët konfirmoi se njerëzit që ndodheshin në dhomën Nr.12 ishin bërë hazër në të pirë.

“Por nuk vura re asnjë shishe të ngjitej lartë!” u shkartis menaxheri.

“Ndoshta i kanë fshehur nëpër xhepa,” hamendi sportelisti.

“Janë duke kënduar, bërtasin dhe duartrokin, burra dhe gra, si haramsëzër të bërë xurxull.”

“Po inspektori?”

“E dëgjova edhe zërin e tij teksa këndonte: O aman, ooo saman aman aman, kjo dynjah është veç duhman, duhman edhe raki!!!” tha sportelisti.

Bubullima u ndien përjashta ndërsa bujtinari i tha vetvetes, “Mundet të jem duke ëndërruar, ose thjesht po çmendem.”

Në zgripë të mendimeve një grup i porsaardhur u afrua. Nga fytyrat dhe veshjet dukej qashtë se i përkisnin një sërë të ulët shoqërore, dukeshin fakir-fukarenj. Pyetën nën formulën e njohur të pashmangshme, “A qëndron këtu zj. Bahiga al- Dahabi?” Dëshpërimisht buzëqeshi dhe kontaktoi me telefon gruan fatale. Ajo i u lut t’i mbante të porsaardhurit në sallën e pritjes dhe t’u shërbente për të pirë gjithashtu. Pamja e sallanit tashmë po e pikëllonte edhe më tepër.

“Ky hotel nuk është më hotel. Unë nuk jam më pronari i tij. Kjo ditë nuk është më ditë.

Lunatizmi po zgërdhiet me ne në trajtat e rakisë, duhmës të cigareve dhe mishit të pjekur!»

Shiu filloi të zbresë litar-litarë i shoqëruar me shkrepitja rrufesh që zbrisnin nga qielli. Kalldrëmi i hyrjes së hotelit po ndriçohej zbehtë veç nëpërmjet llambave të ndezura brenda tij. Sportelisti u qa, “Veç një Zot mund të na shpëtojë!”, ndërsa të gjithë të porsaardhurit u strehuan në hajat. Kutitë elektrike majë shtyllave në xhade filluan të shpërthejnë nën trysinë e shiut që njëkohësisht godiste xhamat e dritareve papushim. Bujtinari i nguuar pas shulit të portës kryesore i kishte ngulur sytë drejt e mbi qiellin e errët. Gradualisht poshtë mbi rrugën e përbaltur ishte krijuar një rrymë uji e cila merrte me vete rrëmbimthi guralecë dhe llucë. Rrebeshi vinte nga lartë duke shkaktuar valë të tërbuara mbi tokën fatkeqe.

“Nuk kemi parë hata të tillë të paktën përgjatë një breznie të tërë,” dëshmoi ai.

Duke kërkuar pas në të shkuarën e tij, mu përpara syve iu shfaq, një përmbetje e tillë nga koha e fëmijërisë. Kujtonte se si atëherë përmbytja kishte bllokuar transportin, fundosur rrugët, shkapërderdhur banesat, dhe shkalafitur tavanet. Menjëherë u pozicionua në sportel duke qartësuar të gjitha ndodhitë e mbajtura shënim, pa harruar të jap urdhra dhe orientime për t’i bërë shqisat katër, e sidomos për të mbajtur nën kontroll absolut të gjitha dhomat dhe çatinë.

Në survejim e sipër të krejt situatës pyeti të parin punonjës që iu shfaq atypari, “Më thuaj shpejt të rejat nga dhoma Nr.12 ?”

“E qeshura dhe kënga nuk ka asnjë shenjë mbarimi zotni,” tha tjetri duke mbledhur buzët, “Janë hazdisur fare, akoma më keq!”

Blind Sajed iu largua sallës së pritjes dhe u drejtua drejt derës së jashtme. “Zbythu pas tek vendi yt!” ju lëshua me zë të lartë bujtinari. Sipërmarrësi tentoi të kapte dorezën e derës kur tjetri i turfulloi përsëri akoma më me tërbim, “Nuk do të paralajmëroj më, more vesh. Kthehu pas!”

Rrufetë shpërthenin si bomba dhe shiu përplasej si breshëri mbi parvaze dhe trotuare. I zoti i bujtinës përlloragari se bujtina e tij e vjetër ishte ndërtuar pa betonime të përforcuara dhe nata paralajmëronte për dëme të mëtejshme.

Sportelisti i tha, “Kemi ankesa nga dymbëdhjeta për rrjedhje nga tavani, dhe uji është duke e përmbytur dhomën.”

“D.m.th. ndaluan nga hajengu?” pyeti i irrituar, “Atëherë yrysh, hajde le ta lëshojnë dhomën!”

“Nuk munden!” kundërshtoi sportelisti.

Por bujtinari vendosmërisht vazhdoi “Djema, dhomat po përmbytën, ndaj mobilizoni krejt personelin të bymllim vrimat nga ku rrjedh uji, dhe të përforcojmë pritat me thasë prej rëre!»

“Po dhoma Nr.12 ?” u dëgjuan zërat e punonjësve “Ata janë ngjeshur brenda saj. Nuk mundet të bëjnë hap përjashta sepse mulla e tyre është fryrë së tepërmi aq sa nuk mund të hapin derën!”

Tufani ndëshkoi natën përjashta, brenda mpirja totale kishte ozurpuar hotelin, ndërsa punonjësit gulçonin me thasë rëre ndër duar duke u përpjekur të ndalnin pushtimin e shiut që po depërtonte brenda mureve.

Në këtë çast mbi të gjitha ndodhi gjëja më e veçantë: fakir-fukarenjtë që ishin duke pritur në sallën e pritjes vrapuan të ndihmojnë në përpjekjen e mundimshme të sapo krijuar. Bujtinari shikonte i mallëngjyer dhe krenar gjithë këtë skenë në të cilën vetëm Blind Sajed, Pastruesi i Kufomave, nuk mori pjesë.

Pak më vonë sportelisti raportoi përpara tij: “Të varfrit po bëjnë gjithçka është e mundur për ta parandaluar fatkeqsinë,” foli ai gjith krenari, “Por përsa i përket dhomës Nr.12, ata vazhdojnë të jenë në kushte shumë të vështira të cilat po keqësohen gjithmonë e më tepër, imzot.” Përsa tha më sipër tjetri, bëri që krejt qënien e bujtinarit ta përshkojë ndjenja e grevistik, njeriut që në shenjë proteste abandonon gjithçka qëllimisht. Nga një njeri i përmbajtur gjer në ato momente ai u kthye në një të revoltuar. Neveria që kishte kapluar trupin, mishin, gjakun, nervat dhe shpirtin e tij, më së fundmi dorëzoi edhe rrekat e fundit të urtësisë nënshtruese.

“Dëgjo,” bërtiti me zë të lartë, “Dëgjomë më vëmendje se ç’po të them...” Sportelisti zgurdulloi sytë i shokuar, ndërsa i zoti i bujtinës me zërin e ngritur, dha i sigurt verdiktin e tij final:

“Harroooje. Harroje dhomën Nr.12 dhe të gjithë dynjanë brenda saj!”

«Imzot, atje burrat po thërrasin dhe gratë po qajnë!»

Duke ulërritur si një bishë e blagosur bujtinari urdhëroi:

“Përqendrohuni mbi çatinë e sallës së pritjes, merrni vesh apo jo, përsa i përket dhomës Nr.12, harrojeni, lëreni ashtu si është, me gjithçka dhe gjithsecilin që mbart brenda!”

Sportelisti thjesht nguroi për momentin, por zëri shkumbëzues i tjetrit në vijueshmëri e shkundi nga vendi, “Vëri vath në vesh të gjitha sa po të them, nguli në tru pa t’u dridhur gjunjë! Kupton?!”

Nga dritarja e sallanit bujtinarit të asaj bujtine të vogël i’u shpërfaq stuhia që po thyej në zemër të territ, duke larë kalimthi çdo çast në ikje.

Ndjeu se pesha e barrës po i lehtësohej thellë në shpirt, ndërsa vetbesimi po i rikthehej së bashku me kthiellësinë e mendjes.

Një djalë i ri studioi juridik, e më pas, me të mbaruar shkollën nisi të punonte në gjykatë, por u sëmur nga apendiciti, dhe për të kaluar kohën në shtrat e ëma i bleu një palë bojëra që të pikturonte, dhe djaloshi vendosi të bëhej artist, e me t'u rikuperuar konkurroi në akademinë e arteve, por nuk u pranua, e ai konkurroi përsëri e sërish nuk u pranua, dhe ai priste jashtë portës së akademisë që t'i tregonte punimet e tij profesorëve që hynin në akademi, e kjo vazhdoi gjatë derisa dikush e vuri re talentin e tij, dhe ai u pranua më në fund në akademi dhe ai djalosh u bë artist i madh, por më vonë u sëmurë nga kanceri, dhe pavarësisht se operacioni u krye me sukses ai mbeti i paralizuar duke e detyruar të pikturonte në mure e tavane me shkopinj të gjatë, e më pas i braktisi penelat e vendosi të pikturonte me gërshërë, duke prerë letrat me ngjyra e duke krijuar kompozime me to, e kështu nga artist i madh u bë një ndër artistët më të shquar i shekullit të 20-të. Kjo është historia e Henri Matisse (1869-1954), artisti që ndryshoi një shekull, piktori që nisi një epokë të re në art e në botëkuptimin e njeriut modern.

“Artisti e sheh të vërtetën e vjetër nën dritën e re,” u shpreh ai, “pasi nuk ka të vërteta të reja.” Ndaj të gjithë artin e shkua ai e pa nën një dritë të re. Kur Matisse po studionte art me piktorin Gustave Moreau, ky i fundit u shpreh, në mënyrë profetike, “Ti do e thjeshtosh pikturën.” Dhe ashtu ndodhi. “Unë ndiej përmes ngjyrës,” u shpreh më vonë Matisse. Dhe ngjyrat e pastra, të forta e të papërziera karakterizojnë të gjitha veprat e tij. Përmes tyre ai ëndërronte dhe kërkonte të pikturonte parajsën. Edhe studio e tij ishte si parajsa e tij e dëshiruar. Në të ai kishte një kafaz të madh me zogj të llojeve të rralla, përfshirë edhe pëllumba me raca të shartuara. Gjithashtu ai kishte objekte të koleksionuara, zbukurime që i pikturonte vazhdimisht në tablotë e tij, vazo prej bakri, maska afrikane, enë kineze, guaska tropikale, limonë, portokalle, kunguj të tharë, bimë zbukuruese, e lule me gjethe të mëdha e të harlisura.

Vepra *Kërcimi* (1910) është një ndër tablotë më të njohura dhe revolucionare të shekullit të 20-të. Në vitin 1909 Matisse mori një porosi të rëndësishme. Një industrialist rus, jashtëzakonisht i pasur, me emrin Sergei Shchukin i kërkoi Matisse tre piktura me përmasa të mëdha për të zbukuruar shkallën spirale të rezidencës së tij, Pallatit Trubetskoy, në Moskë. Motivi i kërcimit u bë një ndër më të preferuarit e artistit në disa tablo të tij, dhe padyshim i dhanë Matisse një famë edhe më të madhe.

Në këtë tablo ka vetëm tri ngjyra. Rozë, blu, dhe jeshile. Shikoni sesa minimaliste është kjo vepër. Vetëm tri ngjyra. Thjeshtësi absolute e ndërkohë që përmban një botë të tërë: roza për ngjyrën e trupit të njeriut, bluja për qiellin dhe jeshilja për natyrën dhe pjellorinë e saj. Tre elementët kryesorë të jetës.

Në pikturë ngjyrat ndahen në të ngrohta dhe të ftohta. E kuqja, dhe të gjithë ngjyrat që rrjedhin prej saj janë të ngrohta, në këtë rast roza është ngjyrë e ngrohtë, ndërsa ngjyrat e ftohta nisin me blunë, jeshilen dhe të



KËRCIMI I HENRI MATISSE

Dr. Bledar Kurti

tjerat që rrjedhin prej tyre. Një paraqitje e tillë e dy ngjyrave të ftohta në sfond, e figura të ngrohta në plan të parë nuk ishte parë kurrë në pikturë. Konflikti i përhershëm i dy koncepteve: zjarr dhe akull, e ngrohtë dhe e ftohtë, pasion dhe racionalizëm, etj., janë pikturuar në harmoni të plotë në këtë vepër. Pavarësisht pamjes, asgjë nuk është e thjeshtë në veprat e Matisse. Ndaj tabloja *Kërcimi*, në dukje minimaliste, përmban një univers të tërë.

Pesë figurat në tablo kërcëjnë me gëzim në një rreth. Silueta rrethore e trupit në të majtë përkon saktësisht me anën tjetër të rrethit me siluetën e figurës në të djathtë. Figura e rrethit, aq e studiuar në Greqinë e lashtë, e më vonë nga Vitruvius, Leonardo da Vinci, etj. Rrethi i jetës. Cikli i jetës. E gjitha kjo brenda një tabloje me tri ngjyra. Figurat spërdridhen dhe e kthejnë trupin plot ndjenjë sikur janë të përhumur në

ritmin e kërcimit. Ato duken sikur lëvizin aq shpejt saqë gruaja në qendër të tablosë, ajo në plan të parë, duket sikur e ka humbur ritmin e nuk arrin dot ta kapë dorën e figurës që ka në të majtë. Figurat në tablo nuk kanë hije, që na tregojnë se ky kompozim nuk ka kohë dhe mund të gjendet kudo në vend dhe hapësirë, pra një vepër simbolike universale.

Ky kërcim është frymëzuar edhe nga kujtimet rinore të Matisse mbi kërcimin “farandole” që kryhej vazhdimisht në Montmartre, Paris, dhe kërcimin spanjoll “sardanes” që praktikohet në jug të Francës. Në këtë tablo Matisse e ka paraqitur kërcimin si një rit të shenjtë. Figurat zor se dallohen për nga gjinia, por megjithatë ato janë njerëzore, e duket se lodrojnë, spërdridhen, kërcëjnë e hidhen, nën ritmin e kërcimit.

Ky kompozim i përket tematikës së “epokës së artë” të njerëzimit, kësaj

figurat nuk janë njerëz të vërtetë, por simbole imazhi të imagjinuara. Ka një thjeshtësi në këtë tablo e cila i referohet primitivizmit dhe riteve pagane. Kjo tablo shpalos një ndërthurje të fuqishme të tri ngjyrave që bashkojnë njeriun, qiellin dhe tokën. Në të Matisse ka kapur kuptimin e thellë të vallëzimit, duke shprehur ndjesinë e të pandërgjegjshmes së njeriut në përfshirjen e ritmeve të natyrës dhe kozmosit! Në të ai përshkruan një harmoni çlodhëse të cilën ai e ëndërroi gjatë të gjithë jetës së tij:

Unë ëndërroj për një art plot ekuilibër, të pastër dhe të qetë, të lirë prej shqetësimeve apo tematikave depresive, një art që mund të jetë për çdo njeri që mendon, si për njeriun e biznesit ashtu edhe për njeriun e librave ... një ndikim qetësues e zbutës për mendjen, diçka pors një kolltuk i mirë që siguron çlodhje nga lodhja fizike.

Të pesë figurat kanë linja të forta, dhe deformimi i siluetave të tyre shpreh eksitim, përndeje e shprehi të pasionit dhe fuqisë së ritmit gjithëpërfshirës. Lëvizja e shpejtë dhe e përbashkët mbush trupat me forcë jete të pandërprerë, dhe ngjyra e kuqe e siluetave bëhet simbol i nxehtësisë së brendshme. Instinkti dhe ndërgjegjja janë bashkuar në një tërësi harmonike. Trupat nuk kanë një përshkrim realist por bazik dhe primitiv. Përmes ngjyrës së sheshtë linjat e theksuara trupore shpalosin thelbin dhe kuptimin e qenies njerëzore. Ja si e përshkruan vetë Matisse pikturimin e trupit:

Kur unë pikturoj trupin e një gruaje; së pari i jap hir, bukuri, dhe pastaj duhet t'i jap diçka më shumë. Unë duhet ta përmbledh kuptimin e trupit përmes linjave thelbësore. Bukuria do të jetë më pak e dukshme në shikim të parë, por në fund do të shfaqet përmes imazhit të ri që kam arritur, që ka kuptim më të madh dhe ka një plotësi më të madhe njerëzore. Bukuria do të jetë më pak e dukshme, duke mos qenë karakteristika e vetme, por gjithsesi do të jetë aty, në konceptimin e përgjithshëm të figurës sime.

Kjo tablo, sikurse edhe disa të tjera që u blenë nga Shchukin, u konsiderua tronditëse nga shoqëria bashkëkohore ruse mbi përdorimin e figurave nudo. Porosia e kësaj pikturë erdhi fill pas vdekjes së gruas së rreptë e disi puritane të Shchukin, dhe sinjalizoi një fazë të re në jetën e Shchukin dhe një besim të plotë tek Matisse si piktori më i rëndësishëm i kohës. Pesë figurat nudo nuk janë të bukura, por ato janë një imazh i ri i një jete të vjetër, e njeriut primitiv, i cili e ka origjinën tek thjeshtësia dhe harmonia me qiellin dhe tokën. Figurat janë dinamike dhe të egra. Ka dinamikë lëvizje në to por edhe një egërsi tribale. Dhe kjo nuk është aspak rastësi, pasi Matisse ishte babai i Fovizmit. Dhe Fovizmi rridhte nga fjala frëngjisht “fauves” që do të thotë “bishat e egra.”

Vetë Matisse vinte nga një familje



e mbajtur dhe vetë ishte njeri i qetë, i zgjuar dhe i respektuar, dhe nuk kishte asgjë të çmendur në jetën dhe personalitetin e tij, por pikturat që bënte ishin të egra, dhe e shtynin shikuesin të mendonte se artisti ishte një bishë e egër, një kafshë e tërbuar që promovonte instinktin primitiv dhe kafshëror të njeriut.

Gjatë një ekspozite në *Salon d'Automne* në vitin 1905, ku ekspozoheshin veprat e Mattise e shumë piktorëve të tjerë, kritiku Louis Vauxcelles, duke parë vetëm një skulpturë të stilit të mesjetës ndër piktura që të vrisnin sytë me ngjyrat e forta, i përçmoi artistët, duke thënë *‘Donatello au milieu des fauves!’* (Donatello në mes të bishave të egra). Dhe sikurse Impresionizmi mori emrin prej nga një tallje e një kritiku, dhe Claude Monet u quajt menjëherë babai i asaj lëvizje, kështu ndodhi edhe me Fovizmin, një lëvizje që u drejtua nga Henri Matisse. Fovizmi ishte tejet kalimtar në fillim të shekullit të 20-të, por reputacioni dhe ndikimi i Matisse u forcua edhe më shumë duke e mbartur Fovizmin në veprat e tij pa qenë nevoja të ekzistonte më si një lëvizje artistike. Ai ishte njeriu i thjeshtë dhe i vetëpërmbajtur por ishte artisti që i përdorte ngjyrat me një furi dhe egërsi të jashtëzakonshme.

Ngjyrat e Matisse janë të forta dhe të sheshta, ndaj tablotë e tij duket se janë një-dimensionale, por në fakt ai përdor perspektivën përmes dredhive të linjave dhe planeve. Thjeshtësia që ai i bëri ngjyrave dhe vetë pikturës ndikoi tek të gjithë artistët e tjerë. Primitivizmi në artin e Matisse e frymëzoi Pablo Picasso-n të drejtohej për nga Kubizmi. Matisse i rekomandoi mikut të tij Picasso të njihej me *l'art nègre* (arti afrikan) dhe kjo këshillë rezultoi në vepra të mrekullueshme kubiste nga Pablo Picasso. Por ndryshe nga artisti spanjoll i cili e shihte artin agresiv dhe si mjet lufte, Matisse, e konsideronte primitivizmin dhe thjeshtësinë jo si egërsi, por si parajsë dhe pafajësi. Asnjë ndërlikim njerëzor nuk ka në veprat e tij, por ngjyrat janë forcat e vetme në çdo tablo. Ngjyra që krijojnë parajsën.

Ai e arratoi studion e tij me pamjen e një parajse artificiale, dhe e ndërtoi edhe jetën e tij si Kopshti i Edenit. Ai

udhëtoi në Marok dhe u kthye, jo vetëm me pllaka qeramike shumëngjyrëshe të dekoruara me motive lulësh e figurash gjeometrike, por edhe me një vizion të ri për stilizimin e figurave dhe sfondit të përshkruar sipas sixhadeve e motiveve orientale. Në Marok ai pa burrat që pinin duhan e që vështronin akuariumet me peshq, ndaj edhe në tablotë e tij nisën të shfaqeshin motive me veshje orientale, qilima e sixhade arabe, dhe akuariume me peshq.

Por, ashtu siç kishte ndodhur më parë, kur për shkak të një sëmundje nëna i kishte blerë një palë bojëra, dhe ai vendosi të bëhej artist, dyzetë vite më vonë një sëmundje tjetër e bëri të hynte në fazën më të lavdishme të karrierës së tij. Ai u diagnostikua me kancer, dhe pas operacionit, pavarësisht të suksesshëm, ai mbeti i paralizuar. Ndaj u detyrua të pikturonte i shtrirë. Duke e patur të vështirë të përdorte ngjyrat sipas pëlqimit, ai vendosi të pikturonte porsi një fëmijë, duke krijuar imazhe me letra me ngjyra. Kështu që mjeshtri i madh nisi të përdorte ekskluzivisht vetëm prerjen e letrave si mënyrën kryesore për të bërë art, dhe gërsërët si mjetin primar, duke futur në pikturë një mënyrë tërësisht të re. Matisse do të priste me gërsërë fletë të ngjyrosura në forma dhe madhësi të ndryshme, duke formuar si figura lulësh ashtu edhe imazhe abstrakte, të cilat më pas i rregullonte në kompozime të gjalla, të cilat të godisnin me lojën e tyre plot ngjyra dhe kontraste, me shfrytëzimin e strategjive dekorative dhe minimizimin e mjeteve të përdorura. Fillimisht, këto kompozime ishin me përmasa modeste, por me kalimin e kohës, shkalla e tyre u rrit duke u zgjeruar në vepra murale ose vepra që mbulonin dhoma të tëra.

“Letrat e prera më lejojnë të vizatoj me ngjyrë,” u shpreh ai. “Për mua kjo është çështje thjeshtëzimi. Në vend që të vizatoj konturin dhe pastaj ta mbush me ngjyrë, duke bërë kështu që ngjyra të modifikojë vizatimin, unë vizatoj direkt në ngjyrë.... Ky thjeshtëzim garanton saktësi në bashkimin e dy mënyrave të shprehjes, të cilat shndërrohen në një. Dhe me ato letra me ngjyra, në vitin 1947 ai krijoi katalogun e mrekullueshëm me ilustrime, të titulluar *Jazz*. Me gërsërët në dorë, Matisse ndihej sikur fluturonte, dhe me ngjyra të

sheshta të prera ai krijoi imazhet më të paharrueshme të shekullit të 20-të, si gjethe shumëngjyrëshe ashtu edhe nudo blu, të cilat tronditën shikuesit por edhe kritikët e artit. Artistët dhe kritikët profesionistë u hutuan prej atyre imazheve. Ata po haseshin me një rast të paprecedentë. Ata nuk e lidhnin dot atë teknikë të re me ndonjë formë artistike të mëparshme ndaj nuk dinin si të shpreheshin. Ajo ishte një teknikë tërësisht e re. Nuk ishte provuar kurrë më parë. Sëmundjen paralizuese, Matisse e shndërroi në periudhën më krijuese të jetës së tij.

Në fund të viteve të tij, arti i Matisse do prezantohej si një kishë. Dhe në këtë periudhë, në fakt mesi i luftës së dytë botërore, ndodh historia e mjeshtrit me një murgeshë dhe një kishë, e cila do rezultonte në një nga veprat më madhështore të shekullit. “Nevojitet një infermiere nate - Duhet të jetë e re dhe e bukur.” Ky ishte njoftimi që Henri Matisse vendosi në shkollën e infermierisë në Nisë të Francës në vitin 1942. Ai ishte shtatëdhjetë e dy vjeç dhe po rehabilitohej nga një operacion serioz. Ai kërkonte kujdes të vazhdueshëm dhe kishte nevojë për dikë që të përkujdesej për të, ndërkohë që infermierja e tij e zakonshme ishte larguar për pak kohë.

Një vajzë njëzetë e një vjeçare, studente infermierie me emrin Monique Bourgeois, e pa njoftimin. Për të siguruar ca para për familjen ajo aplikoi dhe Matisse e pranoi. Monique dhe mjeshtri u miqësuan menjëherë. Ata u bënë shpirtra binjakë, dhe vajza nisi ta donte artistin si gjyshin e saj. Ata u bënë miq të mirë, por infermierja e rregullt e Matisse u kthye dhe jeta e tyre mori drejtime të ndryshme. Por, më vonë, në vitin 1943, ata u gjendën rastësisht shumë pranë njëri-tjetri në Vence, një komunë e vogël në juglindje të Francës. Matisse kishte shkuar aty për t’i shpëtuar kërcënimit të bombardimeve, ndërsa Monique kishte ardhur në manastirin e domenikanëve pranë shtëpisë së tij për t’u shëruar nga tuberkulozi. Pasi u shërua ajo vendosi të qëndrojë në manastir e të bëhej murgeshë dhe mori emrin Jacques-Marie. Motrat domenikane kërkonin të ndërtonin një faltore ndaj Jacques-Marie ia prezantoi mjeshtrin priftit përgjegjës për kishën dhe

kështu Matisse, në moshë të thyer nisi dekorimin e faltores. Ai krijoi çdo detaj: dritaret e qelqit, altarin, dyshtën, dekorimin e mureve, ndriçimin, madje edhe rrobat e priftit. Faltorja *Chapelle Du Rosaire*, sot e njohur si *Faltorja e Matisse* është një ndër veprat më të mrekullueshme të mjeshtrit, në të cilën shpaloset një ndërthurje e ngjyrave të ndezura foviste, linjave të dinamikës së tablosë *Kërcimi*, kolazhet me letra të prera, dhe një ilustrim i parajsës që Matisse kishte ëndërruar gjatë të gjithë jetës së tij.

Pablo Picasso u inatos shumë që Matisse po punonte për një kishë. “Përse nuk zbukuron një treg futa perimesh? Do pikturoje fruta dhe perime?” Por Mattise u shpreh, “Nuk dua t’ia di se çfarë mendon. Unë kam jeshile që janë më jeshile sesa dardhat dhe portokallet, e ngjyrë portokalli më të ndezura sesa kungujt e verdhë. Ndaj nuk ka rëndësi që është inatosur Picasso.” Por ky i fundit ende vazhdonte me inatin e tij, “Nuk do isha kundër nëse ti do ishe besimtar. Duke qenë se nuk je, atëherë nuk besoj se ke moralin e duhur.” Por, Mattise iu përgjigj, “Po, unë lutem, edhe ti lutesh, dhe ti e di fare mirë këtë. Kur çdo gjë shkon keq, ne sulemi tek lutja për të rizbuluar atmosferën e kungimit tonë të parë... Unë po eci sërish në një tokë të pastër.”

Matisse e përdori këtë faltore për të harmonizuar të gjitha stilet e tij të pikturës dhe për të përmbledhur gjysmë shekulli përvojë të suksesshme në art. “Dua që ata vizitorë që hyjnë në faltore të ndihen të pastruar dhe të çliruar nga barra e tyre,” u shpreh ai. I gjithë interiori i kishës është krijuar në varësi të dritës. Vetratat janë të zbukuruara me ngjyra të verdhë, blu dhe jeshile. Mjeshtri na shpjegoi edhe se kur është moment më i mirë për ta vizituar atë:

Stina më e favorshme është dimri - Dhe pastaj, ora më e mirë është ora njëmbëdhjetë në mëngjes.

E përse atëherë?

Sepse dritaret janë pikturuar në mënyrë të atillë për të transfigu-ruar të zezën dhe të bardhën që mbizotëron brenda faltores dome-nikane, duke e bërë të ndriçojë me të gjitha ngjyrat e ylberit.

I pyetur sesi mund të krahasohej faltorja e tij me Notre Dame, Matisse u përgjigj: “Është një lule. Është thjeshtë një lule, por është një lule.” Mjeshtri e dinte se fytyra e artit mund të shpaloset përmes thjeshtësisë, duke e mahnitur njerëzimin me gjëra të vogla si lulet, ndaj edhe ai shërbeu si një pasqyrë apo enë për ta përçuar këtë mesazh që arti i jep njerëzimit.

Ne sot shohim veprat e Matisse dhe ndihemi sikur kërcëjmë me ritmin e ngjyrave të thjeshta e të fuqishme. Jeta është një kërcim, e disa prej nesh arrijnë ta kapin ritmin e saj, e disa të tjerë nuk arrijnë dot, por për Henri Mattise, nuk mund të thuhet gjë tjetër veçse ai jo vetëm e kërcëu bukur jetën e tij, por vazhdon ta kryesojë atë kërcim duke na ftuar edhe ne t’i bashkohemi valles së jetës dhe të shijojmë ritmin e saj, e cila, pavarësisht ndërlikimeve që na duket se mund të ketë, është e thjeshtë, e bukur, e ndezur, dhe padyshim, plot ngjyrë.



Në mesin e viteve 1960-të, Nkuptova se po më kthehej në telash përqendrimi i vëmendjes gjatë shkrimit të prozës së gjatë. Për njëfarë kohe kisha vështirësi të lexoja atë që kisha shkruar, ashtu si edhe të shkruaja. Vëmendjen e kisha te vetja, nuk po përqendrohesh dot, dhe nuk kisha durim të shkruaja romane. Është një histori e ngatërruar, tepër e gjatë për ta treguar, por e di që arsyeja pse kjo ndodh me mua ka të bëjë me arsyen pse shkruaj poezi dhe tregime. I thoja vetes: nisja, vazhdo, mos e zgjat. Por ka gjasë që në fund të të njëzetave, të kem humbur ambicien për të shkruar prozë të gjatë. Nëse ishte kështu, mendoj se më mirë që ndodhi. Ambicia dhe pak fat janë gjëra të mira për një shkrimtar. Shumë ambicie dhe fat i keq, ose aspak fat, mund të jenë vdekjeprurëse. Duhet të kesh talent.

Disa shkrimtarë kanë shumë talent, nuk njoh asnjë shkrimtar që nuk e ka. Por t'i shohësh gjwrat në mënyrë unike dhe të saktë, dhe të gesh kontekstin e duhur për t'i shprehur ato, kjo është diçka tjetër. "Bota sipas Garpit" është botë e mrekullueshme, natyrisht, sipas John Irving-ut. Ka një botë tjetër sipas Flannery O'Connor-it, dhe të tjera sipas William Faulkner-it dhe Ernest Hemingway-t. Ka botë sipas Cheever-it, Updike-ut, Singer-it, Stanley Elkin-it, Ann Beattie-it, Cynthia Ozick-ut, Donald Barthelme-it, Mary Robison-it, William Kittredge-it, Barry Hannah-it, Ursula K. LeGuin-it. Çdo shkrimtar i madh apo edhe shumë i mirë e bën botën sipas veçantive të tij.

Ajo për të cilën po flas, është e ngjashme me stilin, por nuk është vetëm stil. Është firma e veçantë dhe e pagabueshme e shkrimtarit në gjithçka që shkruan. Është bota e tij dhe e askujt tjetër. Kjo është një nga gjërat që e dallon një shkrimtar nga një tjetër. Jo talenti. Ka shumë të talentuar rreth nesh. Por shkrimtari që ka një mënyrë të veçantë se si i sheh gjërat dhe kësaj pamje i jep shprehje artistike: ai shkrimtar mund të jetë rreth nesh për shumë kohë. Isak Dinesen-i ka thënë se shkruante nga pak çdo ditë, pa shpresë dhe pa dëshpërim. Një ditë do ta vendos këtë thënie në një letër dhe do ta ngjit në mur, pranë tryezës time të shkrimit. Tani unë mbaj disa letra të tilla në mur. "Saktësia themelore e një thënieje është morali I VETËM i shkrimit". Ezra Pound. Nuk është kjo gjithçka DOMOSDOSHMERISHT, por nëse një shkrimtar ka "saktësinë themelore të thënies", ai është të paktën në rrugën e duhur.

Kam një letër të tillë të ngjitur lart, me këtë fragment fjalie nga një tregim i Çehovit: "...dhe papritur



MBI ARTIN E TREGIMIT

nga Raymond Carver

gjithçka iu bë e qartë". Për mua këto fjalë janë të mbushura me habi dhe mundësi. Më pëlqen qartësia e tyre e thjeshtë, dhe shenja për zbulesën që nënkuptohet. Kanë edhe mister. Çfarë ka qenë e paqartë më parë? Pse po bëhet e qartë pikërisht tani? Çfare ndodhi? Mbi të gjitha – çfarë do të ndodhë tani? Ka pasoja si rezultat i zgjimeve të tilla të papritura. Ato më shkaktojnë një ndjenjë të mprehtë lehtësimi dhe pritshmërisht.

Kam dëgjuar shkrimtarin Geoffrey W olff duke thënë para

një grupi studentësh të shkrimit krijues: "Mos bëni truke të pavlera". Edhe kjo duhet ngjitur në mur. Do ta ndryshoja pak në "Mos bëni truke". Pikë. I urrej truket. Sapo të pikas shenjën e parë të një truku ose një marifeti në një krijim letrar, një truk të pavlerë apo edhe një truk të ndërlikuar, prirem të hedh sytë te ballina e librit. Truket janë përfundimisht të mërzitshme dhe unë mërzitem lehtë, gjë që mund të lidhet me faktin që nuk përqendrohem për një kohë të gjatë. Por shkrimi jashtëzakonisht

i mençuar, ose thjesht shkrimi pa kuptim, më vë në gjumë. Shkrimtarët nuk kanë nevojë për truke apo marifete dhe nuk është e domosdoshme të jenë më të zgjuarit. Duke marrë në sy rrezikun të duket si i marrë, shkrimtari ndonjëherë duhet të jetë në gjendje të ndalet dhe të habitet prej diçkaje – nga muzgu apo një këpucë e vjetër - me mahnitje absolute dhe të thjeshtë.

Disa muaj më parë, në "New York Times Book Review", John Barth shkroi se dhjetë vjet më parë shumica e studentëve në seminarin e shkrimit letrar ishin të interesuar për "risitë formale" dhe kjo nuk duket se po ndodh më. Ai është pak i shqetësuar se mos shkrimtarët fillojnë të shkruajnë në vitet 1980-të romane për nënat dhe baballarët. Ai shqetësohet se eksperimentimi në shkrimin letrar mund të jetë duke u braktisur, së bashku me liberalizmin. Bëhem pak nervoz nëse shoh se jam duke dëgjuar diskutime të zymta për "risitë formale" në letërsi. Shumë shpesh "eksperimentimi" është një leje për të qenë të pakujdesshëm, teveqelë ose imitues në letërsi. Edhe më keq, një leje për të dhunuar apo tjetërsuar lexuesin. Shumë shpesh një letërsi e tillë nuk na jep asnjë lajm nga bota, ose përshkruan një peizazh shkretëtire dhe kaq – disa duna dhe hardhuca aty-këtu, por jo njerëz; një vend të pabanuar nga asgjë e njohur njerëzore, një vend me interes vetëm për disa specialistë shkencorë.

Duhet të theksohet se eksperimenti i vërtetë në krijimtarinë letrare është origjinal, i fituar me vështirësi dhe është arsye për t'u gëzuar. Por mënyra e dikujt tjetër se si i sheh gjërat - ajo e postmodernistit Donald Barthelme, për shembull - nuk duhet të ndiqet nga shkrimtarët e tjerë. Nuk do të funksionojë. Ekziston vetëm një Barthelme, dhe që një shkrimtar tjetër të përpiqet të përvetësojë ndjeshmërinë e veçantë të Barthelme-it ose *mise en scene*-ën në rubrikën e risisë për atë shkrimtar do të thotë të ngatërrohet me kaosin dhe fatkeqësinë dhe, edhe më keq, me vetë-mashtrimin. Eksperimentuesit e vërtetë duhet ta "bëjnë të re", siç kërkoi Ezra Pound-i, dhe në këtë proces duhet t'i zbulojnë vetë gjërat. Por nëse shkrimtarët nuk kanë hequr dorë nga shqisat, ata duhet gjithashtu të mos shkëputen plotësisht nga ne, duhet të përcjellin lajme nga bota e tyre tek e jona.

Është e mundur, që në një poezi ose një tregim, të shkruash për gjëra dhe objekte të zakonshme duke përdorur një gjuhë të zakonshme, por të saktë, dhe t'i pajisësh këto gjëra - një karrige, një perde

dritareje, një pirun, një gur, një vath gruaje - me pafundësi, madje me fuqi befasuese. Është e mundur të shkruash një rresht dialogu në dukje të padëmshëm dhe t'ia shtish të dridhurat lexuesit – ta bësh burim të kënaqësisë artistike, siç do të thoshte Nabokovi. Ky është lloji i shkrimit që më intereson më shumë. Nuk më pëlqen shkrimi i shkujdesur ose i paorganizuar, edhe nëse mban lart flamurin e eksperimentimit ose është thjesht realizëm i paraqitur dobët.

Në tregimin e mrekullueshëm të Isaac Babel-it, “Guy de Maupassant”, rrëfimtari ka këtë për të thënë për shkrimin e letërsisë : “Asnjë hekur nuk mund ta shpojë zemrën me aq forcë sa një pikë e vënë pikërisht në vendin e duhur”. Kjo gjithashtu duhet të vihet në një letër për ta ngjitur në mur.

Evan Connell tha një herë se ai e dinte se kishte mbaruar me një tregim kur shihte se po e rishikonte dhe po hiqte presje dhe më pas duke e lexuar përsëri historinë i vendoste presjet përsëri në të njëjtat vende. Më pëlqen kjo mënyrë të punuari. E respektoj këtë lloj kujdesi për atë që po bëhet.

Në fund të fundit, kjo është gjithçka që kemi, fjalët, dhe është mirë që ato të jenë të duhurat, me shenjat e pikësimit në vendet e duhura, në mënyrë që ato të mund të thonë më së miri atë që mendohet të thonë. Nëse fjalët janë të rënda ngaqë emocionet e vetë shkrimtarit janë të shfrenuara, të gabuara dhe të pasakta për një arsye a një tjetër - nëse fjalët janë në ndonjë mënyrë të paqarta - sytë e lexuesit do të rrëshqasin mbi to dhe nuk do të arrihet asgjë. Ndjenja artistike e lexuesit thjesht nuk do të ngjallet. Henry James-i e quajti këtë lloj shkrimi të pafat “veçanti të dobët”.

Kam miq që më kanë thënë se duhej të nxitonin ta përfundonin një libër, sepse kishin nevojë për para, botuesi ose bashkëshortja i detyronte – dhe ata në një farë mënyre kërkonin falje që shkrimi nuk ishte shumë i mirë. “Do të kishte qenë më mirë nëse do t'i kushtuar më shumë kohë”. Mbeta i shtangur kur dëgjova një mik romancier të thoshte këtë. Këtë ndjesi më shkakton, sa herë që e mendoj, gjë që e shmang. Nuk është puna ime. Por nëse letërsia nuk mund të bëhet brenda nesh aq e mirë sa është, atëherë pse ta shkruajmë? Në fund, kënaqësia që kemi bërë më të mirën dhe prova e kësaj pune të madhe, është e vetmja gjë që mund të marrim në varr. Doja t'i thoja mikut tim, për atë Zot, më mirë merru me diçka tjetër. Duhet të ketë mënyra më të lehta dhe ndoshta më të ndershme për të nxjerrë bukën e gojës. Ose

thjesht bëje duke përdorur aftësitë, talentin tënd në mënyrën më të mirë të mundshme dhe pastaj mos u shfajësoj dhe mos gjej justifikime. Mos u anko, mos jep shpjegime.

Në një ese të quajtur, thjesht, “Shkrimi i tregimeve”, Flannery O'Connor flet për shkrimin si një akt zbulimi. O'Connor thotë se ajo shumë shpesh nuk e dinte se çfarë do të shkruante kur ulej për të shkruar një tregim. Ajo thotë se është dyshuese kur shumë shkrimtarë e dinë se çfarë do të shkruajnë kur fillojnë të shkruajnë diçka. Ajo përdor tregimin “Njerëz të mirë, të thjeshtë” si një shembull se si ajo shkroi një tregim, fundin e të cilit as që mund ta merrte me mend derisa i ishte afuar: “Kur fillova të shkruaj atë histori, nuk e dija se do të flitej aq me hollësi për shumë tema të jetës së përditshme dhe njëri nga personazhet do të kishte një këmbë druri. Thjesht një mëngjes pashë se po përshkruaja dy gra për të cilat dija diçka, dhe para se të isha e vetdijshme, njëra prej tyre kishte një vajzë me një këmbë druri. U shfaq shitësi i Biblës, por

nuk e kisha idenë se çfarë do të bëja me të. Nuk e dija se do ta vidhte atë këmbë prej druri deri në dhjetë a dymbëdhjetë rreshta para se ta bënte, por kur zbulova se kjo ishte ajo që do të ndodhte, kuptova se ishte e pashmangshme.

Kur e lexova këtë para disa vitesh, u befasova që ajo, ose kushdo tjetër, shkroi tregime në këtë mënyrë. Mendova se kjo ishte diçka që më ndodhte vetëm mua dhe isha pak në siklet. Me siguri mendova se kjo mënyrë e të punuarit në një tregim në një farë mënyre zbulonte disi të metat e mia. Mbaj mend që u ngazëlleva shumë duke lexuar atë që ajo kishte për të thënë për këtë temë.

Një herë u ula për të shkruar atë që doli të ishte një histori mjaft e mirë, megjithëse kisha vetëm fjalinë e parë të tregimit kur e fillova. Prej disa ditësh sillesha me këtë fjali në kokë: “Ai po përdorte fshesën me korrent kur ra telefoni”. E dija se kishte një histori aty e cila donte të rrëfehej. E ndjeja së thelli, se kjo histori fillonte në atë mënyrë, nëse do të kisha kohë ta shkruaja.


Gjeta kohën, një ditë të tërë, madje dymbëdhjetë, pesëmbëdhjetë orë, nëse do të doja t'i shfrytëzoja. E gjeta këtë kohë, u ula në mëngjes, shkrova fjalinë e parë, dhe fjalitë e tjera filluan t'i bashkoheshin të parës menjëherë. E shkrova tregimin ashtu siç do të shkruaja një poezi; një rresht dhe pastaj tjetrin, dhe tjetrin. Shumë shpejt mund të shihja një histori të shkruar dhe e dija se ishte historia ime, ajo që doja të shkruaja.

Më pëlqen kur ka një ndjenjë rreziku ose kërcënimi në tregime. Mendoj se është mirë të kesh një kërcënim të vogël në një histori. E para, është gjë e mirë për të vënë gjërat në lëvizje. Duhet të ketë tension, një ndjesi se diçka është e pashmangshme, se disa gjëra janë në lëvizje të pandërprerë, përndryshe, shpesh ndodh që thjesht nuk ke një histori. Ajo që krijon tension në një krijim artistik është deri diku mënyra se si fjalët konkrete lidhen së bashku për të krijuar veprimin e dukshëm të historisë. Por janë edhe gjërat që lihen jashtë, që nënkuptohen, peizazhi mu nën sipërfaqen e lëmuar (por ndonjëherë të thyer dhe të paqartë) të gjërave.

Përkufizimi i V.S. Pritchett-it për tregimin është: “diçka e parë kalimthi me cep të syrit”. Vini re pjesën “shoh kalimthi” të këtij përkufizimi. Së pari, të shikuarit. Më pas, pamjes i jepte jetë, shndërrohet në diçka që ndriçon çastin dhe, nëse jemi me fat - përsëri kjo fjalë - mund të ketë rëndësi dhe kuptim më të gjerë. Detyra e lëvruarit të tregimit është të rrok me këtë shikim gjithçka që mundet me fuqinë e tij krijuese. Sprova më e madhe është që me inteligjencën dhe aftësinë letrare (talentin) e tij, të gjejë masën e përpjesëtimin dhe përshtatshmërisë së gjërave: të shpë rfaqë se si gjërat janë në të vërtetë dhe si i sheh ai ato gjëra - ashtu siç askush tjetër nuk i sheh ato. Dhe kjo bëhet nëpërmjet përdorimit të gjuhës së qartë dhe specifike, gjuhës së përdorur për të sjellë në jetë detajet që do të ndriçojnë historinë për lexuesin. Dhe në mënyrë që detajet të jenë konkrete dhe të përçojnë kuptim, gjuha duhet të jetë e duhura dhe e përdorur me saktësi. Fjalët mund të jenë aq të sakta, saqë mund të tingëllojnë monotone, por gjithsesi nëse përdoren siç duhet, mund të jenë pikërisht ato që duhen duke qëlluar në shenjë .

Ese e shkëputur nga studimi “Historia dhe shkrimtari i saj: hyrje në artin e tregimit”, hartuar nga Anne Chartes, Universiteti i Kënektikatit, SHBA, 2003.

Përktheu: Granit Zela



SADIK BEJKO

kalorësit e shiut

Onufri Poezi

